





Ajetullah Muhamed Taki Misbah Jezdi

**PASQYRIMI I KUR'ANIT**  
**NË**  
**“NEHXHUL BALAGA”**

Tiranë, 2023

**Titulli: Pasqyrimi i Kur'anit në "Nehxhul Balaga"**

**Autori: Ajetullah Muhamed Taki Misbah Jezdi**

**Përktheu: Mentor Çadri**

**Recensent: H. Vullnet Merja**

**Redaktoi: Jerida Kulla**

**Perkujdesja garfike: Sabrie Feza**

**Kapaku: Sabrie Feza**

**Botoi: Shoqata FLLADI**

Ky libër është një instrument i shkëlqyer për të kuptuar Kur'anin në dritën e "Nehxhul Belagës"<sup>1</sup> (fjalët e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*)). Ai i drejton lexuesit se si të kuptojnë subjektin e Kur'anit, si ta interpretojë atë në shoqërinë e sotme dhe pengesat kulturore që hasen për ta kuptuar atë si duhet.

© Asambleja Botërore Ehli Bejti

*Të gjitha të drejtat e rezervuara.*

*www.ahl-ul-bait.org info@ahl-ul-bayt.org*

---

<sup>1</sup> Nehxhul Belaga është një përmbledhje fjalimesh, thëniesh dhe letrash të Prijësit të Besimtarëve, Imam Ali ibn Ebu Talibit (Paqja qoftë mbi të!), hartuar nga Sharif al-Radi Muhamed ibn Husejni (d. 406 AH / 1016). Përmbajtja librit ka të bëjë me tri temat thelbësore: Zoti, njeriu dhe gjithësia. Kjo vepër përfshin komente mbi çështjet shkencore, letrare, sociale, etike dhe politike. Me përjashtim të fjalëve të Kur'anit të Madhërishëm dhe të Profetit të Shenjtë Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), asnjë ligjëratë e njeriut nuk mund të barazohet me të për nga elokuenca.

Deri tani, më shumë se 101 interpretime, shpjegime janë shkruar në "Nehxhul Belaga", duke treguar rëndësinë e kësaj teze për dijetarët dhe njerëzit e ditur të kërkimit.

Për më shumë informacion, vizitoni: <https://www.al-islam.org/nahjul-balagha-part-1-sermons> (Përkthyesi)

## SIMBOLET E TRANSLITERIMIT

Simboli	Transliterimi	Transliterimi (rishikim i alfabetit tjetër)
ء	'	a
ب	B	t
ث	th	j
ح	h	kh
د	D	dh
ر	R	z
س	S	sh
ص	s	dh
ط	t	z
ع	'	gh
ف	F	q
ك	K	l
م	M	n

ه	H	ë
ي	Y	ah

### Zanoret e gjata

آ	A	a
اي	I	i
او	U	u

### Shkronjat në persisht

Simboli	Transliterimi	Transliterimi
پ	P	ch
ژ	Zh	g

## PARATHËNIE

*Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!*

Ruajtja e trashëgimisë së çmuar, lënë pas nga familja e Profetit të Shenjtë, Ehli Bejti (*Paqja qoftë mbi ta!*) nga pasuesit e tyre, nga kërcënimi i zhdukjes, është ilustruar nga një shkollë gjithëpërfshirëse (*maktab*), e cila mbulon të gjitha degët e ndryshme të dijes islame dhe ushtron kërkuesit e sinqertë të së vërtetës.

Ajo, në listën e dijetarëve, ka shumë personalitete të talentuara, të cilët kanë përfituar nga kjo pasuri e madhe e dijes dhe e njohurive. Kjo shkollë ka paraqitur studiues të umetit mysliman, i cili, duke ndjekur familjen e Profetit të Shenjtë, Ehli Bejtin, (*Paqja qoftë mbi ta!*), i është dhënë autoriteti për të zhdukur dyshimet dhe skepticizmin e hasur nga besimet e ndryshme dhe prirjet intelektuale, si brenda ashtu edhe jashtë shoqërisë myslimane dhe kanë dhënë përgjigje e zgjidhje më të qëndrueshme, lidhur me këto dyshime gjatë gjithë shekujve në të kaluarën.

Ankoruar në përgjegjësitë që mbart mbi supe, Asambleja Botërore "Ehli Bejti" ka filluar mbrojtjen e shenjtërisë së profetësisë (*risalah*) dhe të besimit autentik, të vërtetat e të cilave kanë qenë



kundërshtuar gjithmonë nga krerët dhe prijësit e sekteve, të feve dhe të prirjeve antiislame.

Kuvendi e konsideron veten si një pasues i nxënësve të drejtë të shkollës së Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*). Ata gjithmonë, bazuar dhe në përshtatje me kohën dhe hapësirën, kanë hedhur poshtë, mbi baza logjike, të gjitha akuzat dhe, me përpjekjet e tyre, kanë qenë të parët për të sqaruar të gjitha keqkuptimet dhe keqinterpretimet.

Njohuritë empirike, të ruajtura në librat e tyre, nga dijetarët e shkollës së Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*) janë unike, sepse janë bazuar mbi intelektin dhe arsyetimin e pastër nga çdo grimcë paragjykimi të verbër apo tekë. Ajo i adresohet ekspertëve, studiuesve dhe mendimtarëve, në një mënyrë që është e pranueshme për një mendje të shëndoshë njerëzore (*fitrah*).

Me qëllimin e përhapjes të së vërtetës, Asambleja Botërore “Ehli Bejt”, në kuadër të hulumtimit, i ka përfshirë këto njohuri me vlerë, shkrimet e shkrimtarëve bashkëkohorë shi’itë apo të atyre, që, nëpërmjet udhëzimit hyjnor, përqafojnë këtë shkollë fisnike.

Kjo Asamble, është gjithashtu e angazhuar në studimin dhe botimin e veprave me vlerë të paraardhësve të devotshëm dhe personaliteteve të shquara shi’ite, në mënyrë që kërkuesit e të vërtetës të mund të shuajnë etjen e tyre nga ky burim i freskët i njohurive, të ofruara nga familja e Profetit të Shenjtë, Ehli Bejt (*Paqja qoftë mbi ta!*), si një dhuratë për të gjithë botën.

Shpresohet që lexuesit tanë nuk do ta kufizojnë Asamblenë Botërore "Ehli Bejtî" nga pikëpamjet dhe sugjerimet e tyre me vlerë, si dhe nga kritika konstruktive në këtë fushë.

Ne, gjithashtu, ftojmë studiuesit, përkthyesit dhe institucionet e tjera që të na ndihmojnë në propagandimin dhe përhapjen e Islami të pastër.

Ne i lutemi Allahut të Lartësuar ta pranojë këtë përpjekje të vogël dhe ta çojë atë më tej, nën kujdesin e mëkëmbësit të Tij në tokë, Imam Mehdiut (*Allahu përshpejtoftë ardhjen e tij të lavdishme!*).

Ne shprehim mirënjohjen tonë të pakufishme për Profesor Ajetullah Muhamed Taki Misbah Jazdi për shkrimin e librit, për zotin Mansur Limba, për përkthimin e tij dhe për të gjithë kolegët tanë të nderuar, sidomos të nderuarit e Zyrës së Përkthimit, për përmbushjen e kësaj detyre.

**Departamenti i Çështjeve Kulturore**

**Asambleja Botërore "Ehli Bejtî"**

## HYRJJE

**Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!**

*Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve. Qofshin bekimet e Allahut mbi Profetin Muhamed dhe mbi pasardhësit e tij të dëlirë. Mallkimi i Allahut qoftë mbi të gjithë armiqtë e tyre.*

Edhe pse ne besojmë se Kur'ani i Shenjtë është dhurata më e madhe hyjnore për njerëzimin dhe trashëgimia më e çmuar e Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për myslimanët, umeti mysliman nuk ka treguar sa duhet interes për ta përdorur këtë trashëgimi të çmuar.

Pavarësisht se është theksuar në mënyrë të përsëritur nga i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), si një detyrim që duhet t'i referohet Kur'anit për të vepruar në jetën tonë, si gjënë me më shumë peshë (*thiqi al-akbar*) dhe për të mësuar shkencat e Kur'anit nga Ehli Bejti (*Paqja qoftë mbi ta!*), si gjënë me më shumë peshë (*thiqi el-kabir*), myslimanët neglizhuan këshillat e tij, për t'u mbajtur fort pas litarit unifikues të Allahut (*habl Allah*), dhe, pas vdekjes së Profetit Muhamed (*Paqja*

dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), u ndanë në sekte.

Si pasojë, shoqëria myslimane mbeti prapa me statusin e saj original, i cili është përshkruar në Kur'an në këtë mënyrë:

وَأَنْتُمْ الْأَعْلَوْنَ إِنْ كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ

**"Mos u ligështoni dhe mos u pikëlloni, sepse ju, gjithsesi jeni më të lartët, nëse jeni besimtarë të vërtetë.<sup>1</sup>**

Në ditët e sotme, duhet të pranojmë realitetin e dhimbshëm, se për arsye të largimit nga realiteti i Kur'anit dhe i diturive të Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*), shoqëria myslimane ka pësuar humbje të pariparueshme.

Pavarësisht largimit nga realiteti i Kur'anit dhe shkëputjes nga kjo perlë qiellore dhe dhuratë e të Gjithëmëshirshmit, kujdesi, ose vëmendja e veçantë për të, ka marrë vrull, përparësi dhe është rritur dukshëm në mesin e myslimanëve të sotëm.

Të gjithë myslimanët e njohin Kur'anin si Shkrimin e shenjtë që i është shpallur të Dërguarit të bekuar (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) Natën e Caktimit (*Nata e Kadrit*).<sup>7</sup> Tani, printimi i Kur'anit të Shenjtë në letër të cilësisë së lartë, me kapakë të artë, recitimi dhe memorizimi i tij, zotërimi i shkencave që kanë të bëjnë me pamjet e tij të jashtme, të tilla, si: shqiptimi korrekt dhe recitimi (*taxhvid*), kanë gjetur një vend të veçantë në kulturën myslimane. Herë pas here ne jemi dëshmitarë në organizimin e konkurseve vjetore të recitimit dhe të mësimin

<sup>1</sup> Sure "Ali Imran", ajeti 139

përmendësh të Kur'anit të Shenjtë në nivel ndërkombëtar. Kjo, në vetvete, është bërë burim i përparimit.

Sigurisht, nuk duhet lënë pa përmendur se vëmendja gjithnjë në rritje, kushtuar Kur'anit të Shenjtë, në vende të tjera myslimane, ka qenë, në një farë mase, për shkak të Hirësisë së Tij, Imam Khomeinit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe fitores së Revolucionit Islamik në Iran, sepse, pas mesazhit të Imamit të shquar (*Paqja qoftë mbi të!*), për administratën e dy Vendeve të Shenjta (*el-haramajn el-sharifajn*) (Mekës dhe Medines), përcjellë nga një këshill (*shaëra*) i përbërë nga përfaqësues të shumë vendeve myslimane, Arabia Saudite ndërmori dëmshpërblimin dhe zhvillimin e dy vendeve të shenjta, bashkë me shtypjen dhe shpërndarjen e kopjeve të Kur'anit pelegrinëve të Haxhit nga e gjithë bota, jo vetëm për ta paraqitur veten si pionieri i përhapjes së Islamit dhe Kur'anit, por edhe për të minuar vëmendjen e kushtuar nga myslimanët për Republikën e Iranit.

Përqendrimi në aspektet e jashtme të Kur'anit dhe largimi nga e vërteta e tij, ka qenë një nga problemet më të mëdha, për shkak të të cilave myslimanët kanë marrë goditje të rënda. Për sa kohë që myslimanët nuk lëvizin nga kahet e jashtme të Kur'anit drejt aspekteve të tij të fshehta dhe transformimit të retorikës boshe në praktikë, udhëzimi i Kur'anit nuk do të arrihet prej tyre.

Ky vëllim nuk është një përpjekje për të shqyrtuar arsyet pse myslimanët janë prapa nga e vërteta e Kur'anit dhe e pasardhësve të Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), pas vdekjes së tij.

Më saktë, kjo përpjekje është për të paraqitur disa nga dimensionet e të vërtetës së Kur'anit nga këndvështrimi i "Nehxhul Belagës" dhe vetë Librit të Shenjtë, si dhe për të njohur lexuesit me Kur'anin dhe me madhësinë e tij nga perspektiva e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*).

Ajo, gjithashtu, trajton dhe adreson disa dyshime të shprehura nga armiq të veçantë të Kur'anit. Këto dyshime janë përmendur në pjesën përmbyllëse, edhe përmes predikimeve të Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*).

Në të vërtetë, çështjet e trajtuara në këtë libër janë përkthime të një seri leksionesh të mbajtura nga Hirësia e Tij, Ajetullah Misbah Jazdi, për Ramazan 1419-20 hixhrij (21 dhjetor 1998, 18 janar 1999, 10 dhjetor 1999, si dhe 8 janar 2000) në Kum. Temat e trajtuara nga profesor Jazdi nuk janë shkurtuar dhe nuk janë përshtatur, por gjuha bisedore është afruar me fjalën e shkruar, me një përpjekje për të ruajtur një saktësi të përsosur në hartimin dhe redaktimin e këtij libri.

Si përfundim, ne u jemi mirënjohës dijetarit erudit, të nderuarit Ahmed Muhamedi për përkthimin dhe hartimin e temave të këtij libri dhe të nderuarit Muhamed Mahdi Nadiri Kummi për redaktimin e tij në gjuhën angleze.

I lutemi Allahut, Dhënësit të mirësive për suksesin e tyre të vazhdueshëm!

*Instituti Arsimor dhe Kërkimor "Imam Khomeini"*

# KAPITULLI I

## STATUSI I KUR'ANIT NË SHOQËRITË FETARE

### ***Kur'ani, si i vetmi Libër i Shenjtë në dispozicion të njerëzimit***

Nëse do donim të sqaronim çdo gjë që është trajtuar, në lidhje me Kur'anin, në "Nehxhul Belaga", kjo do të përbënte një diskutim shumë të gjatë. Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) e ka paraqitur Kur'anin dhe statusin e tij në më shumë se 20 predikime të regjistruara në "Nehxhul Belaga". Ndonjëherë, ai ka ndarë në më shumë se gjysmën një Ligjëratë, në sqarimin e statusit të Kur'anit, rolin e tij në jetën e myslimanëve dhe detyrimin e tyre ndaj këtij Libri të Shenjtë. Këtu, ne do të shpjegojmë vetëm disa nga përshkrimet e Kur'anit të Shenjtë në "Nehxhul Belaga".

Në Ligjëratën 133, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) thotë:

"Libri i Allahut është mes jush. Ai ligjëron dhe gjuha e tij nuk belbëzon."<sup>1</sup>

Kjo do të thotë: Kur'ani është pranë jush dhe i arritshëm për ju. Në kundërshtim me shkrimet e tjera qiellore, si ato që i janë shpallur Profetit Musa (Moisiut) dhe Profetit Isa (Jezusit) (*Paqja qoftë mbi ta!*), Kur'ani është në dispozicionin tuaj. Thuhet se në të kaluarën, sidomos në mesin e hebrenjve, Shkrimet e shpallura nuk ishin në dispozicion të masave të gjera. Vetëm disa pjesë të Teuratit ishin në dispozicion të teologëve çifutë dhe nuk ishte e mundur që masat e gjera të kishin qasje në to.

Lidhur me shkrimet e shenjta qiellore, të shpallura Profetit Isa (*Paqja qoftë mbi të!*), statusi i tyre ka qenë më shqetësues, sepse ajo që është i njohur sot si Ungjill (*Inxhil*) në mesin e të krishterëve, nuk është libri i shpallur për Profetin Isa, El-Masih (Jezusi, Krishti/Mesia). Më saktë, ai përbëhet nga tema të hartuara nga individë të caktuar dhe të njohura si Katër Ungjijtë Kanonikë.<sup>2</sup>

Kështu, komunitetet e mëparshme ishin të kufizuar nga qasja me shkrimet qiellore. Por Kur'ani ka një histori të ndryshme.

Mënyra e shpalljes së Kur'anit, këndimi dhe mësimdhënia e tij nga Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte i tillë që njerëzit mësuan përmendësh

---

<sup>1</sup> Në këtë vëllim, përkthimi i citimeve nga "Nehxhul Belaga" është përshtatur nga Sejid Ali Riza, Nehxhul Belaga: Kulmi i elokuencës, Kum, Fondacioni për Përhapjen e Kulturës Islame në Botë, 1995). (Përkthyesi)

<sup>2</sup> Kjo do të thotë, katër librat e para të Dhiatës së Re, d.m.th: Ungjijtë e Markut, të Lukës, të Mateut dhe të Gjonit. (Përkthyesi)



vargjet e tij dhe Kur'ani, në formën e tij të plotë, ka qenë në duart e tyre.

Ndër dallimet e tjera të rëndësishme të këtij Libri Qiellor është se Allahu i Lartësuar, vetë merr përgjegjësinë e ruajtjes dhe mbrojtjes së Kur'anit të Shenjtë nga çdo formë e kërcënimit. Përveç kësaj, i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) sigurohej që myslimanët të mësonin përmendësh ajetet e tij hyjnore, me qëllim që një numër i madh i myslimanëve, gjatë jetës së tyre, ta mësonin përmendësh të gjithë Kur'anin.

Ata mësuari të përgatisnin dorëshkrimet e ajeteve, sapo u shpallën dhe dalëngadalë i mësonin përmendësh ato. Përsëritja e këtyre dorëshkrimeve dhe të mësuarit e Kur'anit përmendësh bëri që të jetë i arritshëm për të gjithë.

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) thotë: "*Libri i Allahut është mes jush. Ai ligjëron dhe gjuha e tij nuk belbëzon.*" Është mirë të reflektojmë mbi thënien e dytë. Kjo do të thotë: Ky Libër ka forcën e të folurit dhe gjuha e tij as belbëzon e as nuk ndihet e lodhur.

Më pas, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) vazhdon:

وَيْتٌ لَا يُهْدَمُ أَرْكَانُهُ، وَعِزٌّ لَا يُهْرَمُ أَعْوَانُهُ.

"Ajo është një ndërtesë, kolonat e të cilës nuk shemben dhe një fuqi, mbështetësit e të cilës nuk mund t'i mposhtësh kurrë."

## **Mënyra kur'anore e ligjërit**

Në përshkrimin e Kur'anit në "Nehxhul Belaga", nga njëra anë, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), thotë se ky Libër është një libër folës, ligjërues dhe nuk lodhet nga të folurit. Ai shpreh në mënyrë të qartë vetveten. Nga ana tjetër, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) thotë se ky Kur'an nuk flet. Ai duhet të nxitet për të folur dhe "Unë jam njeriu që paraqet dhe shpjegon këtë Kur'an për ju."

Në disa raste, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka përshkruar Kur'anin si një "ligjërues a folës të heshtur" (*Samitun Natik*).<sup>1</sup> Kur'ani është një ligjërues, por ai është ligjërues i heshtur. Çfarë do të thotë kjo?

Duket se kjo shprehje tregon dy këndvështrime të ndryshme për këtë Libër të Shenjtë. Një këndvështrim është se Kur'ani është një Libër i Shenjtë, por qëndron i heshtur, vendosur në një cep. Ai nuk flet me askënd dhe askush nuk komunikon me të. Këndvështrimi i dytë është se ai është një Libër folës, që u adresohet të gjitha qenieve njerëzore, u bën thirrje atyre që të ndjekin udhëzimin e tij dhe u jep lajmin e gëzuar të suksesit dhe të çlirimit të pasuesve të tij.

Natyrisht, Kur'ani, përshkrimi i vetëm i të cilit është shenjtëria, përbëhet prej fjalëve, fjalive dhe ajeteve të shkruara në letër. Myslimanët e puthin dhe tregojnë respekt për të dhe e vendosin në pjesën më të dukshme të shtëpive të tyre. Ndonjëherë,

---

<sup>1</sup> "Nehxhul Belaga", Ligjërata 147. Duhet të theksohet se në këtë libër, të gjitha citatat e Kur'anit janë të "Nehxhul Belaga".

ata e lexojnë atë në tubime, pa i kushtuar vëmendje kuptimit të tij. Nëse ne e shohim Kur'anin në këtë mënyrë, atëherë ai është një libër i heshtur, i cili nuk prodhon një tingull të veçantë. Çdokush që ka një pikëpamje të tillë mbi Kur'anin, nuk do të dëgjojë një fjalë prej tij dhe Kur'ani i Shenjtë nuk do të zgjidhë asnjë nga problemet e tij.

Prandaj, ne jemi të detyruar të ndjekim këndvështrimin e dytë. Kjo do të thotë se duhet ta konsiderojmë Kur'anin si librin e jetës. Duke kultivuar frymën e nënshtrimit, të bindjes ndaj Allahut të Madhërishëm, ne duhet të jemi të përgatitur për të dëgjuar mesazhin e Kur'anit të Shenjtë, që përmban udhëzime për një jetë më të mirë. Në këtë mënyrë, Kur'ani flet, duke i udhëzuar njerëzit në të gjitha aspektet e jetës.

Përveç këtij interpretimi të Kur'anit, si "një folës dhe drejtues i heshtur", që kemi përmendur, ka një kuptim më të thellë të tij, ajo që Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) i referohet, kur thotë: "*Unë jam ai që shpjegon Kur'anin për ju.*"

Është e vërtetë se Kur'ani i Shenjtë është Fjala e Allahut të Lartësuar dhe e vërteta e kësaj fjale hyjnore dhe mënyra e shpalljes së tij janë përtej të kuptuarit tonë. Por, ngaqë qëllimi është udhëzimi i njerëzimit, kjo Fjalë e Allahut është thjeshtuar në formën e fjalëve, të fjalive dhe të ajeteve, që mund të lexohen dhe të dëgjojnë nga të gjitha qeniet njerëzore.

Megjithatë, nuk është e saktë të thuhet se përmbajtja e të gjitha ajeteve mund të kapen dhe të kuptohen nga mendjet me formim mesatar dhe kuptimi i ajeteve të arrihet pa iu drejtuar interpretimit dhe shpjegimit të të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe*

bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), Imamëve të Pagabueshëm dhe atyre me formim dhe njohuri të formuar.

Për shembull, detaje dhe shpjegime të anëve të veçanta të ligjit nuk janë përmendur në Kur'an. Për më tepër, ajetet e Kur'anit të Shenjtë janë koncize dhe kështu, ato kanë nevojë për shpjegime dhe sqarime. Prandaj, për shumë arsye, Kur'ani është "i heshtur" (*samit*). Kjo do të thotë, në mungesë të shpjegimit dhe interpretimit të atyre që kanë njohuri dhe vetëdije hyjnore, ai është i pakapshëm për njerëzit e thjeshtë.

### ***Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe shpjegimi i Kur'anit***

Një nga përgjegjësitë e të Dërguarve për umetin është që të shpjegojnë ajetet hyjnore. Duke iu drejtuar të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), Kur'ani i Shenjtë thotë:

وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الذِّكْرَ الْحَقَّ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ

"Ne e zbritëm përkujtesën (Kur'anin) në mënyrë që t'u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur dhe që ata të mendojnë."<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Sure "En Nahl", ajeti 44.

Kur'ani është Fjala e Allahut, edhe pse ajo është reduktuar shumë për t'u shqiptuar me fjalë dhe ajete në dispozicion të myslimanëve, dija e saj e thellë nuk mund të kuptohet nga një laik.

Kjo është arsyeja që Kur'ani është "i heshtur" për njerëzit e zakonshëm dhe ka nevojë për interpretimin dhe shpjegimin e të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe të Imamëve të Pagabueshëm, sepse ajetet e Kur'anit kanë interpretime të veçanta, të cilat janë të njohura vetëm për të Dërguarin e Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe Imamët e Pagabueshëm, që ia transmetojnë shkencat e Kur'anit myslimanëve dhe ia përcjellin mesazhin e tij njerëzve.

Megjithatë, duhet të theksohet se Kur'ani deklaron mesazhin e tij, qoftë i këndshëm apo i pakëndshëm te i adresuari. Ndonjëherë, kjo është në përputhje me atë që ai pëlqen dhe nganjëherë, është në kundërshtim me dëshirat trupore të njeriut. Djajtë, në mesin e njerëzve, nuk kanë të drejtë të shfaqin tekat mbi Kur'anin dhe në emër të të kuptuarit personal të Kur'anit, ta interpretojnë në mënyrë spekulative Fjalën e Allahut. Ne do ta shtjellojmë këtë çështje në të ardhmen.

Sipas të dy kuptimeve të deklaruara, qenia e Kur'anit "një folës i heshtur", Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) përcjell mesazhin e tij për njerëzit dhe siguron prova, argumente të vërteta për myslimanët.

Në përshkrimin e Kur'anit të Shenjtë, në Ligjëratën 157, Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), thotë:

ذَلِكَ الْقُرْآنُ فَاسْتَنْتِظُوهُ، وَلَنْ يَطُوقَ، وَلَكِنْ أُخْبِرُكُمْ عَنْهُ: أَلَا لِي فِيهِ عِلْمٌ مَا يَأْتِي، وَالْحَدِيثُ عَنِ الْمَاضِي، وَدَوَاءٌ دَائِبِكُمْ، وَنُظْمٌ  
مَا يَنْتَعِمُ.

*“Ky është Kur’ani. Nëse ju i kërkoni atij të flasë, ai nuk do ta bëjë këtë. Do t’ju rrëfej rreth tij. Dijeni se ai përmban njohuri të asaj që do të ndodhë, histori të së kaluarës, kura për sëmundjet tuaja dhe rregullore për çdo gjë që ju do të përballeni.”*

Kur’ani është një oqean i dijes dhe i mësimit hyjnor. Vetëm ata që kanë lidhje me botën e padukshme mund të zhyten në thellësinë e tij të padepërtueshme dhe të marrin perlat që përsosin njeriun. Allahu i Lartësuar, gjithashtu, ka nxitur njerëzit të fitojnë njohuritë fisnike të Kur’anit me mbështetjen e hijeshisë, të njohurive, me ndihmesën dhe udhëzimet e të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe Imamëve të Udhëzimit, pasi shkencat e Kur’anit janë me Ehli Bejtin (*Paqja qoftë mbi ta!*). Si të tilla, fjalët e tyre janë ato të Kur’anit. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe Imamët e Pagabueshëm quhen “Kur’ani folës”-“Kur’ani Natik”.

Në përputhje me kriterin bazë të lartpërmendur, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), thotë: “Nëse ju i kërkoni Kur’anit të flasë, ai nuk do ta bëjë këtë.” Kjo do të thotë: Ky është Kur’ani dhe ja ku jeni edhe ju. Siç mund ta shikoni, pa shpjegimin e Imamëve të Pagabueshëm nuk mund ta shfrytëzoni Kur’anin! Këta Imamë të Pagabueshëm do t’jua interpretojnë dhe do t’jua shpjegojnë Kur’anin juve dhe do t’ju mësojnë njohuritë dhe shkencat e Kur’anit.

Pas këtyre vërejtjeve paraprake, Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), i qaset Kur’anit me një këndvështrim tjetër,

duke u bërë thirrje njerëzve t'i referohen dhe të reflektojnë mbi Kur'anin. Kjo do të thotë: Imami i Pagabueshëm supozohet të komunikojë njohuritë dhe shkencat e Kur'anit për myslimanët dhe Kur'ani, në vetvete, nuk mund të flasë, ndërsa njerëzit nuk janë të aftë të kapin direkt mesazhet hyjnore. Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), atëherë thotë: "Por unë do t'ju tregoj për të."

Kjo do të thotë: Unë do t'ju informoj për Kur'anin dhe do t'ju mësoj njohuritë dhe shkencat që kanë të bëjnë me të, në mënyrë që ju ta dini se çdo gjë që ju duhet, është në Kur'anin e Shenjtë. Dijeni se ai përmban njohuri të asaj që ka për të ndodhur në të ardhmen, historitë e të kaluarës, kura për sëmundjet tuaja dhe rregulloren për çdo gjë që ju do të përballeni.

Jeni ju ata që duhet të vendosni për çështjet tuaja, duke iu referuar Kur'anit të Shenjtë dhe njohurive të Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*).

### ***Përmendja e dy pikave***

Së pari, Kur'ani është dokumenti më i rëndësishëm historik për myslimanët dhe pasuesit e këtij libri hyjnor, sepse Kur'ani përmend ngjarjet historike dhe thotë diçka në lidhje me mendimet, besimet e popujve dhe komuniteteve të së kaluarës, si dhe për mënyrën e jetesës dhe fatin e tyre. Ai është dokumenti më i besueshëm dhe më bindës historik.

Në krahasim me librat historikë dhe shkrimet që u mungon vërtetimi kur'anor, edhe nëse ata janë raportuar me zinxhir të plotë transmetimi, vlera apo besueshmëria e tyre nuk e kalon atë të

Kur'anit. Kështu, historitë e profetëve dhe komunitetet e shkuara duhet të dëgjohen nga Kur'ani dhe mësimet e nxjerra prej tyre.

Duke iu referuar Kur'anit dhe duke studiuar të dhënat jetësore të komuniteteve dhe kombeve të shkuara, ne duhet të nxjerrim mësimet tona dhe të drejtojmë jetën tonë në rrugën e të vërtetës.

Së dyti, Kur'ani i Shenjtë jep, gjithashtu, informacione e parashikon të ardhmen. Natyrisht, të flasësh shkencërisht dhe me saktësi për të ardhmen, mundësohet vetëm nga Allahu i Lartësuar dhe nga ata që janë të informuar për të ardhmen, me urdhrin e Tij. Allahu është ai, për të cilin e kaluara, e tashmja apo e ardhmja nuk kanë kuptim dhe mund të flasë e të japë informacion për të ardhmen.

Allahu është ai që tregon qartë rrugën për robtë e Tij dhe u mëson atyre se si të sillen për të arritur suksesin e tyre. Është Kur'ani i Shenjtë që jep informacion në lidhje me të kaluarën dhe të ardhmen dhe i bën njerëzit të vetëdijshëm për to. Për këtë arsye, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) thotë: *"Ta dini se ai zotëron njohuri të asaj që do të vijë në të ardhmen dhe historitë e të kaluarës."*

### **Roli i Kur'anit në jetë**

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) e ka paraqitur Kur'anin si mjekimin universal për të gjitha problemet: *"Ai përmban një kurë për sëmundjet tuaja dhe rregulloret për çdo gjë që ju përballeni."* Ekzistenca e Kur'anit trajton të gjitha dhembjet dhe agonitë. Kjo recetë mjekësore duhet të lexohet dhe duhet të studiohet me kujdes dhe



njeriu duhet të njihet me mënyrën e kurimit të individëve dhe me sëmundjet sociale apo situatat e vështira.

Dihet se, para se të përjetosh dhe të identifikosh dhimbjen apo problemin, është jo normale të flasësh për kurën, sepse sëmundjet individuale dhe shoqërore, fillimisht duhet të identifikohen dhe duhet të njihen, duke studiuar në thellësi ajetet e Kur'anit të Shenjtë. Pastaj, duke vepruar në përputhje me këtë recetë mjekësore, duhet t'i shërojmë ato.

Sot, ka shumë probleme në shoqërinë tonë, individuale dhe shoqërore dhe të gjithë do të donin të shpëtojmë prej tyre. Pavarësisht përparimeve mahnitëse në fusha të ndryshme dhe përpjekjeve të mëdha që po bëhen, ende shumë probleme mbeten të pazgjidhura dhe autoritetet e interesuara po përpiqen t'i zgjidhin ato në një mënyrë ose në një tjetër.

Në Ligjëratën 189, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) thotë, me një ndryshim të vogël: "Kjo është një kurë, pas së cilës nuk ka sëmundje."

Çështja që duhet të merret parasysh, përpara çdo gjëje tjetër, është besimi në thënien e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*). Kjo do të thotë se ne duhet të besojmë sinqerisht se shërimi i vërtetë për sëmundjet sociale dhe problemet tona individuale gjendet te Kur'ani. Ne të gjithë e pranojmë këtë fakt, por njerëzit kanë shkallë të ndryshme besimi dhe sigurie.

Është e vërtetë se ka individë që sinqerisht besojnë se, nëse ata i referohen Kur'anit dhe veprojnë sipas njohurive dhe udhëzimeve të tij, kjo do të jetë një recetë e mirë mjekësore për të

gjitha sëmundjet. Megjithatë, njerëz të tillë janë shumë të paktë në numër dhe ndoshta një nga problemet më serioze të shoqërisë sonë është besimi i dobët në këtë drejtim. Kjo është arsyeja pse shumë probleme mbeten të pazgjidhura.

Ndoshta, disa individë mund të shtrojnë pyetjen: "Përkundër faktit se Kur'ani është në dispozicion dhe ne pretendojmë ta ndjekim atë, pse janë ende të pazgjidhura problemet tona dhe njerëzit vazhdojnë të vuajnë nga probleme ekonomike, si: inflacioni, çmimet e larta dhe mijëra probleme sociale e individuale, morale e kulturore?"

Le t'i përgjigjemi kësaj pyetjeje.

### ***Kur'ani, si burim universal i udhëzimit***

Kur'ani ka të bëjë me vendin e përjetshëm të njeriut dhe synon çlirimin dhe shpëtimin e tij në këtë botë dhe në Botën Tjetër. Kur'ani i Shenjtë na shpalos autostradën dhe rrugët kryesore që duhet të ndjekim, për të pasur një jetë të lumtur e të begatë. Këto mënyra të përgjithshme janë fanarë që orientojnë veprimet dhe lëvizjet tona.

Megjithatë duhet të theksohet se në arritjen e shpëtimit dhe të lumturisë në këtë botë dhe në Botën Tjetër, zgjidhjen e problemeve dhe vendosjen e një shoqërie të zhvilluar islame dhe në të njëjtën kohë fetare, Allahu i Lartësuar, e ka pajisur me dy mjete, d.m.th me fenë dhe me intelektin.

Kur'ani paraqet rrugët e përparimit njerëzor. Një shoqëri islame është e detyruar të krijojë terrenin për realizimin e qëllimeve të larta të Kur'anit, duke përdorur intelektin e njeriut dhe përvojën shkencore. Kur'ani i konsideron dijet dhe njohuritë si një burim hyjnor dhe nxit myslimanët t'i fitojnë ato nga kudo dhe kushdo që mundet, pavarësisht nëse është mysliman apo jomysliman. I Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u bëri thirrje myslimanëve të merrnin njohuri nga fusha të ndryshme studimi:

أَطْلُبُوا الْعِلْمَ وَكُونُوا بِالصَّيِّئِينَ.

*"Kërkoni diturinë, edhe në qoftë se ajo është në Kinë."*<sup>1</sup>

Kjo do të thotë: Kërkoni diturinë dhe shfrytëzoni përvojën shkencore të të tjerëve, edhe nëse kjo kërkon të udhëtoni në vende të largëta.

Në ditët e sotme, marrëdhëniet ndërkombëtare janë komplekse, dhe, duke përdorur produktet e eksperimenteve shkencore, vendet arrogante dhe fuqitë ekonomike dëshirojnë të forcojnë marrëdhëniet e tyre hegjemoniste.

Megjithatë, me mendjemprehtësi të madhe dhe pa bërë as kompromisin më të vogël në ndjekjen e objektivave tona islame dhe kur'anore, ne do të shfrytëzojmë arritjet shkencore të njeriut në fusha të ndryshme, për të përmirësuar kushtet tona ekonomike dhe për të zgjidhur problemet e përditshme të njerëzve.

---

<sup>1</sup> "Bihar El Anuar", vëll. 1, f. 177.

Për këtë arsye, Kur'ani nuk ka për qëllim të adresojë të gjitha problemet e mëdha dhe të vogla në jetën e njeriut. Më saktë, ai paraqet rrugët më të rëndësishme për të arritur lumturinë dhe përsosmërinë dhe u bën thirrje myslimanëve drejt tyre. Në përputhje me thënien e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) për fuqinë shëruese të Kur'anit, ne do të nxjerrim në pah një nga mënyrat e përgjithshme të nënkuptuara nga Kur'ani dhe do ta interpretojmë atë si një model.

### ***Një shembull i rrugëve të përgjithshme të Kur'anit***

Kur'ani i Shenjtë thotë:

وَلَوْ أَنَّ أَهْلَ الْقُرَىٰ آمَنُوا وَاتَّقَوْا لَفَتَحْنَا عَلَيْهِم بَرَكَاتٍ مِّنَ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ وَلَكِن كَذَّبُوا فَأَخَذْنَاهُم بِمَا كَانُوا يَكْسِبُونَ

**"Sikur njerëzit e atyre qyteteve të besonin dhe të ruheshin prej gjynaheve, Ne do t'u dërgonim atyre bekime nga qielli dhe Toka. Por, ata mohuan, prandaj i dënuam për atë që bënë."**<sup>1</sup>

Ky është një prej ajeteve të qarta të Kur'anit, në të cilin nuk ka asgjë alegorike. Kuptimi i tij është i qartë dhe i kuptueshëm. Nuk ka asnjë dyshim në të dhe në kuadrin gjuhësor vetëm një interpretim mund të nxirret nga ata që njohin gjuhën arabe.

Ky ajet përmban një nga udhëzimet e përgjithshme ideologjike dhe, në të njëjtën kohë, tregon një mjet për zgjidhjen e

<sup>1</sup> Sure "El A'raf", ajeti 96.

problemeve ekonomike dhe vështirësive në jetë. Ajeti fisnik e shpjegon shumë qartë, se zhvillimi ekonomik në jetën e besimtarëve, largimi i vështirësive ekonomike, zbritja e mirësisë hyjnore dhe në përgjithësi, përhapja e bekimeve nga qielli dhe Toka qëndron te besimi dhe besimi i thellë në Zot.

Në të kundërt, ajo e konsideron mosmirënjohjen dhe mohimin e begatave hyjnore si shkak të refuzimit të bekimeve dhe dërgimin e fatkeqësive dhe llojeve të ndryshme të problemeve. Ajo konsideron mirënjohjen dhe vlerësimin e favoreve si shkakun për më shumë begati e dhunti dhe mohimin e tyre, si ftesë për zemëratë.

Kur'ani thotë:

لَئِنْ شَكَرْتُمْ لَأَزِيدَنَّكُمْ وَلَئِنْ كَفَرْتُمْ إِنَّ عَذَابِي لَشَدِيدٌ

**"Nëse tregoheni mirënjohës, Unë, me siguri do t'ju shtoj më shumë begatitë e Mia; por nëse ju mohoni mirësitë e Mia, (atëherë dijeni se) ndëshkimi Im është i rëndë."**<sup>1</sup>

Këtu, unë do të tregoj për një nga bekimet e mëdha hyjnore, dhuruar kombit të madh të Iranit, për shkak të ndjekjes së Kur'anit të Shenjtë. Ne i lutemi Allahut për t'u dhënë njerëzve mundësinë për falënderime për to dhe ne kërkojmë mbrojtje te Allahu nga tërheqja prej nesh i këtij bekimi të madh për shkak të mosmirënjohjes.

---

<sup>1</sup> Sure "Ibrahim", ajeti 7.

## ***Manifestimi i mëshirës hyjnore në vendosjen e qeverisë islame***

Ne të gjithë e pranojmë se pas martirizimit të Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), dëshira më e madhe e të gjithë myslimanëve ka qenë krijimi i një qeverie të drejtë, në bazë të zbulësës dhe urdhëresave hyjnore. Për shumë vite në vijim, paraardhësit dhe të parët tanë u lutën për krijimin e një qeverie të tillë.

Ndërkohë që jetonim nën zgjedhën e tiranëve dhe të monarkëve dhe duke mos pasur rol të rëndësishëm në administrimin e punëve sociale, krijimi dhe vendosja e qeverisë islamike, dukej si një çështje idealiste, e porealizueshme dhe e pamundur.

Natyrisht, ne nuk synojmë të japim shpjegime e të vlerësojmë mangësitë apo të justifikojmë rezultatet. Përkundrazi, ajo që ne duam të theksojmë është se krijimi i këtij sistemi të shenjtë, me qëllim zbatimin e ligjeve dhe dekreteve hyjnore, është një nga hijeshitë e mëshirës hyjnore.

Tani, njëzet vite<sup>1</sup> pas fitores së Revolucionit Islamik, ajo që ka qenë shkak i shqetësimit dhe i ankthit nga mbështetësit e Revolucionit dhe mbrojtësit e vlerave fetare dhe morale, është humbja e besimit dhe e devotshmërisë ndaj Zotit në shoqëri dhe dobësimi gradual i vlerave fetare dhe revolucionare.

---

<sup>1</sup> Tani, ajo është gati tridhjetë vjeç.

Si rezultat i kësaj, armiqtë e Islamit dhe të Iranit mund të kenë sukses në zbatimin e planeve të tyre të sulmit kulturor dhe përsëri të sundojnë myslimanët e Iranit, duke armiqësuar njerëzit, veçanërisht të rinjtë, me vlerat fetare dhe revolucionare.

Në këtë moment, mund të lindë kjo pyetje: Çfarë duhet të bëhet, në mënyrë që vlerat ideologjike dhe fetare të shoqërisë të mund të ruhen, që armiqtë të dështojnë në zbatimin e planeve të tyre dhe të kapërcehen të gjitha problemet tona?

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), gjithashtu, i kushton vëmendje kësaj pike në Ligjëratën 157 të “Nehxhul Belagës” dhe paraqet mbështetjen në Kur’an dhe zbatimin e urdhëresave të Allahut, si mënyrë e zgjidhjes së problemeve individuale dhe sociale.

### ***Zgjidhja e problemeve sociale qëndron në ndjekjen e Kur’anit***

Thënia e Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) për këtë çështje është një parafrazim i thënies së çmuar të Profetit të Shenjtë të Islamit, Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*):

إِذَا التَّسَبَّحْتَ عَلَيْكَ الْفَتَنَ كَقَطْعِ اللَّيْلِ الْمُظْلِمِ فَعَلَيْكَ بِالْقُرْآنِ.

*“Sa herë që trazimet, shqetësimet, problemet, mungesa e stabilitetit dhe përçarjet hedhin një hije mbi shoqërinë tuaj, si nata e errët dhe ju nuk*

*bëni asnjë përparim në zgjidhjen e problemeve, duhet t'i referoheni Kur'anit dhe udhëzimet e tij t'i bëni bazë të veprimeve tuaja."*<sup>1</sup>

Urdhrat shpresëdhënëse që jep Kur'ani, ngjallin frymën e shpresës, të fitores kundër të gjitha mosmarrëveshjeve, të shpëtimit, të përparimit në zemrat tona dhe shpëton njerëzit nga mungesa e shpresës dhe dëshpërimi.

Natyrisht, çdo fitore varet nga vullneti dhe përpjekjet e qenieve njerëzore. Prandaj, në qoftë se ne duam të mbajmë të sigurt lirinë tonë dhe qeverinë islamike, nga çdo formë e komplotit, nën mbrojtjen e Allahut të Lartësuar, nuk ka asnjë mundësi tjetër veçse t'i drejtohem Zotit dhe dekreteve të shpëtimit të Kur'anit dhe të pendohemi për shkak të mosmirënjohjes dhe vulgaritetit të pasionit ekstrem ndaj gjërave, zakoneve të popujve të huaj<sup>2</sup> (*gharbzadeh-ha*) për vlerat fetare.

Është naivitete për ne të mendojmë se arroganca globale do të ndihmojë zyrtarët e Republikës Islamike të Iranit në çështjet që janë të dobishme për kombin mysliman të Iranit dhe jo në përputhje me interesat e tyre hegjemoniste.

Është, gjithashtu, një akt ekstrem i mosmirënjohjes për ne, të braktisim Kur'anin, këtë mrekulli të përjetshme (*mu'xhizah*) të të

---

<sup>1</sup>"Biharul Anuar", vëll. 92, f. 17.

<sup>2</sup> Ksenomaniakët: Të pasionuarit pas modeleve të kulturës së huaj, sidomos asaj perëndimore, euromania. Ky është përkthim i një termi në gjuhën persiane, "gharbzadegan" ose "gharbzadeh-ha", popullarizuar nga Xhelal El Ahmedi (d. 1969), shkrimtar me ndikim të madh. Vepra e tij është "Gharbzadegi"- "Ksenomania" ose "Oksidenti". Shiko përkthimin në anglisht, R. Campbell (trans.) dhe Hamid Algar (ed. dhe anno.), "Oksidentalizmi, një sëmundje epidemike nga Perëndimi" (Berkeley: Al-Mizan Press, 1984). (Përkthyesi)



Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), këtë sigurues të lumturisë dhe të shpëtimit dhe të kërkojmë ndihmën e armiqve për të zgjidhur problemet tona dhe të heqim dorë nga sundimi i juristit, që është zgjerimi i udhëheqësisë së të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe Imamëve të Pagabueshëm (*Paqja qoftë mbi ta!*) dhe të pranojmë sundimin dhe hegjemoninë e armiqve të Allahut. Njeriu duhet të kërkojë strehim te Zoti, nga dita kur kombi mysliman i Iranit do të pësonte zemërimin hyjnor, për shkak të mosmirënjohjes për bekimin e madh të pavarësisë, të nderit dhe të sigurisë dhe të hapë rrugën për gremisjen e poshtërimin e vet.

Në çdo rast, është detyrë e secilit anëtar të kombit, sidomos ata që janë përgjegjës për çështjet kulturore të vendit, për të ruajtur sferën e besimeve dhe vlerave fetare-morale të shoqërisë.

Ata që nuk kanë njohuri të mjaftueshme për fenë dhe janë nën ndikimin e ideve individualiste dhe prirjeve laike, në lidhje me deklaratën e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) mendojnë se kjo i referohet vetëm problemeve shpirtërore dhe morale të popullit.

Sipas mendimit tonë, sidoqoftë, ky mendim është i gabuar, sepse objekti i diskutimit i përfshin të dy, si problemet e sëmundjet individuale, ashtu edhe ato sociale. Duke deklaruar dhe duke parashtruar në deklaratën e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), ideja e pabazë e ndarjes së fesë dhe politikës, si dhe falsiteti i laicizmit bëhet i qartë.

## **Organizimi i çështjeve sociale, sipas udhëzimeve të Kur'anit**

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), thotë:

أَلَا لِمَنْ فِيهِ عِلْمٌ مَا بُئِيَ، وَالْحَدِيثُ عَنِ الْمَاضِي، وَدَوَاءٌ دَائِكُمْ، وَتَنْظِمٌ مَا يَنْتَكُمُ.

*"Dijeni se ai zotëron njohuri të asaj që do të ndodhë, histori të së kaluarës, kura për sëmundjet tuaja dhe rregullore për gjithçka me të cilën do të përballeni."*<sup>1</sup>

Pas deklarimit se Kur'anit përmban njohuri për të kaluarën dhe të ardhmen dhe se ai është zgjidhja për të gjitha sëmundjet, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) e përmend këtë pikë: "... rregullore për çfarëdo që do të përballeni."

Kjo do të thotë: Sistemi apo mënyra e vendosjes së drejtësisë për çështjet tuaja është në Kur'an. Ky Libër qiellor përcakton marrëdhëniet tuaja sociale.

Në shpjegimin e kësaj thënieje të shkurtër nuk kemi mendim tjetër, por të bëjmë vërejtje të shkurtra paraprake.

Objektivi më i madh i çdo sistemi social-politik është ruajtja dhe siguria e rendit shoqëror. Nuk ka asnjë shkollë politike të mendimit në botë që kundërshton një objektiv të tillë. Në fakt, ruajtja e rendit dhe e sigurisë është një nga detyrat kryesore të çdo qeverie. Gjithashtu, mund të thuhet se krijimi i rendit social-politik

---

<sup>1</sup> "Nehxhul Belaga", Ligjërata 157.

është ndër objektivat e shkencave politike, ashtu si çdo sistem politik në botë e deklaron këtë, të paktën në parullat dhe në propagandën e tyre, si një nga objektivat kryesore të saj.

### ***Roli i një objektivi në jetën shoqërore***

Në këtë pikë, roli i një objektivi në jetën sociale, gjithashtu, duhet të përmendet, sepse pa të nuk mund të flasim për rendin shoqëror. Është pikërisht objektivi, që, logjikisht, dikton veprime të caktuara. Duke kryer veprime të caktuara në jetën sociale, individët duan ta arrijnë këtë objektiv. Në një kuptim, objektivi, gjithashtu, vjen nga shoqëria, pasi çdo shoqëri miraton një rend të veçantë shoqëror, në përputhje me statusin fillestar në linjë me kulturën dhe mendimin e saj.

Kështu, në përputhje me politikat e tyre hegjemoniste, fuqitë perandorake përpiqen të shtyjnë vendet drejt qëllimeve të tyre imperialiste, t'i bëjnë këto vende, të huaja për kulturën e tyre origjinale dhe të kontrollojnë kulturën dhe rendin e tyre shoqëror, duke imponuar një kulturë të importuar.

Prandaj, duhet të shihet se çfarë rendi shoqëror, çfarë kulture dhe mendimi deklaron shoqëria. Natyrisht, kultura fetare që ka origjinën nga Kur'ani dhe botëkuptimin monoteist, miraton rendin shoqëror që ruan realizimin e qëllimit të krijimit dhe sigurimin e lumturisë së njeriut dhe shpëtimin në këtë botë dhe në Botën Tjetër. Në thelb, shqetësimi i Islamit dhe i Kur'anit, është shpëtimi dhe përsosja e njeriut.

Është me të vërtetë e dhimbshme, që disa "intelektualë" dhe liberalë, të cilët janë myslimanë, por nuk kanë njohuri të mjaftueshme për parimet social-politike të Islamit, dhe vështirë se kanë ndonjë shqetësim apo interes fetar, nuk janë në dijeni të kësaj çështjeje themelore. Sa herë që ata flasin për rendin shoqëror, i referohen rendit shoqëror që rrjedh nga demokracia perëndimore dhe ky rend shoqëror perëndimor buron nga mendimi i tyre laik.

Për shkak të njohjes së dobët të fesë, këta "intelektualë", mendojnë se, për të organizuar punët sociale dhe për të administruar në mënyrë sistematike shoqërinë, është e mundur vetëm me anë të ndarjes së politikës dhe fesë. Kjo, në vetvete, është një produkt i imperializmit kulturor dhe konsiderohet ndër sukseset e fuqive arrogante, të cilat, duke mpirë mendjet e të ashtuquajturve intelektualë të vendeve të Botës së Tretë, kanë qenë në gjendje t'i largojnë ata nga mendimi i tyre fetar, duke i kthyer në nxitës të kulturës imperialiste.

Në çdo rast, në kulturën islame apo monoteiste, çdo gjë, përfshi edhe rendin shoqëror, është vlerësuar në bazë të qëllimit të krijimit. Natyrisht, qëllimi i rendit shoqëror në kulturën fetare apo të Kur'anit nuk është vetëm për të siguruar mirëqenien materiale dhe interesat e kësaj bote. Përkundrazi, përsosja e njeriut dhe sukcesi i tij në Botën Tjetër, është marrë, gjithashtu, në konsideratë. Është e qartë se në rast konflikti, sukcesi në Botën Tjetër merr përparësi mbi çështjet e kësaj bote.

Tani, duke marrë në konsideratë sa thamë më sipër, ne do të shqyrtojmë dhe do të trajtojmë nga afër deklaratën e Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) për rolin e Kur'anit në sigurimin e rendit social-politik të shoqërisë, në mënyrë që të bëhen më të njohur me

këndvështrimin e udhëheqësisë, lidhur me rolin dhe pozitën e Kur'anit në jetën shoqërore.

Duke përdorur një shprehje befasuese, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) përmend rolin e Kur'anit në organizimin e punëve sociale të shoqërisë dhe tërheq vëmendjen që të mos e harrojmë atë. Pas thënies se Kur'ani është "*kura për sëmundjet tuaja*", Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) thotë: "*Kur'ani përmban rregullat për çfarëdo që të përballeni.*"

Kjo do të thotë: Sistemi i punëve dhe marrëdhëniet e tua janë në Kur'an. Me fjalë të tjera, nëse jeni duke kërkuar sistemin e dëshiruar dhe racional, nën patronazhin e të cilit të gjithë anëtarët e shoqërisë mund të gëzojnë të drejtat e tyre legjitime, ju duhet të rregulloni apo t'i zgjidhni çështjet tuaja sipas udhëzimeve të Kur'anit.

Nuk është sekret për ata që janë të informuar se shprehja "*... dhe rregullore për çdo gjë që ju do të përballeni*" i referohet çështjeve sociale dhe marrëdhënieve të individëve. Është e vërtetë se çdo individ është i detyruar që të organizojë punët e tij personale dhe private sipas udhëzimeve të Kur'anit, por shprehja "*... dhe rregullore për çdo gjë që do të përballeni...*", nuk përfshin çështjet personale të individëve.

Është e qartë për ata që dinë arabisht, se në deklaratën në diskutim, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) dëshiron të paraqesë dimensionet sociale të Kur'anit të Shenjtë.

Me fjalinë: "*Rendi juaj shoqëror është në Kur'anin e Shenjtë.*", Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) dëshiron t'u tregojë

myslmanëve dhe pasuesve të tij se ata duhet t'i organizojnë çështjet e tyre politike dhe marrëdhëniet shoqërore sipas Kur'anit.

Sigurisht, është e qartë se, për sa kohë që këto këshillime të deklaruar janë konsideruar jodetyruese, këshillimet morale nga zyrtarët e sistemit islam dhe nuk pranohen me gjithë zemër dhe nuk besohen nga ana e tyre, kjo recetë shërimi qiellor nuk do të kurojë ndonjë nga sëmundjet shoqërore të shoqërisë sonë. Duke përmendur pikat kryesore të politikës së sistemit fetar, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) zbulon të vërtetat, sipas të cilit është e pamundur për të realizuar një shoqëri njerëzore, të bazuar në drejtësi dhe barazi, ku të gjithë individët gëzojnë të drejtat e tyre dhe arrijnë përsosmërinë e dëshirueshme.

Prandaj, faktori më themelor dhe më i rëndësishëm është besimi, besimi ose bindja e zyrtarëve dhe i autoriteteve qeveritare në thënien e përgjithshme dhe te parimet e Kur'anit të Shenjtë. Për sa kohë që ata nuk kanë besim të sinqertë dhe bindje të fortë në Kur'an, në efikasitetin e udhëzimeve të tij, në zgjidhjen e problemeve të shoqërisë dhe në sigurimin e lumturisë së njeriut, jo vetëm nuk e marrin Kur'anin si model në praktikë, por, gjithashtu, ata nuk duan ta kuptojnë Kur'anin.

Natyrisht, ata mbretërojnë mbi popullin mysliman në një vend islamik, me fjalë se gjoja mund të quajnë veten dhe qeverinë e tyre një qeveri islamike, vetëm për të ruajtur pozitën e tyre në sytë e njerëzve të tyre dhe myslimanëve të tjerë. Modeli i vetëm qeverisës, i cili nuk diskutohet nga ana e tyre, është qeveria në bazë të ligjeve të Islamit dhe e modeluar sipas Kur'anit.

Megjithatë, ky tjetërsim i të ashtuquajturave shtete islamike nga feja dhe kultura kur'anore, veçanërisht në lidhje me politikën dhe administrimin e shoqërisë, nuk është diçka e panjohur për myslimanët, sepse ata e dinë se sistemet qeverisëse në vendet e tyre përkatëse nuk janë islame dhe kultura dhe mendimi i zyrtarëve qeveritarë është krejtësisht e ndryshme nga mentaliteti dhe modeli i bazuar mbi kulturën kur'anore.

Ajo që është e habitshme dhe e çuditshme për njeriun dhe në të njëjtën kohë, një shkak i shqetësimit dhe i keqardhjes, është gjendja kulturore mbizotëruese në vendin tonë të dashur islamik të Iranit, vendit ku revolucioni, në bazë të udhëzimeve të Kur'anit dhe kulturës fetare dhe nën udhëheqjen e *Pushtetit të Juristit*, është paraqitur me sukses.

Është me të vërtetë për të ardhur keq dhe një çështje brengosëse që deklaratat, qëndrimet dhe veprimet e disa zyrtarëve të kulturës, tregojnë se ata nuk kanë njohuri të mjaftueshme të këtij Libri të Shenjtë dhe nuk e konsiderojnë efikasitetin e modelit qeverisës që rrjedh nga ajo si më shumë se çdo shembull lindor apo perëndimor. Ata, në vazhdimësi, largohen nga parimet e Revolucionit Islamik dhe nga vlerat fetare.

Për shkak të mungesës së besimit të fortë dhe besimit të vërtetë, në mënyrë të nënkuptuar apo të drejtpërdrejtë, ata, paturpësisht, shprehin se koha e pavarësisë së Kur'anit dhe e shërbimeve të kulturës fetare në fushën e qeverisjes ka kaluar dhe sot shoqëria njerëzore nuk ka nevojë për shpalljen hyjnore, pasi ajo, në mënyrë të pavarur, mund të paraqesë mënyra më të mira për administrimin e shoqërisë dhe ruajtjen e rendit dhe të sigurisë.

Në këtë moment, është e nevojshme të dalë në pah natyra shtypëse e sistemeve ekzistuese të pushtetit në botë, tragjeditë dhe krimet e kryera kundër kombeve, në emër të sistemeve të qytetëruara, në mënyrë që të vëmë në dukje, më shumë se kurrë, mendimin e pabazuar, të përmendur, mosbesimin dhe vetëdisfatizmin e përkrahësve të tij.

Megjithatë, në mënyrë që të mos dalim nga tema kryesore dhe për të shmangur zgjatjen e diskutimit, ne nuk do të përmendim padrejtësitë ekzistuese, shkeljet e të drejtave të njeriut, shtypjet, krimet dhe pasigurinë në sistemet e bëra nga njeriu dhe do t'u referohemi referencave përkatëse.

Është e qartë se dobia e qeverisë, bazuar në udhëzime e Kur'anit, për vendosjen e drejtësisë, të barazisë dhe të rendit në shoqëri, do të shfaqet, me kusht që zyrtarët dhe autoritetet qeveritare të besojnë në të dhe të respektojnë vërtet ligjet dhe udhëzimet e Kur'anit. Nëse nuk ndodh kështu, Kur'ani nuk mund të sundojë mbi shoqërinë.

Për këtë arsye, sundimi i Kur'anit në shoqëri varet nga besimi i vërtetë dhe besimi i zyrtarëve të qeverisë në këtë Libër të Shenjtë, që varet nga njohuritë e tyre për këtë recetë hyjnore kurimi dhe të kuptuarit e nevojës për fenë dhe qeverisjen hyjnore. Gjithashtu, kjo ndjenjë nuk do të arrihet, veçse duke gjeneruar frymën e nënshtrimit ndaj Zotit dhe duke u çliruar prej sensit të arrogancës dhe megalomanisë, për sa i përket sovranitetit të Allahut të Lartësuar. Kjo ndjenjë e arrogancës është e njëjta ndjenjë e mosmirënjohjes që hodhi poshtë djallin nga pozicioni i afërt me pozitën engjëjlore dhe afërsinë ndaj Zotit dhe iu nënshtrua shkatërrimit të përjetshëm.



Në këtë pikë, është e përshtatshme për ne, që t'i kushtojmë kujdes kohës për diskursin e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), në Ligjëratën 175 të "Nehxhul Belagës", që përmend pasojat e pakëndshme të largimit nga Kur'ani i Shenjtë.

Ky ligjërim është një paralajmërim për ata që, nga njëra anë, e paraqesin veten si ndjekës të Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe nga ana tjetër, e konsiderojnë Kur'anin dhe modelin e qeverisjes që rrjedh prej tij, si të pamjaftueshëm për administrimin e shoqërisë së sotme njerëzore dhe pëlqejnë sisteme të mangëta të qeverisjeve njerëzore në vend të qeverisjeskur'anore. Shpresohet që në dritën e udhëzimeve, të gjithë anëtarët e shoqërisë sonë, veçanërisht vendimmarrësit dhe zyrtarët e qeverisë, të kenë besim të fortë në qendërsinë e Kur'anit në shoqërinë islame dhe të vënë sinqerisht udhëzimet e tij në praktikë.

### ***Pavarësia qëndron në ndjekjen e Kur'anit***

Në Ligjëratën në fjalë, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), e përshkruan Kur'anin e Shenjtë si një tregues, duke thënë:

وَاعْلَمُوا أَنَّهُ هَذَا الْقُرْآنُ هُوَ النَّاصِحُ الَّذِي لَا يَغْتُشُّ، وَالْهَادِي الَّذِي لَا يُضِلُّ، وَالْمُحَدِّثُ الَّذِي لَا يَكْذِبُ، وَمَا جَالَسَ هَذَا الْقُرْآنَ أَحَدًا إِلَّا قَامَ عِنْدَهُ بِزِيَادَةٍ أَوْ نُقْصَانٍ: زِيَادَةٌ فِي هُدًى، أَوْ نُقْصَانٍ مِنْ عَمَى

*"Dijeni se Kur'ani është me të vërtetë një këshilltar, që kurrë nuk gënjen, një prijës, që kurrë nuk mashtron dhe kurrë nuk të largon nga udha e drejtë, si dhe një transmetues, që kurrë nuk thotë gënjeshtër. Askush nuk do të ulet pranë Kur'anit, por, se, kur ai të ngrihet, do të arrijë një shtim*

ose një reduktim, shtesë në drejtimin e tij, ose në zhdukjen e verbërisë së tij (shpirtërore)."<sup>1</sup>

Pastaj, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), thotë:

وَاعْلَمُوا أَنَّهُ لَيْسَ عَلَى أَحَدٍ بَعْدَ الْقُرْآنِ مِنْ فَاقَةٍ، وَلَا لِأَحَدٍ قَبْلَ الْقُرْآنِ مِنْ غِنَى، فَاسْتَشْفُوهُ مِنْ أَدْوَابِكُمْ، وَاسْتَعِينُوا بِهِ عَلَى لَأَوْلَائِكُمْ، فَإِنَّ فِيهِ شِفَاءً مِنَ أَكْبَرِ النَّاسِ، وَهُوَ الْكُفْرُ وَالنِّقَاطُ، وَالنَّعْيُ وَالضَّلَالُ.

*"Ju duhet të dini se askush nuk do të kërkojë ndonjë gjë tjetër pas (udhëzimit nga) Kur'ani dhe askush nuk do të jetë i lirë nga mungesa para (udhëzimit prej) Kur'anit. Prandaj, kërkonin një kurim prej tij, për sëmundjet tuaja dhe lypni ndihmesën e tij në pikëllimet tuaja. Ai zotëron një kurë për sëmundjet më të mëdha, përkatësisht: mosbesimin, hipokrizinë, neverinë dhe largimin nga drejtimi i gabuar."*<sup>2</sup>

Kjo do të thotë: Me ekzistencën e Kur'anit dhe me sundimin e tij mbi shoqërinë, asnjë nevojë nuk do të mbetet e pazgjidhur për të gjithë, sepse Kur'ani i Shenjtë është programi më sublim hyjnor për jetën e monoteistëve dhe Allahu i Lartësuar ka siguruar nderimin në këtë botë dhe shpëtimin në Botën Tjetër për ndjekësit e këtij Libri të Shenjtë. Prandaj, duhet që shoqëria jonë islame të veprojë në përputhje me porositë, urdhëresat e udhëzimet rivitalizuese të Kur'anit dhe ta marrin atë si modelin e tyre të sjelljes. Duke pasur besim në vërtetësinë e premtimeve të tij, do të zgjidhen nevojat individuale dhe shoqërore, materiale dhe shpirtërore të shoqërisë dhe, si rrjedhim, shoqëria islame të mos ketë nevojë për asgjë dhe askënd.

<sup>1</sup> "Nehxhul Belaga", Predikim 175.

<sup>2</sup> Po aty.

Në të kundërt, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) thekson rrezikun e largimit nga Kur'ani. Ai hedh poshtë idenë se pa Kur'anin, peshën e madhe (*thikl al-akbar*), njeriu mund të zgjidhë problemet individuale dhe sociale të shoqërisë. Midis të tjerash, thotë: *"Askush nuk do të jetë i lirë nga nevoja e (udhëzimit nga) Kur'anit dhe për shoqërinë, Kur'ani kurrë nuk do jetë i panevojshëm."*

Kjo do të thotë: Në formimin e një shoqërie të bazuar në drejtësi, barazi dhe vlera të tjera morale, edhe në qoftë se të gjitha mësimet dhe përvojat njerëzore janë vënë në zbatim dhe të gjitha idetë dhe mendimet janë zbatuar, gjithashtu, në mungesë të Kur'anit, njeriu nuk do të drejtohej askund.

Kjo është për shkak se pa Kur'anin, njeriu e ka të pamundur të bëhet i pavarur dhe i vetëplotësuar. Në lidhje me këtë çështje, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), thotë: *"Prandaj, kërkoni një kurë prej tij për sëmundjet tuaja dhe kërkoni ndihmën e tij, kur jeni në ankth dhe fatkeqësi."*

Pastaj, duke përmendur sëmundjet më të rënda individuale dhe sociale: mosbesimin, hipokrizinë dhe shmangien, ai thotë se mjetet e shërimit të këtyre gjendjeve dhe sëmundjeve ekzistojnë në Kur'an dhe mund të gjendet shërim për këto gjendje dhe sëmundje duke iu referuar Kur'anit.

Prandaj, parimet e përgjithshme dhe rrugët kryesore duhet të mësohen nga Kur'ani dhe problemet zgjidhen duke ndjekur këto parime të përgjithshme dhe duke përfituar nga përvojat, nga reflektimi dhe nga të menduarit. Në qoftë se ne synojmë të zgjidhim problemet brenda kësaj kornize, patjetër do të kapërcejmë të gjitha

mosmarrëveshjet, në të gjitha aspektet, sepse ky është premtimi hyjnor.

Allahu i Lartësuar thotë:

وَمَنْ يَتَّقِ اللَّهَ يَجْعَلْ لَهُ مَخْرَجًا

"Dhe kushdo që i frikësohet Allahut, Ai do të gjejë rrugëdalje (nga çdo vështirësi)."<sup>1</sup>

### ***Kur'ani, ilaçi çudibërës për sëmundjet më të rënda***

Thënia e mësipërme nuk është e pëlqyeshme për arrogantët dhe për ata që kanë besim të dobët tek Allahu, që kanë njohje të pamjaftueshme rreth Kur'anit dhe Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*), dhe që kanë disa njohuri të shkencave njerëzore.

Gjithsesi, çdo person racional pranon se, në krahasim me injorancën e tij, të gjitha përparimet befasuese shkencore të njeriut janë vetëm një pikë në oqean dhe të gjitha pretendimet e filozofitë ateiste morale, në prezantimin e modelit të një qyteti të virtytshëm, nuk janë asgjë në krahasim me dijen e pafund hyjnore të shkencave të Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*), që zënë fill dhe burojnë nga frymëzimi hyjnor.

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) konsideron mosbesimin (*kufri*), hipokrizinë (*nifakut*) dhe shmangien (*dhalal*) si sëmundjet më të këqija të shoqërisë njerëzore. Këto sëmundje e bëjnë shoqërinë

---

<sup>1</sup> Sure "El Talak", ajeti 2.

objekt të një sërë problemesh dhe vështirësish dhe kurimi i tyre mund të gjendet në Kur'an: *“Ai përmban një kurë për sëmundjet më të mëdha, përkatësisht mosbesimin, hipokrizinë, revoltën dhe shmangien.”*

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk nënkupton se Kur'ani, si një recetë mjekësore, shpjegon sëmundjet fizike dhe përshkruan një kurë për çdo sëmundje, ose ofron zgjidhje për të gjitha problemet ekonomike dhe ushtarake dhe përcakton formula që mund të përdoren në fushat e teknologjisë dhe të industrisë. Çdokush që ka njohuritë më të pakta të jetës në këtë botë, e di se problemet kërkojnë mjete dhe mënyrat e tyre përkatëse e të natyrshme.

Siç u tha më sipër, në zgjidhjen e këtyre problemeve, Kur'ani jep mënyrat e përgjithshme që mund të kuptohen dhe të ndiqen, duke përdorur intelektin e dhuruar nga Allahu, talentin dhe njohuritë e fituara në shkencat humane.

Në këtë pikë, më lejoni të tërheq vëmendjen e lexuesit të dashur për dy çështje:

E para: Shkaqet natyrore dhe faktorët fizikë kanë ndikim dhe rezultatet e tyre. Është e rëndësishme të theksohet se Shkaku i Parë i të gjitha dukurive është Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar. Ai ka krijuar sistemin e universit, duke u bazuar mbi marrëdhëniet shkak-pasojë dhe është Ai që siguron shkakësinë për shkaqet dhe faktorët. Pa vullnetin e Tij, asnjë “agjent” nuk mund të ketë pavarësi në rezultatin e veprimit të tij.

Prandaj, në shërimin e të gjitha sëmundjeve dhe zgjidhjen e të gjitha problemeve dhe vështirësive, ne duhet t'i drejtohem kryesisht Allahut të Lartësuar dhe të shpresojmë tek Ai. Është e

vërtetë se në zgjidhjen e problemeve dhe në shërimin e sëmundjeve, ne mbështetemi te burimet natyrore, por siç kërkohet nga monoteizmi, shërimi dhe zgjidhja e problemeve, në thelb, duhet të pritet dhe të konsiderohet se vjen nga Allahu.

Pika e dytë: Rruga e zgjidhjes së problemeve dhe shërimi i sëmundjeve nuk duhet të konsiderohet vetëm në varësi të shkaqeve natyrore dhe zgjidhjeve fizike. Është e gabuar të mendosh se, në mungesë të shkaqeve natyrore dhe faktorëve fizikë, ose joefikasitetin e tyre në zgjidhjen e problemeve, është e pamundur të zgjidhet një problem, të marrësh veten nga një sëmundje, të kurosh sëmundjet, apo të përmbushësh çdo kërkesë të ligjshme dhe të drejtë të njeriut.

Duke krijuar sistemin e shkakut dhe të pasojës, Allahu i Lartësuar, nuk e ka kufizuar Vetën nga aftësitë për të krijuar dukurinë përmes një mënyre të panatyrshme. Përkundrazi, përparësia e Allahut është se fillimisht punët drejtohen me anë të agjentëve natyrorë, por nuk janë të kufizuar vetëm tek agjentët natyrorë. Në fakt, shumë shpesh, Zoti i krijoi gjërat me anë të mënyrave të panatyrshme dhe kjo mund të quhet përparësi hyjnore.

Shërimi apo trajtimi i një sëmundjeje, ndoshta mund të bëhet përmes mënyrave natyrore dhe trajtimit mjekësor, apo në rrethana të veçanta, përmes mënyrave të panatyrshme të tilla, si lutjet e Imamëve të Pagabueshëm, ose të dërguarve të Allahut (*Paqja qoftë mbi ta!*). Në të njëjtën mënyrë, luftëtarët e monoteizmit, të cilët, nga këndvështrimi i pajisjeve materiale, ishin të destinuar të pësonin disfatë nga armiku në fushën e betejës, dolën fitimtarë, për shkak të

ndihmës së fshehtë dhe shkaqeve të panatyrshme. Raste të tilla mund të konsiderohen si pjesë e shkaqeve dhe faktorëve hyjnorë.

Kur'ani i Shenjtë ka transmetuar ngjarje që kanë ndodhur në rrugë të panatyrshme. Për shembull, që të bjerë shiu, në përputhje me kursin dhe faktorët natyrorë, ujërat e deteve dhe të oqeaneve duhet të avullojnë dhe të kthehen në re. Pastaj, për shkak të ndryshimit të temperaturave midis detit dhe tokës, era ka prirje të shpërndajë retë në pjesët e tjera të tokës, derisa pikat e ujit në re bien në formën e shiut, të dëborës ose të breshrit.

Të presësh shi pa shkaqet natyrore dhe faktorët, në bazë të këndvështrimit shkencor, quhet e paarsyeshme dhe e kotë. Megjithatë, pa marrë parasysh faktorët natyrorë të shiut, Profeti Nuh (Noah) (*Paqja qoftë mbi të!*) i drejtohet komunitetit të tij (*Kaum*) dhe i nxit të pendohen dhe të kërkojnë falje, në mënyrë që qielli t'u zbresë shiun:

وَيَا قَوْمِ اسْتَغْفِرُوا لَكُمْ ثُمَّ تُوْبُوا إِلَيْهِ يُرْسِلِ السَّمَاءَ عَلَيْكُمْ مِدْرَارًا وَيُرْدِكُمْ قُوَّةً إِلَى قَوْمِكُمْ وَلَا تَتَوَلَّوْا مُجْرِمِينَ

**"O populli im! Kërkoni falje Zotit tuaj dhe kthehuni tek Ai të penduar se Ai do t'ju sjellë shi të begatshëm nga qielli, dhe do t'ju shtojë fuqi mbi fuqinë tuaj (të tanishme). Pra, mos u shmangni prej (Tij) duke qenë keqbërës."**<sup>1</sup>

Është e vërtetë se shkaqet dhe faktorët natyrorë të shiut dhe i tërë sistemi shkak-pasojë, që rregullon natyrën, janë të gjitha nën pushtetin hyjnor dhe vullnetin e Zotit, por pa marrë parasysh ato, Allahu i Lartësuar, u thotë njerëzvetë kërkojnë falje për gjynahet

<sup>1</sup> Sure "Hud", ajeti 52.

dhe të kthehen te Zoti i tyre. Nga ana tjetër, Ai do t'ju sjellë shi me bollëk nga qielli.

Dikush, ndoshta, mund të thotë se Allahu i Lartësuar nuk nënkupton se pa praninë e shkaqeve natyrore nuk do të ketë shi, përkundrazi, kjo do të thotë se Ai do sjellë shi për ne me ndihmën e shkaqeve natyrore. Përgjigjja është se ky nocion është në kundërshtim me pikëpamjen monoteiste, sepse siç është thënë më parë, duke krijuar sistemin e shkakut dhe të pasojës, Allahu i Lartësuar, nuk e bën Vetën të paaftë të krijojë dukuri pa shkaqe dhe faktorë natyrorë. Lidhur me fuqinë e Tij, në krijimin dhe sjelljen e dukurive në ekzistencë, Allahu thotë:

إِنَّمَا أَمْرُهُ إِذَا أَرَادَ شَيْئًا أَنْ يَقُولَ لَهُ كُنْ فَيَكُونُ

"Vërtet, urdhri i Tij, kur Ai dëshiron diçka, është që t'i thotë asaj: "Bëhu! - dhe ajo bëhet."<sup>1</sup>

### ***Urtësia pas disa fatkeqësive***

Përveç temës së mësipërme, nganjëherë urtësia e Allahut të Lartësuar kërkon që Ai të japë bekimet mbi robërit e Tij me anë të mënyrave të panatyrshme. Duke vepruar kështu, Ai krijon faktorë të ndryshëm nga ato të njohura, si faktorë fizikë për njerëzit që meritojnë mëshirën e Tij. Sistemi i krijimit është ancoruar në dituri, urtësi dhe qëllimi i krijimit të njeriut, është udhëzimi dhe përsosmëria.

---

<sup>1</sup> Sure "Ja Sin", ajeti 82.



Udhëzimi dhe përsosmëria mund të arrihen me anë të dijes, reflektimit mbi ajetet hyjnore, nënshtrimin dhe të vepruarit sipas urdhrave të profetëve dhe fesë së vërtetë. Megjithatë, ndonjëherë, njerëzit largohen nga rruga e të vërtetës për shkak të gjynaheve dhe keqbërjes. Zakonisht, kur qeniet njerëzore janë materialisht mirë dhe ekonomikisht të pasur, ata tregojnë më pak vëmendje ndaj Allahut dhe shpirtërores. Në atë rast, cilësitë e tyre njerëzore dhe hyjnore do të zbehen dhe më në fund zhduken.

Si rezultat, lind terreni për paturpësinë, mosbesimin, devijimin dhe dështimin.

Kur'ani thotë:

كَلَّا إِنَّ الْإِنْسَانَ لِرَبِّهِ لَكَنَّاظٍ \* أَن رَّآهُ اسْتَفْتَىٰ

**"Me të vërtetë njeriu kalon çdo cak, kur mendon se është i vetëmjaftueshëm."**<sup>1</sup>

Nëse shpirti i shumicës në një shoqëri është ai i arrogancës dhe i paturpësisë, mëshira hyjnore kërkon që Ai t'i paralajmërojë njerëzit, në një mënyrë ose në një tjetër, dhe t'i zgjojë ata nga gjumi i shkujdesjes, për t'i sjellë përsëri në rrugën e të vërtetës dhe nënshtrimin ndaj Allahut. Për të realizuar këtë, Ai nganjëherë u sjell fatkeqësi atyre në format e varfërisë dhe të urisë. Njëkohësisht, ai paraqet pendimin, duke kërkuar faljen e gjynaheve dhe duke u kthyer tek Ai me anë lutjesh dhe përgjërimesh, për të larguar fatkeqësitë, në mënyrë që më në fund, qëllimi i krijimit, që nuk

---

<sup>1</sup> Sure "El Alak", ajetet 6-7.

është gjë tjetër përveç dëshirës së vullnetshme për përsosmëri të njeriu, të mund të realizohet.

Ky proces, është, gjithashtu, një nga shembujt apo modelet mahnitëse të Allahut. Ai nganjëherë dërgon një profet dhe e nënshtron komunitetin e tij me mundime dhe vuajtje, në mënyrë që ata të mos bëhen të pavëmendshëm ndaj Tij dhe ndaj rrugës së të vërtetës dhe të mbrohen nga shkatërrimi prej kënaqësive materiale.

Në kushte të vështira, njerëzit kuptojnë nevojat e tyre shpirtërore dhe janë më të prirur për të pranuar të vërtetën dhe mësimet e profetëve, në krahasim me kohën kur ata janë në kushte të mira.

Kur'ani thotë:

وَمَا أَرْسَلْنَا فِي قَرْيَةٍ مِّن نَّبِيٍّ إِلَّا أَخَذْنَا أَهْلَهَا بِالْبَأْسَاءِ وَالضَّرَاءِ لَعَلَّهُمْ يَضَّرَّعُونَ

**"Sa herë që çonim të Dërguar në ndonjë vendbanim, Ne i dënonim banorët e tyre me skamje dhe sëmundje, në mënyrë që ata të përuleshin (para Allahut)."**<sup>1</sup>

Ajetet 75 dhe 76 të sures "Mu'minun", gjithashtu, shpjegojnë këtë temë:

وَأَلَوْ رَحِمْنَاهُمْ وَكَشَفْنَا مَا بِهِم مِّن ضُرٍّ لَلْجَوَا فِي طُغْيَانِهِمْ يَعْمَهُونَ \* وَلَقَدْ أَخَذْنَا لَهُم بِالْعَذَابِ فَمَا اسْتَكَاثُوا لِلزَّبَابِ وَمَا يَنْصُرُعُونَ

**"Sikur Ne t'i mëshironim ata dhe t'ua largonim fatkeqësitë, sërish ata do të endeshin të hutuar në humbjen dhe**

<sup>1</sup> Sure "El A'raf", ajeti 94.

**në mosbesimin e tyre. Ne i dënuam ata njëherë, por ata nuk iu pëkulën Zotit të tyre dhe as nuk i drejtuan lutje (për mëshirë).<sup>1</sup>**

Prandaj, filozofia, pas disa mundimeve dhe vështirësive, është për t'i zgjuar njerëzit dhe t'i bëjë ata t'i kthehen rrugës së udhëzimit, edhe pse është e mundur që këto fatkeqësi të mos zgjojnë disa komunitete, pasi ata janë kokëfortë në shmangien e tyre. Në këtë rast, udhëzimi (*huxhati*) është konsumuar për ta dhe ata duhet të pranojnë përgjegjësinë për fatkeqësinë e sigurt që do t'i japë fund jetës së tyre.

Në ajetet 42 deri 44 të sures "El En'am", Kur'ani i drejtohet Profetit të Islamit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kështu:

وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا إِلَىٰ أُمَمٍ مِّن قَبْلِكَ فَأَخَذْنَاهُم بِالْبَأْسَاءِ وَالضَّرَّاءِ لَعَلَّهُمْ يَتَضَرَّعُونَ \* قُلُوبًا إِذْ جَاءَهُمْ بَأْسُنَا تَضَرَّعُوا وَلَكِنْ قَسَتْ قُلُوبُهُمْ وَزَيَّنَ لَهُمُ الشَّيْطَانُ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ \* فَلَمَّا نَسُوا مَا ذُكِّرُوا بِهِ فَتَحْنَا عَلَيْهِمُ أَبْوَابَ كُلِّ شَيْءٍ حَتَّىٰ إِذَا فَرِحُوا بِمَا أُوتُوا أَخَذْنَاهُم بَغْتَةً فَإِذَا هُمْ مُبْلِسُونَ

**"Ne u kemi dërguar shumë popujve profetë para teje dhe i kemi dënuar ata me skamje dhe fatkeqësi, për t'u bërë të dëgjueshëm. Vetëm sikur të përuleshin, kur u erdhi ndëshkimi Ynë! Por zemrat e tyre u bënë gur, ndërsa djalli ua paraqiste si të bukura veprat e tyre të këqija. Kur ata i harruan paralajmërimet Tona, Ne ua hapëm dyert e çdo mirësie. Por, sapo gëzoheshin me atë që u dhamë, Ne i dënuam befasisht dhe atëherë ata u zhytën në dëshpërim."**

Duhet të dimë se ky ka qenë modeli i Allahut (*Sunnati Allahu*) në lidhje me komunitetet e shkuara dhe umeti i të Dërguarit

<sup>1</sup> Sure "El Mu'minun", ajetet 75-76.

të fundit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk është një përjashtim për të.

Për njerëzit me njohuri dhe maturi, fatkeqësitë, problemet dhe vuajtjet veprojnë si kujtesë dhe nxitje të udhëzimit. Siç është thënë nga Kur'ani, ka, gjithashtu, njerëz që janë të pavëmendshëm dhe nuk do të zgjoheshin nga ndonjë paralajmërim, alarm, kujtesë a nxitje dhe të vijnë në vete.

Është e rëndësishme t'i kushtojmë vëmendje filozofisë, pas ngjarjeve të tilla, të nxjerrim një mësim nga e kaluara, të pendo kemi dhe të kthehemi tek Allahu. Është me të vërtetë për të ardhur keq që në shoqërinë tonë vetëm disa i kushtojnë vëmendje kësaj çështjeje. Për shkak të kësaj shkujdesjeje apo për shkak të dobësismit të besimit, disa zyrtarë zgjasin duart e tyre diku tjetër përpos Allahut, duke u përpjekur të lehtësojnë veten nga vështirësi ekonomike të tilla, si thatësira apo vuajtjet nga uria.

Duke akorduar një buxhet të madh nga thesari publik, ata synojnë të krijojnë shiun, duke injektuar elemente kimike te retë. Çfarë kotësish! Është njohja e shkakut të shiut nga dalja e reve dhe shpërndarja e tyre me anë të erës dhe faktorë të tjerë të kufizuar që e bën njeriun fodull e arrogant, duke menduar se ai mund të prodhojë shi, sa herë që ai dëshiron dhe, në vend që të tërheqë vëmendjen e myslimanëve ndaj Zotit, mbështetjen dhe përdorimin e bamirësive të Tij për të mirën e tyre, ai kërkon dhe gjuan për një fragment të reve, ndërsa qëndron në majë të një mali, në mënyrë që ta mbarsë atë, si të themi, dhe kështu të prodhojnë shiun.

Meqë ra fjala, çështja e përmendur sjell ndër mend historinë e Profetit Nuh (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe djalit të tij. Pas shumë vitesh

ftese për të besuar, Profeti Nuh (*Paqja qoftë mbi të!*) u zhgënjye, pasi njerëzit e tij refuzuan të besojnë në Zot. Pasi humbi të gjitha shpresat për udhëzimin e tyre dhe duke qenë dëshmitar për shenjat e zemërimit hyjnor, ai i kërkoi djalit të tij që të besojë në Zot dhe të hipë në arkë, për të shpëtuar nga dënimi i përcaktuar. Në përgjigje të babait të tij, ai shprehu mendimin e tij ateist, në këtë mënyrë:

سَأُوِي إِلَى جَبَلٍ يَنْصُبِي مِنَ الْمَاءِ

**"Unë do të strehohem në një mal. Ai do të më mbrojë nga përmytjet."**<sup>1</sup>

Siç e dimë të gjithë, ai nuk besoi në Zot deri në momentin e fundit dhe u mbyt. Duke rrëfyer këtë histori, Allahu i Lartësuar, zbulon thelbin e mendimit ateist dhe i paralajmëron njerëzit për të.

Tani, ky mendim ateist ekziston, gjithashtu, në mesin e disa njerëzve, sidomos te intelektualët ksenomaniakë (njerëz pasionantë ndaj gjithçkaje të huaj). Në vend të besimit në Zot dhe tërheqjes së njerëzve drejt Tij, në fjalimet dhe shkrimet e tyre, ata presin dhe mbështeten në ndihmën e armiqve të Islamit në zgjidhjen e problemeve.

Është e njohur për ata që janë të informuar se nuk është qëllimi për të kundërshtuar përparimin e shkencave, arritjen e shkencave njerëzore, sepse Kur'ani dhe mendimi monoteist, më shumë se çdo shkollë tjetër e mendimit, u bën thirrje njerëzve për të mësuar dhe për të kërkuar dituri dhe të zbatojnë arritjet e mendimit dhe të ideve të njeriut. Në këtë moment, ajo që ne e

<sup>1</sup> Sure "Hud", ajeti 43.

kundërshtojnë prerë, është mendimi ateist. Për fat të keq, ata që e ndjekin këtë shkollë mendimi, nuk janë të paktë në shoqërinë tonë.

Në çdo rast, mënyra më e mirë dhe rruga më e shkurtër dhe më e sigurt e zgjidhjes së problemeve individuale dhe sociale është kthimi te Dera e Shtëpisë së Allahut, sepse ndjekja e rrugës së Allahut siguron shpëtimin tonë të përjetshëm dhe i largon problemet dhe vështirësitë tona.

فَقُلْتُ اسْتَغْفِرُوا رَبَّكُمْ إِنَّهُ كَانَ غَفَّارًا \* يُرْسِلِ السَّمَاءَ عَلَيْكُمْ مِدْرَارًا

**"Atëherë u thashë (atyre): 'Kërkoni falje Zotit tuaj. Me të vërtetë Ai është falës i madh. Ai do t'ju dërgojë shira të bollshëm nga qielli.'"**<sup>1</sup>

Prandaj, në mënyrë që të shmangim mangësitë dhe për të gjetur lehtësim nga problemet, Kur'ani propozon zgjidhje për pasuesit e tij dhe siguron efikasitetin e këtyre zgjidhjeve. Siç ka treguar shumë herë përvoja, myslimanët mund t'i provojnë ato.

Pa dyshim, fitorja e Revolucionit Islamik në Iran është një nga shembujt e mrekullueshëm të ndihmesës hyjnore dhe ndihmës së fshehur të Allahut për shoqërinë tonë islame. Kur tërë populli, duke u mbështetur te Zoti dhe duke refuzuar të varin shpresat e tyre për tjetër pos Tij, kërkuan një qeveri islamike, Allahu, në përputhje me premtimin e Tij në Kur'an: **"O besimtarë, nëse e ndihmoni Allahun, edhe Ai do t'ju ndihmojë juve dhe do t'ju bëjë të qëndroni fort në këmbët tuaja."**<sup>2</sup>, i bëri njerëzit fitimtarë

<sup>1</sup> Sure "Nuh", ajeti 10-11.

<sup>2</sup> Sure "Muhammed", ajeti 7.

mbi armiqtë e tyre, pavarësisht nga fuqia e regjimit monarkik 2500 vjeçar, mbështetur nga të gjithë armiqtë e Islamit.

Shembulli apo modeli i Allahut, që kur njerëzit kthehen tek Ai, do t'i ndihmojë ata, është ende i vërtetë. Pasi ata harrojnë Zotin, kërkojnë ndihmë nga të tjerë pos Tij dhe i kthejnë shpinën Atij, ata do të pësojnë zemërimin dhe poshtërimin.

Gjithsesi, nuk ka dyshim se Kur'ani i Shenjtë është receta e shërimit të Allahut dhe shpëtimi i njeriut në këtë botë dhe në Botën Tjetër qëndron në bindjen ndaj urdhrave ripërtëritëse. Mënyra e zgjidhjes së problemeve individuale dhe sociale duhet të kërkohej në të. Kur'ani, ky sigures i shpëtimin të njeriut, duhet të njihet, duhet të respektohet, duhet të nderohet dhe duhet të veprohet sipas urdhrave të tij. Gjithsesi, ka dy lloje respektesh që tregohen për Kur'anin, të cilat ne do të citojmë më poshtë.

### ***Respekti i vërtetë, i jashtëm, për Kur'anin e Shenjtë***

Respekti që tregohet për Kur'anin sot, në shoqëritë myslimane, mund të quhet respekt i jashtëm. Kur'ani nuk është shpallur për ne vetëm për t'u trajtuar me respekt në metodë dhe stil. Kur'ani nuk është vetëm për t'u mësuar përmendësh dhe për t'u recituar me një zë melodioz.

Kur'ani është libri i jetës dhe mesazhet e tij hyjnore duhet të ndiqen në jetën e njeriut, në mënyrë që të arrihet shpëtimi në këtë botë dhe në Botën Tjetër. Zyrtarë të qeverisjes në vendet myslimane janë veçanërisht të detyruar për organizimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme politike, në përputhje me udhëzimet e

këtij Libri Hyjnor, në mënyrë që të hapë rrugën për rritjen e një kulture të Kur'anit në mesin e anëtarëve të shoqërisë dhe, në këtë mënyrë, të kuptojnë qëllimin, pas shpalljes së Kur'anit, i cili nuk është gjë tjetër veçse përsosja dhe lumturia e njeriut nën bekimin e drejtësisë dhe të barazisë në botë.

Për fat të keq, domosdoshmëria e konsiderimit të Kur'anit si boshtin e jetës social-politike të myslimanëve, është lënë pas dore. Tani, institucionet, nga parashkollorët deri në nivelin universitar, në shumë vende myslimane, janë të angazhuara në mësimdhënien dhe mësimnxënien e Kur'anit të Shenjtë, mësim i përkushtuar në leximin, këndimin dhe mësimin përmendësh të Kur'anit, me anë të metodave të ndryshme.

Çdo vit, ne dëshmojmë konkurrime ndërkombëtare për memorizimin dhe recitimin e Kur'anit të Shenjtë. Shkencat e ndryshme të Kur'anit të tilla *tajvid/intonacion, tartil* dhe të tjera, zënë një vend të veçantë në mesin e atyre që janë të dhënë pas Kur'anit. Përveç kësaj, Kur'ani është mbajtur me nderim të lartë nga myslimanët, aq sa të mos prekin fjalët dhe ajetet e tij pa abdes dhe ulen me përlulësi për ta lexuar atë.

Shumë prej tyre nuk zgjasin këmbët përkundër një kopjeje të Kur'anit. Ata e mbulojnë atë me mbulesën më të mirë dhe e vendosin në kutinë më të bukur. Me pak fjalë, forma të tilla të jashtme të respektit ndaj Kur'anit janë të zakonshme në mesin e masave myslimane.

Zbatimi i formave të mësipërme të respektimit të këtij Libri Qiellor është një vlerë e domosdoshme. Nuk ka rëndësi se sa besnik jemi ndaj praktikave të tilla, ne nuk kemi treguar respektin e duhur



ndaj këtij Libri të Shenjtë dhe nuk kemi shprehur mirënjohjen e duhur për këtë bekim të madh të Allahut të Lartësuar, që është bekimi i udhëzimit.

Megjithatë, forma më e lartë e respektit dhe e mirënjohjes për çdo bekim është kuptimi i thelbit të tij dhe veprimi, ashtu si Allahu ka urdhëruar. Nganjëherë e konsiderojmë Kur'anin me këtë perspektivë dhe tregojmë respekt dhe nderim për të, del qartë se Kur'ani i Shenjtë nuk ka vendin e dëshiruar në kulturën e shoqërive myslimane dhe nuk tregohet respekti dhe nderimi i duhur për të.

Format e respektit ndaj Kur'anit të Shenjtë nga ana e myslimanëve janë të nevojshme, por, duke bërë kështu, qëllimi i Zotit të Plotfuqishëm në zbulimin e Kur'anit nuk është realizuar. Njohja me aspektet e jashtme të Kur'anit, duke lexuar ajetet e tij hyjnore dhe respekti i jashtëm për këtë recetë shërimi janë një prelude për të vepruar sipas udhëzimeve dhe urdhrave të tij. E drejta e vërtetë e Kur'anit nuk mund të jepet pa e bërë atë boshtin e jetës social-politike të myslimanëve.

Me sa duket, nderimi dhe respektimi për recetë mjekësore të mjekut dhe leximi me një ton melodioz, pa kuptuar dhe pa zbatuar rekomandimet dhe udhëzimet e tij, nuk mund të kurojë sëmundjen e një pacienti. Çdo person racional beson se rimëkëmbja qëndron në ndjekjen e udhëzimeve të një recete mjekësore. Forma reale, lidhur me një recetë mjekësore, është zbatimi dhe të vepruarit sipas saj dhe jo ofrimi i një respekti të jashtëm e formal të mjekut dhe recetës së tij.

## **Kur'ani, drita e vërtetë**

Një nga manifestimet demonstrative të Allahut, është drita. Allahu e ka krahasuar veten me dritën, duke thënë:

اللَّهُ نُورُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ

**"Allahu është Drita e qiejve dhe e tokës."**<sup>1</sup>

Për shkak të kësaj drite të Allahut të Lartësuar, bota e qenies ekziston dhe bekimi i ekzistencës së vazhdueshme zbret mbi krijesat nga burimi i saj. Për shkak të saj vazhdojnë të mbijetojnë dukuritë dhe krijesat.

Ndonjëherë, fjala e Zotit është përshkruar si "drita", sepse me anë të dritës njeriu gjen rrugën e tij dhe ruhet nga devijimi dhe humbja e rrugës, pasi devijimi më katastrofik në rrugën e jetës, është ai që rrezikon shpëtimin e njeriut, drita e vërtetë dhe reale është ajo që shpëton njerëzit nga devijimi dhe tregon qartë rrugën e vërtetë të përsosmërisë njerëzore.

Me fjalë të tjera, ajo dallon rrugën e përsosjes dhe të shpëtimit nga shtigjet e degradimit dhe të devijimit. Si e tillë, Allahu i Lartësuar, e ka përshkruar Kur'anin si "dritë", duke thënë:

قَدْ جَاءَكُمْ مِنَ اللَّهِ نُورٌ وَكِتَابٌ مُبِينٌ

---

<sup>1</sup> Sure "El Nur", ajeti 35.

**"Sigurisht juve ju ka ardhur prej Allahut dritë (i Dërguari) dhe Libër i qartë (Kur'ani)."<sup>1</sup>**

Si e tillë, duke përfituar prej saj, ju mund të dalloni rrugën e lumturisë nga ajo e dënimit për vuajtje në ferr.

Pas përshkrimit të Islamit dhe të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) thotë kështu në Ligjëratën 18, ndërsa përshkruanin Kur'anin e Shenjtë:

مِمَّ أَنْزَلَ عَلَيْهِ الْكِتَابَ نُورًا لَا نُظُنُّهُ مَضَاهِيحُهُ، وَسِرَاجًا لَا يَخْبُو تَوَقُّدُهُ، وَبَحْرًا لَا يُدْرِكُ قَعْرُهُ.

*"Pastaj, Allahu i dërgoi atij Librin, si një 'dritë', flakët e të cilës nuk mund të shuhen, 'një llambë', shkëlqimi i të cilës nuk zhduket, dhe një 'det', thellësia e të cilit nuk mund të matet."<sup>2</sup>*

Në përshkrimin e Kur'anit, në këtë predikim, duke përdorur tri krahasime shumë të bukura, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) kërkon të njohë zemrat e myslimanëve me madhështinë e Kur'anit dhe të tërheqë vëmendjen e tyre ndaj kësaj pasurie të mrekullueshëm hyjnore, e cila është në dispozicion të tyre.

Fillimisht, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) e përshkruan Kur'anin si një "dritë", flakët e të cilës nuk mund të shuhen dhe shkëlqim i saj nuk zhduket. Përmes një ngjashmërie me atë që është e kuptueshme, nga ajo që është e perceptueshme, ai thotë se Kur'ani është si burim i madh i energjisë elektrike, që ndriçon autostradat

<sup>1</sup> Sure "El Maide", ajeti 15.

<sup>2</sup> "Nehxhul Belaga", Ligjërata 189.

që shpërndahen në drejtime të ndryshme në errësirën e natës, përmes një rrjeti dritash të fuqishme elektrike.

Duke instaluar semaforët nëpër kryqëzime, ajo bën të zgjedhësh rrugën që të çon në një vend të caktuar, duke shmangur rrugë të tjera, që përfundojnë në humnera të tmerrshme për ata që duan të arrijnë në mënyrë të sigurt në vendin e tyre.

Kur'ani, gjithashtu, luan të njëjtin rol në një shoqëri fetare apo islame, me një ndryshim: flakët që burojnë nga ky burim i dritës dhe ndriçojnë rrugën e shpëtimit, nuk mund të shuhen kurrë.

Si e tillë, rruga e të vërtetës është gjithmonë e drejtë dhe e ndriçuar dhe Kur'ani i Shenjtë dhe flaka ndriçuese që rrezatohet prej saj, vazhdimisht paralajmëron pasuesit e tij të jenë të kujdesshëm dhe të mos shmangen nga rruga e të vërtetës.

Në një pjesë tjetër të Ligjëratat, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) thotë:

وَأَوْرَأَ لَيْسَ مَعَهُ ظُلْمَةٌ.

*"Kur'ani është një rrëzëllim, me të cilin nuk ka errësirë."*<sup>1</sup>

Ky Libër Qiellor ka fanarë të natyrshëm, të cilët vazhdimisht ndriçojnë rrugën e udhëzimit dhe të lumturisë. Imamët, të cilët janë "përkthyesit" e Shpalljes hyjnore, përfaqësojnë fanarët që komunikojnë njohuritë e Kur'anit te njerëzit dhe i njohin ata me të vërtetën e tij nëpërmjet njohurive të dhuruara nga Allahu.

---

<sup>1</sup> Po aty.

## ***Fanarët dhe reflektimet kur'anore***

Siç e dimë, në bazë të traditës së dy gjërave me peshë (*hadithi "Eth Thakalajn"*), Kur'ani dhe pasardhësit e Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) (*itrat*), këto dy pasuri hyjnore, përgjatë rrugës së udhëzimit të monoteistëve, janë plotësuese. Duke u kapur pas njëres dhe duke e braktisur tjetrën, qëllimi i shpalljes së Kur'anit nuk mund të realizohet. Imamët e Pagabuëshëm (*Paqja qoftë mbi ta!*) janë ndriçues, drita e të cilave buron nga ky burim hyjnor dhe zotërojnë shkencat e Kur'anit dhe të vërtetën e tij.

Këto personazhe të shenjta mund t'i dallojnë ajetet metaforike (*muteshabihatet*) nga ajetet e drejtpërdrejta (*muhkamat*) dhe rrugën e vërtetë nga rruga e rreme dhe t'i udhëzojnë njerëzit drejt rrugës së shpëtimit dhe të përsosmërisë. Ndërkohë, njerëzit duhet të mësojnë nga shkencat e Kur'anit dhe të veprojnë sipas tyre.

Modeli i Allahut (Sunnati i Allahut) është i tillë që njerëzit duhet të njohin shkencat e Kur'anit përmes Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*) dhe të përpiqen për të siguruar shpëtimin e tyre në këtë botë dhe në Botën Tjetër, duke iu bindur atyre. Për këtë arsye, duke zyrtarizuar zinxhirin e pathyeshëm të imamatit (*imamah*), Allahu i Lartësuar ka mbajtur të hapur rrugën e përfitimit nga shkencat e Kur'anit për ata që janë në kërkim të shpëtimit. Armiqtë dhe materialistët gjatë gjithë historisë janë përpjekur ta shuajnë dritën e udhërrëfimit hyjnor, që është mishëruar në shkollën e Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*), por Kur'ani thotë se ata kurrë nuk do të ketë sukses në këtë mënyrë:

يُرِيدُونَ لِيُطْفِئُوا نُورَ اللَّهِ بِأَفْوَاهِهِمْ وَاللَّهُ مُنِيرٌ نُّورِهِ وَأَلْوَكِرَةُ الْكَافِرُونَ

"Ata dëshirojnë të shuajnë dritën e Allahut me gojën e tyre, po Allahu e përsos dritën e Vet, edhe pse këtë gjë e urrejnë besimtarët."<sup>1</sup>

Si e tillë, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) krahason Kur'anin me një ndriçues, flakët e të cilit nuk mund të shuhen dhe shkëlqimi i tij nuk do të venitet kurrë.

Shkencat e Kur'anit janë aq të thella dhe të gjera, sa herë që ata janë të njohur me njohuritë e Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*), reflektojnë mbi to, fitojnë njohuri dhe fakte të reja në çdo fazë, pasi ky Libër Qiellor është një dorëshkrim i dijes hyjnore, sado që ata janë të etur për të përfutur të vërtetën nga gurra e tij e pastër, etja nuk shuhet. Në fakt, ata bëhen gjithnjë dhe më të etur.

Si e tillë, ne mund të shohim se, duke recituar ajete hyjnore në lutjet rituale dhe duke reflektuar mbi ta, evlijatë (të dashurit) e Allahut dhe ata që kanë njohuri për të vërtetën e Kur'anit, përpiqen të pastrojnë shpirtat e tyre dhe pozicionojnë veten më shumë se kurrë në pragun e frymëzimit të Zotit dhe në dijen e Tij të pafundme.

Kur'ani është një diell rrezatues, dija e të cilit (*ma' rifah*) është e pafund dhe shkëlqimi i dritës është i përjetshëm, sepse ky Libër Qiellor është si një oqean i thellë. Është e pamundur për këdo që ta kuptojë atë, përveç të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe Imamëve të Pagabueshëm (*Paqja qoftë mbi ta!*), të cilët zotërojnë "njohuri të

<sup>1</sup> Sure "El Saff", ajeti 8.

Librit” (*ilm al-Kitab*). Çdo person që dëshiron të njihet me Kur’anin apo Fjalën e Allahu dhe të jetojë jetën e tij individuale dhe shoqërore, bazuar në udhëzimet e këtij Libri Qiellor, nuk ka mundësi tjetër, por të kapet pas Kur’anit sipas interpretimit, shpjegimit dhe sjelljes së Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe Imamëve të Pagabueshëm (*Paqja qoftë mbi ta!*).

Për ta provuar këtë, ne do të veçonim pjesë të veçanta të dy haditheve:

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), thotë:

وَمَنْ قَتَادِيلُ النَّبِيِّ وَمَصَابِيحُ الرِّسَالَةِ وَمَنْ نُورُ الْأَنْوَارِ وَكَلِمَةُ الْجَبَّارِ وَمَنْ رَأَىٰ الْحَقَّ الَّذِي مَنْ تَبِعَهَا نَجَىٰ وَمَنْ تَأَخَّرَ عَنْهَا هَوَىٰ  
وَمَنْ مَصَابِيحُ الْمَشَاكَاةِ الَّتِي فِيهَا نُورُ النَّوْرِ.

"Ne jemi fenerët e profetizmit (*nubuwoah*) dhe ndriçuesit e profetësisë (*Risalah*). Ne jemi dritat e Dritës dhe fjala e të Plotfuqishmit. Ne jemi flamuri i të vërtetës. Kushdo që e ndjek atë, është i sigurt dhe i shpëtuar dhe kushdo që e braktis, merr rrugën e gabuar. Ne jemi ndriçues të kamares që përmban Dritën e dritave."<sup>1</sup>

Një thënie e ngjashme ka qenë e raportuar nga Imam Sexhadi (*Paqja qoftë mbi të!*):

لَنْ مَثَلًا فِي كِتَابِ اللَّهِ كَمَثَلِ الْمَشَاكَاةِ وَالْمَشَاكَاةِ فِي الْقُنْدِيلِ فَتَحْنُ الْمَشَاكَاةُ فِيهَا مِصْبَاحٌ وَالْمِصْبَاحُ مُحَمَّدٌ (ص) الْمِصْبَاحُ فِي رُجَاجِهِ نَحْنُ الرُّجَاجُ كَأَنَّهَا كَوْكَبٌ ذَرِيٌّ يُوقَدُ مِنْ شَجَرَةٍ مُبَارَكَةٍ زَيْتُونِيَّةٍ مَعْرُوفَةٍ لَا شَرِيْقِيَّةَ وَلَا عَرَبِيَّةَ لَا مُنْكَرَةَ وَلَا دَعِيَّةَ بِكَادٍ زَيْتُونِيَّةٍ وَلَا لَمْ تَمْسَسْهُ نَارُ نُورِ الْقُرْآنِ عَلَى نُورِ يَهْدِي اللَّهُ لِنُورِهِ مَنْ يَشَاءُ وَيَضْرِبُ اللَّهُ الْأَمْثَالَ لِلنَّاسِ وَاللَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ بِأَنَّ يَهْدِي مَنْ أَحَبَّ إِلَيَّ وَلَا يَتَيْنَا.

<sup>1</sup> "Biharul Anuar", vëll. 26, f. 259.

*"Vërtet, shembulli ynë në Librin e Allahut shëmbëllen me atë të një kamareje. Ne jemi kamarja ku vendoset llamba/kandili. Kandili është në një kristal dhe kristali është Muhamedi (Paqja dhe bekimet e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!). (Kristali është si një yll i shndritshëm. Ai, (kandili) ndizet prej (vajit) të një peme të bekuar ulliri, e cila nuk është as lindore, as perëndimore. Vaji shkëlqen edhe pa e prekur zjarri. Drita e Kur'anit është dritë sipër dritës. Allahu udhëzon drejt dritës së Tij cilindo që dëshiron. Allahu paraqet shembuj për njerëzit dhe Allahu është i dijshtëm për çdo gjë. Me të vërtetë, Ai udhëzon këdo që Ai do drejt kujdestarisë sonë [vilajetit]."*<sup>1</sup>

Në këtë thënie, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka interpretuar ajetin 35 të sures "En Nur", duke iu referuar Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*) të tij ose Imamëve të Pagabueshëm (*Paqja qoftë mbi ta!*).

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë se ngjashmëria e Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*) në Kur'an është me një kristal të tejdukshëm, që pasqyron dritën e ndriçuesit të profetizmit (*nubuwwah*). Kjo dritë buron nga një pemë e bekuar, shkëlqimi i të cilës është gjithëpërfshirëse dhe e pamohueshme, plot e përplot me dritë hyjnore. Kjo dritë nuk është as lindore, as perëndimore dhe as e panjohur dhe e manifestuar.

Imam Sexhdi (*Paqja qoftë mbi të!*) thotë se e vërteta e të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe e Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*) të shenjtë është si një kandil që shkëlqen dhe jep dritë, pa flakë.

---

<sup>1</sup> Po aty, vëll. 23, f. 314.



## ***Shpëtimi i ndjekësve të Kur'anit në Ditën e Ringjalljes***

Siç është theksuar më parë, shpëtimi është i një rëndësie të veçantë për njeriun dhe jeta në këtë botë është një prelude për jetën e pasosur në Botën Tjetër. Ngjashmëria e njeriut në këtë botë me Botën Tjetër është e një udhëtari, i cili, duke punuar shumë ditën dhe natën në një qytet të huaj, duke jetuar me kursime, dërgon të ardhurat e tij në vendlindje, synon të ndërtojë një shtëpi dhe ka kapital të mjaftueshëm. Kështu, pas kthimit të tij në shtëpi, ai mund të jetojë i qetë, me nder dhe dinjitet për pjesën e mbetur të jetës. Dallimin e vetëm është se jeta në Botën Tjetër është e pafundme dhe e përjetshme.

Besimet dhe veprimet e secilit janë fara e mbjellë prej tij në këtë botë, që do të japë frytet e veta në Botën Tjetër. Në qoftë se, në këtë botë, një bujk mbjell farën, në përputhje me udhëzimet e një specialisti në bujqësi, rendimenti i tij në kohën e korrjes do të jetë më i miri i mundshëm, si në cilësi dhe sasi.

Në mënyrë të ngjashme, në qoftë se qeniet njerëzore organizojnë veprimet dhe aktivitetet e tyre në përputhje me udhëzimet e Kur'anit të Shenjtë, me mësimet dhe parimet e Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*) dhe zgjidhin çështjet socio-politike dhe individuale sipas urdhërësive të Kur'anit të Shenjtë, përveç nderimit dhe lavdisë në këtë botë, ata do të gëzojnë rezultatet e veprave të tyre të mira në Botën Tjetër.

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) u bën thirrje njerëzve për të ruajtur dispozitat gjallëruese të Kur'anit:

فَاسْأَلُوا اللَّهَ بِهِ، وَتَوَجَّهُوا إِلَيْهِ بِحُبِّهِ، وَلَا تَسْأَلُوا بِهِ خَلْقَهُ، إِنَّهُ مَا تَوَجَّهَ الْعِبَادُ إِلَى اللَّهِ بِمِثْلِهِ. وَعَلَّمُوا أَنَّهُ شَافِعٌ مُسْتَمْعٍ، وَقَائِلٌ مُصَدِّقٌ، وَأَنَّهُ مَنْ شَفَعَ لَهُ الْقُرْآنُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ شَفَعَ فِيهِ، وَمَنْ مَحَلَّ بِهِ الْقُرْآنُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ صَدَّقَ عَلَيْهِ.

"Lutjuni Allahut përmes dashurisë së tij, lutjuni Allahut, e jo njerëzve, përmes tij (Kur'anit). Sepse s'ka tjetër, qet'ju rikthejë tek Zoti, si ai. Kujtoni, që ai është ndërmjetësues e që ndërmjetësimi i tij do të pranohet. Ai është orator që i ka dhënë provat, tashmë. Për këdo që do të flasë Kur'ani Ditën e Gjyqit, fjala e tij do të pranohet. Ai, për të cilin Kur'ani flet keq në Ditën e Gjykimit, do dënohet për shkak të dëshmisë së tij (Kur'anit)."<sup>1</sup>

Pasi thamë se Kur'ani është shërimi më i madh dhe zgjidhje për sëmundjet e shoqërisë, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) bind njerëzit që të kërkojnë shërimin e sëmundjeve të tyre te Kur'ani, duke e ndjekur atë dhe të kthehen te Allahu, duke vepruar sipas tij dhe të mos e marrin Kur'anin si një mënyrë për të kërkuar qenie të tjera njerëzore për ndihmë.

Pastaj, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) paralajmëron njerëzit për rrezikun e ndarjes nga Kur'ani dhe i fton ata të ndjekin këtë Libër Qiellor dhe ta konsiderojnë atë si një udhëzues në mendimet dhe në veprimet e tyre:

فَإِنَّهُ يُنَادِي مُنَادٍ يَوْمَ الْقِيَامَةِ: أَلَا إِنَّ كُلَّ حَارِثٍ مُبْتَلٍ فِي حَزْبِهِ وَعَاقِبَتِهِ عَمَلُهُ، غَيْرَ حَزْبِ الْقُرْآنِ، فَكُونُوا مِنْ حَزْبِيهِ وَأَتْبَاعِهِ، وَاسْتَدِلُّوهُ عَلَى رِبِّكُمْ، وَاسْتَنْصِحُوهُ عَلَى أَنْفُسِكُمْ، وَأَتَّبِعُوا عَلَيْهِ آرَاءَكُمْ، وَاسْتَفْضُوا فِيهِ أَهْوَاءَكُمْ.

"Në Ditën e Gjykimit, një prezantues do të shpallë: 'Kujdes, çdo kultivues i një kulture është në ankth, përveç kultivuesit të Kur'anit.' Prandaj, ju duhet të jeni në mesin e kultivuesve të Kur'anit dhe të ithtarëve të tij. Bëjeni atë t'ju udhëzojë drejt Zotit tuaj. Kërkoni këshilla

<sup>1</sup> "Nehxhul Belaga", Ligjërata 175.

*prej tij për veten tuaj. Mos i kundërvini mendimet tuaja kundër tij. Mos vini në plan të parë dëshirat tuaja para çështjeve të Kur'anit.”<sup>1</sup>*

Në Ditën e Gjykimit, kur njerëzit do të ringjallen për të dhënë llogari, për shpërblim dhe ndëshkim, një lajmëtar do të shpallë këtë të vërtetë popullit: “O njerëz! A e dini se të gjitha qeniet njerëzore, sot do të jenë të prekura me produktet dhe rezultatet e asaj që kanë mbjellë, përveç atyre, besimet dhe veprimet e të cilëve janë të bazuara mbi urdhëresat dhe udhëzimet e Kur'anit? Vetëm këta individë do të jenë të kënaqur me produktet dhe ndikimet e veprave dhe besimeve të tyre dhe nuk do të ndihen të mashtruar.

### ***Këshillime dhe kujtesa***

Jeta e të gjitha krijesave, duke përfshirë njeriun, është e kufizuar. Kjo jetë fillon në një pikë të caktuar në kohë dhe përfundon me vdekjen, në një pikë tjetër. Në këtë hapësirë të kufizuar të kohës, njeriu dhe personaliteti i tij është gjithmonë në një gjendje formimi e zhvillimi. Personaliteti i njeriut rezulton nga bindjet e tij dhe nga mendimet që ka, nga veprimet dhe sjellja. Veprat e njeriut, gjithashtu, do të shfaqen në Ditën e Ringjalljes dhe çdo person do të lotojë, kur të shikojë produktet e veprave të tij.

Pika për t'u theksuar këtu është se për sa kohë që njeriu nuk është larguar ende nga kjo botë, ai mund të ndreqë sjelljen e tij të kaluar në çdo moment, duke rivlerësuar mendimet e tij, besimet

---

<sup>1</sup> Po aty.

dhe veprimet dhe duke ndryshuar fatin e tij drejt çlirimit dhe shpëtimit në këtë botë dhe në Botën e Përtejme.

Ndonjëherë njerëzit vijnë në vete në një moment transformues dhe nëpërmjet pendimit të vërtetë dhe vendimit serioz, ata e transformojnë të kaluarën e tyre të zymtë në një të ardhme të ndritshme dhe të begatë dhe përshkojnë brenda natës një distancë prej një shekulli. Duhet të theksohet se mundësia për vlerësim dhe ndreqje është e mundur vetëm në këtë botë, sepse nuk do të ketë vend për reformim pas vdekjes.

Nëse njeriu bazon veprat dhe aktivitetet e tij në Kur'an, urdhëresat dhe porositë hyjnore në këtë botë, sipas fjalës së Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), ai do të jetë mes mbjellësve të Kur'anit dhe, në Botën Tjetër, do të shijojë produktet e veprave të tij. Koha për veprim dhe përgatitje ekziston vetëm në këtë botë:

الْيَوْمَ عَمَلٌ وَلَا حِسَابٌ وَعَدَا حِسَابٌ وَلَا عَمَلٌ.

*"Sot është koha për të vepruar dhe jo për të dhënë llogari, ndërsa nesër do të jetë koha për të dhënë llogari dhe jo për veprim."*<sup>1</sup>

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili e njeh realitetin e kësaj bote dhe të Botës Tjetër, lidhjen e tyre, si dhe është shumë i shqetësuar për gjendjen e vështirë të myslimanëve, ka thënë: *"Ju duhet të jeni në mesin e mbjellësve të Kur'anit."*

Kjo do të thotë: Nëse dëshironi shpëtimin, ju duhet të mbillni vepra të mira me bekimin e Kur'anit. Bëhuni ndër ata që ndërtojnë vendbanimin e tyre në këtë botë dhe në Botën Tjetër, duke vepruar

<sup>1</sup> "Biharul Anuar", vëll. 32, f. 354; vëll. 77, f. 419.

sipas udhëzimeve gjallëruese të këtij Libri Qiellor. Konsiderojeni Kur'anin si udhëzuesin tuaj, në mënyrë që kurrë të mos keni humbje.

### ***Sekreti i suksesit dhe roli i Kur'anit***

Duket qartë se, në mënyrë që të jesh i suksesshëm në çdo program, sidomos në çështjet arsimore, kulturore dhe sociale, ekzistojnë disa kushte themelore:

1. Korrektësia dhe saktësia e programit, në lidhje me qëllimin e saj.
2. Bindja dhe besimi në program dhe procedurat e paraqitura në program.
3. Zbatimi i udhëzimeve dhe i procedurave të përcaktuara në program.

Natyrisht, në qoftë se ndonjëri prej tri kushteve nuk plotësohet, efikasiteti i programit do të çalojë dhe qëllimi nuk arrihet.

Ne të gjithë pretendojnë se Kur'ani është fjala e Allahut dhe program i jetës për myslimanët. Megjithatë, të pretendosh thjesht, ose vetëm njohja e jashtme, nuk është e mjaftueshme. Rrëfimi, pohimi do të konsiderohet si besim në Kur'an dhe udhëzimet e tij rigjallëruese, me kusht që të tregojnë besim të sinqertë, bindje dhe nënshtrim të plotë ndaj mesazhit të tij hyjnor. Vetëm atëherë Kur'ani do të bëhet efektiv në drejtimin e shoqërisë.

Kur'ani i Shenjtë thotë:

ذَٰلِكَ الْكِتَابُ لَا رَيْبَ فِيهِ هُدًى لِّلْمُتَّقِينَ \* الَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِالْغَيْبِ وَيُقِيمُونَ الصَّلَاةَ وَمِمَّا رَزَقْنَاهُمْ يُنفِقُونَ \* وَالَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِمَا  
أُنزِلَ إِلَيْكَ وَمَا أُنزِلَ مِن قَبْلِكَ وَبِالْآخِرَةِ هُمْ يُوقِنُونَ \* أُولَٰئِكَ عَلَىٰ هُدًى مِّن رَّبِّهِمْ وَأُولَٰئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ

**“Ky është Libri, në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit, të cilët besojnë në të fshehtën, falin namazin dhe japin nga ajo që u kemi dhënë Ne. Për ata që besojnë në atë që të është Shpallur ty (o Muhamed), në atë që është Shpallur përpara teje dhe që me bindje i besojnë Jetës Tjetër, ata janë udhëzuar në Rrugë të Drejtë nga Zoti i tyre dhe pikërisht ata janë të shpëtuarit.”<sup>1</sup>**

Sigurisht, ne jemi të vetëdijshëm se besimi (*imani*) ka shkallë të ndryshme dhe shoqëria islame mund të kapërcejë problemet e saj dhe të arrijë fitoren mbi armiqtë me nder dhe dinjitet, me kusht që zyrtarët e kulturës të shoqërisë të kenë besim të sigurt dhe të besojnë në qeverinë fetare dhe t’i nënshtrohen urdhëresave dhe mësimëve të Kur’anit, si nënshtrimi i Profetit Ibrahim (Abraham) (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe nuk shtiren me besimin në Kur’an, duke përdorur fenë dhe kulturën fetare vetëm për të fituar popullaritet.

Në Kur’anin e Shenjtë, ata që nuk kanë besim në ligjet dhe dekretet hyjnore dhe vetëm pretendojnë se e kanë pranuar Islamin, në mënyrë që të mashtrojnë myslimanët dhe të arrijnë objektivat e tyre të kësaj bote, janë përshkruar si hipokritë (*munafikin*). Karakteristikat e jashtme dhe të brendshme dhe sjellja e këtij grupi janë përmendur në ajetet e shumta të Kur’anit të Shenjtë.

<sup>1</sup> Sure “El Bekare”, ajetet 2-5.

## ***Ibrahimi (Paqja qoftë mbi të!), një model i nënshtrimit ndaj Kur'anit të Shenjtë***

Kur'ani i Shenjtë deklaroi nënshtrimin e Profetit Ibrahimit (*Paqja qoftë mbi të!*) ndaj urdhërimeve dhe porosive hyjnore, si model të nënshtrimit dhe pranimit të vullnetit hyjnor dhe paraqet besimin, durimin, guximin dhe besimin në Allahun e Lartësuar si sekretin e suksesit të tij në përballimin e problemeve dhe fitoren mbi idhujtarët. Ai, gjithashtu, na nxiti të kemi një besim të tillë dhe bindje ndaj urdhërimeve të Allahut dhe Kur'anit të Shenjtë dhe të jemi të fortë dhe të vendosur, ashtu si Ibrahim (i) (*Paqja qoftë mbi të!*) në ekzekutimin e dekreteve hyjnore.

Këtu, ne do të diskutojmë shkurtimisht besimin e Profetit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) në ekzekutimin e urdhrit të Allahut, për të sakrifikuar djalin e tij, Profetin Ismail (Ishmaelin) (*Paqja qoftë mbi të!*). Kështu që, duke shpjeguar frymën e përqendrimit të Allahut, në kulturën monoteiste, ne mund të nxjerrim në pah dobësinë tonë në bindjen ndaj udhëzimeve të Kur'anit dhe të njohim lexuesit me sëmundjet kryesore të shoqërisë.

Siç mund të nxirret nga Kur'ani i Shenjtë, dekreti hyjnor që i dha Profetit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) një djalë, pas njëqind vjetësh. Dëshira e tij u bë realitet, pas një periudhe shumë të gjatë pritjeje. Natyrisht, çdo person e konsideron ekzistencën e një fëmije të bukur, një vazhdim të jetës së tij. Pas lindjes së Ismailit (*Paqja qoftë mbi të!*), Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte urdhëruar nga Allahu i Lartësuar, që të dërgonte fëmijën, së bashku me nënën e tij shpirtmadhe, në tokat e Mekës, t'i linte aty në kushtet më të vështira

të shkretëtirës, pa asnjë gjurmë uji dhe jetese dhe të kthehej nga Meka, pas përmbushjes së misionit të tij hyjnor.

Pas pak kohe, ai u lejua të kthehej në Mekë, kur djali i tij ishte rritur dhe ishte bërë një djalosh i ri, i sjellshëm dhe i pushëm, faqet rozë të të cilit larguan pikëllimin dhe hidhërimin e babait të tij dhe ia shndërruan dhimbjet e ndarjes dhe të problemeve, duke i bërë më të lehta për të. Papritur, në kulmin e lidhjes emocionale me një djalë të tillë, i është shpallur në një "ëndërr" se duhet të sakrifikonte djalin e tij në rrugën e Allahut.

Meqë ra fjala, është e denjë të provojmë bindjen dhe besimin tonë në Zot, në Kur'an dhe në urdhëresat hyjnore, si dhe shkallën e nënshtrimit tonë ndaj Allahut nëpërmjet besimit dhe shkallës së nënshtrimit së Profetit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*), kështu që ne mund të dallojmë largësinë mes nesh dhe asaj që Kur'ani dhe Allahu i Madhërishëm dëshiron prej nesh dhe forcimit të besimit tonë.

Nëse ju dhe unë do të merrni një urdhër nga Xhebraili (Kryeengjëlli Gabriel), që të flijoni djalin tuaj, ndërsa jeni zgjuar dhe jo në gjumë, nuk jeni të sigurt as që ta dëgjoni atë, pa le ta zbatoni urdhrin hyjnor, për të flijuar djalin tuaj. Sidoqoftë, pa asnjë hezitim, Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte i vendosur t'i bindej urdhrit hyjnor. Pa shfaqur asnjë dyshim për vërtetësinë e urdhrit të shpallur, e informoi djalin e tij për ëndrrën:

فَلَمَّا بَلَغَ مَعَهُ السَّعْيَ قَالَ يَا بُنَيَّ إِنِّي أَرَى فِي الْمَنَامِ أَنِّي أَذْبَحُكَ فَانظُرْ مَاذَا تَرَى قَالَ يَا أَبَتِ افْعَلْ مَا تُؤْمُرُ سَتَجِدُنِي إِن شَاءَ اللَّهُ مِنَ الصَّابِرِينَ



**“Kur fëmija u rrit, aq sa ta ndihmonte në punë, Ibrahim i tha: ‘O djali im, kam parë ëndërr se duhet të të flijoj. Çfarë mendon ti?’ I biri i tha: ‘O ati im, vepro ashtu siç je urdhëruar! Dashtë Allahu, unë do të jem i durueshëm!’”<sup>1</sup>**

E tillë është shkalla e besimit dhe e nënshtrimit të Profetit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*). Tani, përpiquni të kuptoni shkallën e besimit dhe të nënshtrimit të djalit. Vëreni bindjen e të birit në urdhrin e Allahut dhe të babait të tij dhe do të mahnitëni me sinqeritetin dhe besimin e individëve, që pena dhe gjuha janë të paafta t’i përshkruajnë dhe hezitoni ta quani veten “myslimanë”.

Profeti Ismail (*Paqja qoftë mbi të!*), ky djalë që mësoi nga babai i tij mësimin e nënshtrimit ndaj vullnetit të Allahut, nxiti të atin për të ekzekutuar urdhrin hyjnor, pa pyetur për filozofinë prapa vrasjes së tij dhe pa shkaktuar asnjë dyshim dhe hezitim te babai i tij . Ai ka thënë: **"O babai im! Vepro ashtu siç je urdhëruar. Dashtë Allahu, unë do të jem i durueshëm."**

Njerëzit e mëdhenj veprojnë, pasi të kërkojnë ndihmën e Allahut të Lartësuar dhe të mbështeten tek Ai. Në të gjitha aktivitetet, me ndihmën e Tij, asistencën dhe përlësinë më të madhe, ata thonë: *“Me vullnetin dhe ndihmën e Allahut, unë do të kryej një vepër të tillë dhe të atillë...”* Edhe këtu, Profeti Ismail (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk mbështetet në fuqinë e tij, por në ndihmën e Allahut.

Allahu i Lartësuar, shpreh dhe përshkruan fytyrën e Profetit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe gjendjen e tij të nënshtrimit ndaj Zotit, duke cituar fjalët e Ibrahimit:

---

<sup>1</sup> Sure “El Saffat”, ajeti 102.

إِنِّي وَجَّهْتُ وَجْهِيَ لِلَّذِي فَطَرَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ حَنِيفًا وَمَا أَنَا مِنَ الْمُشْرِكِينَ

**“Unë e kthej fytyrën time nga Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë, dhe nuk jam nga idhujtarët!”<sup>1</sup>**

Ne duhet të kemi të njëjtin besim si të Profetit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) në Allah dhe Kur'an, për të përfituar nga Kur'ani, d.m.th. udhëzimin e shoqërisë, në përputhje me udhëzimet e Kur'anit.

Prandaj, është e qartë se përveç besimit dhe bindjes, çfarëdo që të materializojë programin në udhëzimin e Kur'anit, është të veprjmë sipas udhëzimeve të Kur'anit dhe të vëmë në praktikë urdhërimet e tij gjallëruese, si në jetën individuale, ashtu edhe atë shoqërore.

---

<sup>1</sup> Sure "En'am", ajeti 79.

## **KAPITULLI II**

### **KUPTIMI DHE INTERPRETIMI I KUR'ANIT**

#### ***Problemi kryesor***

Në kapitullin e mëparshëm kemi arritur në përfundimin se Kur'ani është një Libër i udhëzimit hyjnor dhe të gjithë ne duhet ta besojmë atë. Ne duhet të menaxhojmë jetën dhe shoqërinë tonë në përputhje me udhëzimet e tij, për të qenë të lumtur në këtë botë dhe në Botën Tjetër. Unë do të doja të parashtroj këtë pyetje: Pavarësisht ekzistencës së Kur'anit, pse ne ende vuajmë nga probleme, sidomos probleme kulturore?

Ne do të përgjigjeshim se kjo është për shkak se nuk veprojmë sipas porosive të shpëtimit, të dhëna në Kur'an, ashtu si duhet të vepronim. Kjo përgjigje mund të konsiderohet e saktë, por duket se çështja më themelore është: Pse nuk veprojmë sipas tyre, ashtu si duhet? Në të vërtetë, cilët janë faktorët që ndikojnë për të treguar më pak vëmendje në praninë e Kur'anit në shoqëri dhe në

largimin gradual të njerëzve nga Kur'ani, kultura fetare dhe vlerat hyjnore?

Pasi objekti i diskutimit është Kur'ani, sipas "*Nehxhul Belagës*", ne duhet të pyesim: Si e analizon Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) problemin kryesor të shoqërisë sonë dhe çfarë zgjidhje jep ai? Para se të përgjigjemi me anë të një deklaratë të Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), unë do të doja ta trajtojë temën kryesore, pas disa vërejtjeve paraprake.

Besimi në Zot dhe nënshtrimi ndaj urdhëresave hyjnore janë ndër kushtet më të rëndësishme të udhëzimit dhe përfitimit nga udhëzimet e Kur'anit të Shenjtë. Besimi abrahamik dhe nënshtrimi, janë të nevojshme për një jetë të sigurt nga kurthet e shejtanit. Gurët e zallit në *Mash'ar al-Ma'rifah*<sup>1</sup> duhet të grumbullohen, me të cilët do të godasim (*ramji*) shejtanin e urdhërimit të vetvetes ose frymës/dëshirave sensuale (*nefs el-'ammarah*), kur i referohemi Kur'anit të Shenjtë.

Njeriu duhet t'i rezistojë dëshirave trupore e sensuale, t'i japë përparësi fjalës së Allahut para tyre dhe të mos ketë dëshira e ide të paramenduara, për të shmangur kryerjen e gabimeve, duke iu referuar ajeteve hyjnore dhe të kuptojë Kur'anin e Shenjtë.

Nuk është e vërtetë se ai që i afrohet Kur'anit, me çfarëdo qëllimi dhe në çfarëdo mënyre, mund të përfitojë me të drejtë prej tij. Thjesht, në qoftë se ne kemi pranuar, me të vërtetë, të qenit rob

---

<sup>1</sup>Mash'ar el ma'rifah, Mash'ar el Haram ose Muzdelifah: vendi ku pelegrinët në Haxh kalojnë natën gjatë kthimit të tyre nga Arafati, për të marrë 70 gurët që të sulmojnë (*ramji*) në xhamarat (vendet e tre pllakave të gurit që simbolizojnë satain) në Mina. (Përkthyesi)

i Allahut, duhet t'i nënshtrohemi plotësisht Atij, të pajtojmë veten me vullnetin e Tij dhe të besojmë sinqerisht se Ai është më i ditur se shërbëtorët e Tij dhe se Ai urdhëron dhe ndalon çka është e mirë apo e keqe për to. Është vetëm besimi dhe bindja, që njerëzit të kuptojnë drejt këtë Libër Qiellor dhe të përfitojnë nga udhëzimet e tij jetëdhënëse.

Prandaj, kushti i parë dhe më kryesori, për të përfituar nga udhëzimi hyjnor, është të kemi shpirtin e nënshtimit dhe të shmangim çdo formë të paragjykitimit dhe të egoizmit. Në recetën që ai shkruan për një pacient, një mjek pret që ai të marrë ilaçin e përcaktuar dhe ushqimet e duhura dhe të ndalojë marrjen e mjekimeve apo të ushqimeve që pengojnë ose vonojnë shërimin e tij.

Por, a janë të gjitha recetat dhe porositë e një mjeku në përputhje me pëlqimet dhe prirjet e pacientit? Ndoshta, një pacient mund të marrë me entuziazëm ilaçet e përshkruara dhe shmang disa ushqime të ndaluara nga mjeku. Por, në shumicën e rasteve, prirjet e pacientit janë në kundërshtim me recetat e mjekut. Ndonjëherë, një pacient dëshiron të konsumojë turshi, por për mjekun, duke vepruar në këtë mënyrë, është sikur të marrësh një helm vdekjeprurës.

Në këto raste, ekziston mundësia që, për shkak të prirjes së tij të fortë për këto ushqime, pacienti do të dyshojë mbi diagnozën e mjekut dhe bën dëshirën personale një justifikim për t'i konsumuar ato.

Natyrisht, për sa i përket sëmundjeve fizike, për shkak të një dëshire të fortë për të rimarrë veten, njeriu nuk është i gatshëm të

shkelë recetat e mjekut. Në shumicën e rasteve, ai përpiqet t'i zbatojë ato mbi prirjet e tij personale dhe i përmbahet me besnikëri recetave dhe porosive të mjekut. Për sa i përket sëmundjeve shpirtërore, megjithatë, shumë njerëz marrin prirjet e tyre seksuale, si kriter për gjykim dhe angazhohen në interpretimin e fesë dhe të ligjeve hyjnore, mbi bazën e ideve të rreme, të paramenduara dhe dëshirave të papërshtatshme e të pahijshme.

Natyrisht, me një mentalitet të tillë, është e pamundur të kuptojmë se si duhet Kur'anin dhe fenë, edhe nëse supozojmë se një person, me të vërtetë, dëshiron ta kuptojë atë si duhet dhe nuk ka ndërmend aspak për të mashtruar të tjerët. Fakt i thjeshtë, ai dëshiron ta kuptojë Kur'anin dhe fenë, nuk pengon tërësisht efektet e paragjyimit të tij, idetë e njolloitura dhe prirjet trupore nga interpretimi dhe kuptimi i gabuar i ajeteve kur'anore dhe i haditheve.

Sigurisht, rasti i individëve që janë të vetëdijshëm dhe në mënyrë të ndërgjegjshme shtrembërojnë ligjet dhe urdhëresat fetare, për të mashtruar njerëzit, duke i dhënë një goditje kulturës fetare të shoqërisë, në emër të interpretimeve të ndryshme, është një histori tjetër, me të cilën do të merremi në kohën e duhur. Ne do të shqyrtojmë shkurtimisht shkaqet dhe motivet e kësaj ideje antifetare nga këndvështrimi i "Nehxhul Belagës".

Tani, ne do të përpiqemi të gjejmë rrugën e duhur, duke iu referuar Kur'anit dhe për të kuptuar ligjet dhe urdhëresat e tij, do të bazohemi në thëniet e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*).

## ***Këshilla e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), lidhur me Kur'anin***

Pas deklaratës brilante e të qartë, ku Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) dha lajmin për Ditën e Ringjalljes, për kënaqësinë e pasuesve të Kur'anit, për veprimet e tyre, për të dhënat e kaluara dhe vuajtjet e dhunuesve të Kur'anit në atë ditë, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) i këshillon njerëzit kështu: *“Ju duhet të jeni ndër përhapësit e Kur'anit dhe pasuesve të tij. Bëjeni atë udhëzuesin tuaj drejt Zotit tuaj. Kërkoni prej tij këshilla për veten tuaj.”*<sup>1</sup>

Kjo do të thotë: Njiheni Zotin nëpërmjet Fjalës së Tij. Njihini cilësitë e Zotit nëpërmjet Kur'anit. Kur'ani është një udhëzues që do t'ju çojë tek Allahu.

Ju duhet të konsultoheni me këtë udhëzues hyjnor, për të njohur të Dërguarin e Tij dhe të keni besim tek Allahu, që zbulon Kur'anin. Ju, qeniet njerëzore, keni nevojë për Atë që është dashamirës dhe i mëshirshëm për ju, në mënyrë që t'ju këshillojë dhe t'ju mëshirojë në rast nevoje. Konsiderojeni Kur'anin si këshilltarin tuaj dhe ndiqni këshillat dashamirëse, sepse Kur'ani nuk do t'ju tradhtojë, por ju udhëzon në mënyrën më të mirë të mundshme në rrugën e drejtë.

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) i këshillon myslimanët dhe ata që janë në kërkim të lumturisë në këtë botë dhe në Botën Tjetër, ta konsiderojnë Kur'anin si udhërrëfyesin e tyre dhe t'i kushtojnë vëmendje këshillave dhe paralajmërimeve të tij të sinqerta, sepse:

---

<sup>1</sup> “Nehxhul Belaga”, Ligjërata 175.

إِنَّ هَذَا الْقُرْآنَ يَهْدِي لِلَّتِي هِيَ أَقْوَمُ وَيُبَشِّرُ الْمُؤْمِنِينَ الَّذِينَ يَعْمَلُونَ الصَّالِحَاتِ أَنَّ لَهُمْ أَجْرًا كَبِيرًا

**"Në të vërtetë, ky Kur'an udhëzon drejt asaj që është më e mira dhe u jep lajmin e gëzuar besimtarëve që bëjnë vepra të mira, se ka një shpërblim të madh për ta."<sup>1</sup>**

Pika që theksohet këtu, është nevoja për besim të fortë në përmbajtjen e këtij ajeti të shenjtë, pasi një besim i tillë në Kur'an nuk ekziston, pasi ndonjëherë njeriu nuk i nënshtrohet plotësisht Allahut dhe nuk heq nga vetja paragjykimet dhe dëshirat sensuale dhe ekziston mundësia që të dorëzohet ndaj tundimeve satanike dhe të largohet nga rruga e drejtë. Pasi ai këshillohet me Kur'anin, në mënyrë të pavetëdijshme, kërkon ajete, që në dukje, përshtaten me dëshirat e tij trupore.

Natyrisht, urdhrat dhe dekretet e Kur'anit nuk janë në harmoni me dëshirat trupore dhe prirjet shtazarake të njeriut. Kështu, sa herë që Kur'ani thotë diçka kundër prirjeve të tij personale, ai është i pakënaqur dhe, kur vargjet kur'anore janë në përputhje me prirjet e tij trupore, i pranon ato krahëhapur.

Sigurisht, të gjitha këto reagime janë të shprehura në mënyrë të fshehtë në brendësi, por ndikimet e tyre manifestohen me veprimet dhe sjelljet e tij. Si e tillë, arsyeja kërkon që, para se të konsultohet me Kur'anin, njeriu të largojë nga mendja e tij çdo formë të egoizmit, në mënyrë që të mund të hyjë në shkollën e Kur'anit me frymën e përqendrimit tek Allahu. Mënyra është: Duke respektuar sinqerisht rregullat e sjelljes, që njeriu i fiton me dijen hyjnore.

<sup>1</sup> Sure "El Isra" (ose Beni Isra'il), ajeti 9.



### ***Interpretimi spekulativ (Tefsir bi err rrajji)***

Natyrisht, për të vepruar si më lart, nuk është një detyrë e lehtë. Në të vërtetë, për ata që nuk kanë një shpirt të fortë të nënshtrimit ndaj Zotit, është edhe më e vështirë. Për këtë arsye, ajo quhet Xhihadi i madh (*xhihad al akbar*).

Duket se baza psikologjike dhe mendore e interpretimit spekulativ (*tefsir bi err rrajji*) është se njeriu nuk mund të braktisë dëshirat dhe prirjet e tij sensuale. Shejtani, më tej, shfrytëzon këtë situatë dhe e drejton mendjen dhe të menduarit e një personi të tillë për një interpretim të gabuar dhe mashtrues të Kur'anit dhe të fesë.

Nëse personi ka një qëndrim të mirë shoqëror, tundimi i satanait, armikut të betuar të njerëzimit, është i shumëfishtë, sepse ai e di se, duke larguar një person të tillë, ai ndoshta do të largojë nga rruga e drejtë një grup njerëzish që e dëgjojnë atë person. Ne shpesh gjejmë individë që nxjerrin urdhra fetare, pa u konsultuar me Kur'anin dhe, pa pasur meritat e nevojshme intelektuale dhe akademike dhe kualifikimet e duhura, shprehin mendimin e tyre personal dhe thonë se edhe Kur'ani, gjithashtu, e shpreh këtë apo atë pohim.

Pastaj ata e justifikojnë atë me vargje të shkurtra dhe me kuptimet e tyre të paqarta së jashtmi. Natyrisht, një sfond i tillë psikologjik, me ide të paramenduara, nuk siguron një kuptim të saktë të Kur'anit, madje, gjithashtu, çon në keqkuptime dhe shmangie nga e vërteta.

Në gjuhën fetare, ky lloj i të kuptuarit dhe i interpretimit të Kur'anit, është përshkruar si "interpretim spekulativ" (*tefsir bi err rrajji*) dhe konsiderohet si lloji më i keq i qasjes ndaj Kur'anit, në veçanti dhe fesë, në përgjithësi. Kur'ani e konsideron këtë lloj të qasjes ndaj fesë dhe ajeteve hyjnore, si një veprim tallës dhe kategorikisht e denoncon atë:

وَلَا تَتَّخِذُوا آيَاتِ اللَّهِ هُزُوعًا وَادْكُرُوا اللَّهَ عَلَيْهِمْ وَمَا أَنْزَلَ عَلَيْكُمْ مِنَ الْكِتَابِ وَالْحِكْمَةِ يُعْظِمُ بِهِ وَأَتَمُّوا اللَّهَ وَاعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ

**"Mos luani me Shpalljet e Allahut! Kujtoni begatitë që ju ka dhënë Ai, si dhe Librin (Kur'anin) dhe diturinë e hollësishme, që jua ka zbritur për t'ju këshilluar. Kini frikë Allahun dhe ta dini se Allahu është i Dijshëm për çdo gjë!"<sup>1</sup>**

Siç u përmend më herët, ata që përfitojnë nga udhëzimet e Kur'anit, janë pikërisht personat që kanë besim në të. Ata që duan të krijojnë arsyetim fetar apo kur'anor për prirjet e tyre personale dhe të interpretojnë Fjalën e Allahut sipas mendimit të tyre personal, në fakt, nuk kanë besim në Zot. Është e nevojshme t'i kushtojmë vëmendje disa haditheve përkatëse:

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ (ص): قَالَ اللَّهُ جَلَّ جَلَالُهُ: مَا آمَنَ بِي مَنْ فَسَّرَ بِرَأْيِهِ كَلَامِي.

I Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: "Allahu, qoftë i lavdëruar, ka thënë: 'Ai që interpreton Fjalën Time, sipas mendimit të tij, në të vërtetë nuk ka besim tek Unë'"<sup>2</sup>.

<sup>1</sup> Sure "El Bekare", ajeti 231.

<sup>2</sup> Shejkh Saduk, "Et Teuhid", f. 68.

I Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:

مَنْ فَسَّرَ الْقُرْآنَ بِرَأْيِهِ فَقَدْ افْتَرَىٰ عَلَى اللَّهِ الْكَذِبَ.

"Ai që interpreton Kur'anin sipas mendimit të tij, i ka atribuuar një gënjeshtër Allahut."<sup>1</sup>

Kështu, njeriu që ka për qëllim të interpretojë vargjet kur'anore për interesat e tij dhe ta paraqesë atë si interpretim të Kur'anit ose të Fjalës së Allahut, ka vendosur, në fakt, mendimin e tij si kriter dhe ia atribuon ato Allahut të Lartësuar. Kjo qasje ndaj Kur'anit dhe interpretimit të tij është e neveritshme dhe e rrezikshme, sepse ajo të çon në rrugë të gabuar dhe ata që kryejnë një gjynah të tillë, do të ndëshkohen me dënimet më të ashpra në Ditën e Gjykimit.

Për sa thamë më sipër, i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), gjithashtu, ka thënë:

مَنْ فَسَّرَ الْقُرْآنَ بِرَأْيِهِ فَلْيَتَّبِعُوا مَقْعَدَهُ مِنَ النَّارِ.

"Vendbanimi i atij që interpreton Kur'anin sipas mendimit të tij personal, do të jetë në zjarrin e Xhehenemit."<sup>2</sup>

Prandaj, që të jemi të sigurt nga ndëshkimi i rëndë, duhet të shmangim vënien në diskutim dhe kundërshtimin e Allahut të Lartësuar dhe të qëndrojmë larg nga rënia në kurthin e shmangies, të qëndrojmë larg nga dëshirat sensuale, t'i largohemi egoizmit, të

<sup>1</sup> "Biharul Enuar", vëll. 36, f. 227.

<sup>2</sup> "Auali ae le'ali", vëll. 4, f. 104.

kemi besim në Allahun, që është i pastër dhe nuk ka nevojë për asgjë, i don veç të mirën njerëzimit. Ne duhet të jemi të mirorientuar nga Allahu dhe t'ia nënshtrojmë veten Atij.

### ***Udhëzimi i Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), për të shmangur interpretimin spekulues***

Siç u përmend më herët, njeriu ka dëshira dhe mendime, që janë disa herë, madje në shumicën e rasteve, në kundërshtim me pikëpamjen kur'anore. Në përputhje me natyrën e tij njerëzore, ai, gjithashtu, dëshiron që Kur'ani "të miratojë" pikëpamjet dhe dëshirat e tij.

Ndonjëherë, është, gjithashtu, e mundur që këto ide, në mënyrë të pavetëdijshme ndikojnë në të kuptuarin dhe në interpretimin e Kur'anit. Satanai i është përveshur punës, duke kërkuar mundësi për të larguar grupe njerëzish nga rruga e të vërtetës, duke mashtruar intelektualët, të cilët pretendojnë se janë dijetarë fetarë. Për këtë arsye, duhet t'i kushtojmë vëmendjen e duhur kësaj pjese të deklaratës së Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*).

Në një përpjekje, për të qenë i imunizuar nga kuptimi i gabuar dhe për të shmangur devijimin e mundshëm, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:

وَاتَّبِعُوا عَلَيْهِ آرَاءَهُمْ.

*“Mos u besoni pikëpamjeve tuaja kundër tij (Kur’anit).”<sup>1</sup>*

Kjo do të thotë: Kur të angazhoheni për të kuptuar dhe për të interpretuar Kur’anin, gjeni gabimin te paragjykimet tuaja, mendimet e paramenduara, prirjet dhe pikëpamjet, krahasuar me ato të Kur’anit dhe lini mënjane mendimin tuaj personal dhe dëshirat sensuale, trupore.

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Konsiderojini dëshirat tuaja, për sa i përket Kur’anit, si të rreme.”<sup>2</sup>*

Është pranuar se kjo thënie tregon nevojën për kujdes maksimal, besueshmëri dhe devotshmëri ndaj Zotit (*takva*), në të kuptuarin dhe në interpretimin e Kur’anit të Shenjtë, pasi Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë se njeriu duhet t’i qaset Kur’anit dhe të fillojë të kuptojë dhe të interpretojë me supozimin se ai nuk di asgjë dhe çdo gjë që thuhet në të, është e vërteta:

وَاسْتَعِظُوا فِيهِ أَهْوَاءَكُمْ.

*“Konsiderojini dëshirat tuaja në çështjet e Kur’anit, si të rreme.”<sup>3</sup>*

Kjo do të thotë: Merrini dëshirat tuaja si të gabuara dhe të pahijshme, në mënyrë që të mund të përfitoni sa më shumë nga Kur’ani. Përndryshe, ju gjithmonë do të jeni në prag të gabimit dhe të devijimit.

Prandaj, thelbi i fesë, që nuk është tjetër veçse nënshtrimi ndaj Zotit, kërkon që njeriu t’i bindet plotësisht Zotit të Lartësuar

<sup>1</sup> “Nexhul Belaga”, Ligjërata 175.

<sup>2</sup> Po aty.

<sup>3</sup> Po aty.

dhe trajton si të gabuar mendimin e tij personal, në lidhje me udhëzimet dhe urdhëresat e Allahut në Kur'anin e Shenjtë. Sapo një frymë e tillë të mbizotërojë, është e qartë se ai do të kuptojë urdhërimet hyjnore, urdhërimet dhe mësimet e Kur'anit më mirë, dhe, sapo ai t'i nënshtrohet plotësisht Allahut, i pranon me gjithë zemër ato.

### ***Dy këndvështrime për trajtimin e Kur'anit dhe të mësimëve fetare***

Ka dy këndvështrime të ndryshme për trajtimin e Kur'anit të Shenjtë dhe mësimëve fetare:

1. Këndvështrimi që ka në qendër Allahun dhe frymën e dorëzimit dhe nënshtimit ndaj Tij.

2. Këndvështrimi që i konsideron dëshirat trupore të njeriut, si thelbin e krijimit dhe përpiqet të interpretojë dhe të kuptojë tekstet fetare dhe mësimet e Kur'anit mbi këtë bazë, i njohur sot si "humanizëm", domethënë, me njeriun në qendër, krahasuar me Zotin në qendër.

Duket se klasifikimi i lartpërmendur është përtej çështjeve dhe diskutimeve të mëparshme, sepse tashmë është supozuar që ka dy mënyra të mundshme të të kuptuarit të Kur'anit. Njëra ka të bëjë me frymën e dorëzimit dhe të nënshtimit ndaj Zotit dhe tjera është ndoshta një efekt nga dëshirat sensuale, trupore.

Prandaj, për të shmangur interpretimin spekulues, në të kuptuarin dhe interpretimin e Kur'anit, si dhe për ta kuptuar atë

saktë, kemi shpjeguar këshillat përkatëse të Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) në domosdoshmërinë e shmangies së paragjykimeve dhe spastrimin e mendjes nga dëshirat trupore.

Në këtë këndvështrim, ne konsiderojmë të dy grupet e adresimit të Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) si myslimanë. Në një përpjekje për të shmangur devijimin në fe dhe të bien në humnerën e *Tefsirit Bi'r rejit*, respektimi i devotshmërisë dhe përmbajtja nga dëshira sensuale dhe paragjykimet, është i domosdoshëm.

Duke përshkruar karakteristikat e secilit grup, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) paraqet dy grupe:

1. Njëri grup përbëhet nga ata që e kanë pranuar plotësisht “robërinë” dhe nënshtrimin e tyre ndaj Zotit dhe janë të vendosur për të luftuar dëshirat e tyre sensuale dhe për t’i dhënë përparësi vullnetit dhe kënaqësisë së Allahut kundrejt trilleve dhe tekave të tyre. Natyrisht, individë të tillë, që me gjithë zemër njohin këtë Libër Qiellor, Kur’anin, singerisht pranojnë urdhëresat dhe mësimet e tij dhe e konsiderojnë atë si udhërrëfyes të tyre në praktikë dhe përpiqen të zbatojnë ritet e tij.

Duke përshkruar këtë grup, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:

عِبَادَ اللَّهِ، لِمَنْ مِنْ أَحِبِّ عِبَادِ اللَّهِ إِلَيْهِ عَبْدًا أَعَانَهُ اللَّهُ عَلَى تَشْيِهِ.

“Vërtet, Allahu i do më shumë ata që u ka dhënë forcë (për të vepruar) kundër pasioneve të tyre.”<sup>1</sup>

<sup>1</sup> “Nehxhul Belaga”, Ligjërata 86.

Pastaj, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka deklaruar statusin e Kur'anit midis këtyre njerëzve:

قَدْ أَمَكَرَ الْكِتَابَ مِنْ زَمَائِهِ، فَهُوَ قَائِدُهُ وَإِمَامُهُ، يُحَلُّ حَيْثُ حَلَّ مُنْجِلُهُ، وَيُنزَلُ حَيْثُ كَانَ مَنزِلُهُ.

*"... Prandaj Kur'ani është udhëzues dhe udhëheqësi i tij. Ai ulet, kur Kur'ani e ul atë dhe vendoset atje ku Kur'ani e vendos atë."*<sup>1</sup>

Ky grupim ka pranuar Kur'anin dhe të vërtetat e fesë, si një tërësi të realiteteve objektive dhe ka besim në to. Ai konsideron dekretet dhe urdhëresat fetare të Kur'anit të Shenjtë si përfshirëse të realitetit objektiv dhe i quan ata si të lidhur direkt me shpëtimin e tij dhe shkeljen e tyre si shkakun e humbjes në këtë botë e dhe në Botën Tjetër.

Pasi këta individë nuk kanë asnjë mendim, ose pikëpamje të tyre, ata besojnë në fe, në shkrimet e shenjta, në urdhëresat dhe mësimet hyjnore. Kanë besim në marrëdhëniet shkakësore ndërmjet tyre dhe mirëqenien e njerëzimit, përpiqen shumë për të kuptuar saktësisht Kur'anin, të dinë saktësisht se çfarë urdhëron. Më pas, e ndjekin atë.

2. Krahasimisht me grupin e parë, ka njerëz që mendojnë se Kur'ani, ose ndonjë tekst apo shkrim tjetër fetar për këto çështje, varet në atë çka individët mendojnë dhe nuk flet për çështje absolute dhe të veçanta lëndore.

Kur'ani apo ndonjë tekst fetar, është i lirë nga kuptimi dhe përmbajtja dhe nuk ka asnjë qëllim të lindur. Çdo person ka idetë e tij, që rrjedhin nga prejardhja e tij arsimore, familja e tij, shoqëria

<sup>1</sup> Po aty.



dhe të tjera si kjo. Pasi vjen pranë Kur'anit, ai dedukton pika të caktuara, bazuar në idetë e tij personale, ndërsa Kur'ani, në të vërtetë, nuk shpreh këto çështje.

Në fakt, ky është kuptimi i tij, që është diskutuar nën petkun e Kur'anit. Natyrisht, duke pasur parasysh këtë pikëpamje dhe këtë mendim, feja, Kur'ani, ajetet dhe urdhëresat e tij trajtohen si fjalë dhe korniza, të cilave u mungon çdo përmbajtje dhe janë idetë e njeriut që i japin kuptim këtyre fjalëve.

Sipas idesë së lartpërmendur, pretendohet se Kur'ani apo ndonjë tekst fetar, nuk ka asgjë për të thënë. Përkundrazi, çdo njeri kupton diçka nga Kur'ani apo ndonjë tekst fetar sipas mentalitetit apo mendësisë së vet. Natyrisht, ky lloj botëkuptimi është, në fakt, një tallje e fesë dhe e besimtarit.

### ***Pluralizmi fetar apo mohimi i fesë, nën petkun e "interpretimeve të ndryshme"***

Është e qartë se ajo që është paraqitur sot në shoqërinë tonë si "interpretime të ndryshme të fesë", buron nga grupi i dytë. Edhe pse termi i lartpërmendur është paraqitur nga të ashtuquajturit intelektualë myslimanë, thelbi i nocionit të "interpretimeve të ndryshme të fesë" duhet të kërkohet te humanizmi, ose përqendrimi te njeriu.

Siç u tha më parë, nocioni konsideron vlerësimet fetare, urdhëresat e shkrimeve qiellore si të pakuptimta dhe pohojnë se Kur'ani apo ndonjë tekst tjetër fetar është i heshtur dhe nuk ka asnjë

kuptim dhe koncept. Në fakt, jemi ne njerëzit, që kemi vetë paragjykimet tona, të cilët ia atribuojmë të kuptuarit dhe interpretimin tonë fesë dhe Kur'anit. Prandaj, Kur'ani nuk ka mesazhin e vet dhe nuk flet për ndonjë të vërtetë.

Me qëllim të qartësimit të natyrës së këtij mendimi dhe për të kuptuar argumentin e përkrahësve të tij mbi "heshtjen e fesë" dhe mundësinë e interpretimeve të ndryshme, citimi i një shembulli mund të rezultojë i dobishëm.

Ndoshta, të gjithë janë pak a shumë të njohur me Divanin (përmbledhje me poezi) e Hafizit,<sup>1</sup> gazelet (poezi dashurie)<sup>2</sup> dhe poezi të tjera të këtij poeti të madh dhe mistiku të shquar. Leximet e ndryshme të poezive të Hafizit dhe poezitë e këtij poeti të madh, do të shprehin se hartuesi i tyre nuk thotë asgjë me fjalët dhe shprehjet e përdorura në poezi.

Ai ka vënë vetëm fjalë dhe shprehje të pakuptimta së bashku, në një formë ritmike dhe i ka sistemuar ato si korniza boshe, por, natyrisht, me një ritëm shumë elegant dhe tërheqës. Kjo do të thotë se poeti i reciton ato, ndërsa nuk ka kuptim, qëllim dhe synim në mendje.

Në përputhje me nocionin e leximeve të ndryshme, thuhet se gazelet (lirikat e dashurisë) dhe poezi të tjera të Hafizit janë të lira nga çdo kuptim. Duke u konsultuar me librin, për një qëllim

---

<sup>1</sup> Khuaxhah Shemsud'din Muhamed Hafiz Shirazi (rreth 1325-1391), shkrimtari, poeti, persian i shekullit të katërbëdhjetë. Konsiderohet si mjeshtër i shquar i traditës të të shkruarit Ghazel. (Përkthyesi)

<sup>2</sup> Gazel është një formë lirike e poezisë persiane, me disa dyvargësha me rimë, që i këndon dashurisë e gëzimeve të jetës dhe shpreh ndjenjat e brendshme të poetit. (Përkthyesi)

ose një mendim të veçantë, çdokush hap librin e Hafizit dhe interpreton poezinë e parë në një faqe ose një gazel në një mënyrë të caktuar. Për shembull, ai që ka një pacient dhe dëshiron shërimin e tij, konsultohet me librin dhe e kupton nga një gazelë se pacienti i tij nuk do të bëhet më mirë.

Një person tjetër, i cili ka një borxh, kupton nga i njëjti gazel se ai së shpejti do ta paguajë atë. Një person i tretë, i cili shpreson për kthimin në shtëpi të një të dashuri, i cili është në një udhëtim, merr lajmin e gëzuar për kthimin e tij. Në përgjithësi, të gjithë kuptojnë diçka nga këto fjalë, sipas mentalitetit të tij. Në të vërtetë, është individi ai që i jep librit të Hafizit fuqinë e fjalës.

Gjithkush, në fjalët e tij në gojën e Hafizit dhe të gjitha interpretimet, arsyetimet dhe perceptimet janë konsideruar të sakta, sepse këto kuptime janë ato të individëve, ndërsa shprehjet, fjalët, gazelet dhe poezitë e tjera janë marrë si të pakuptimta.

Kjo ide është saktësisht e njëjtë si “interpretime të ndryshme të fesë”, e cila e konsideron Kur’anin apo ndonjë tekst fetar të pakuptimtë dhe pa ndonjë mesazh apo domethënie. Ithtarët e kësaj ideje hamendësojnë se Kur’ani nuk thotë se çfarë duhet të bëjmë ose të mos bëjmë dhe çfarë është e vërtetë dhe e saktë apo atë që është e rreme dhe e gabuar. Përkundrazi, janë individët, që interpretojnë të vërtetën dhe të pavërtetën nga Kur’ani, në përputhje me botëkuptimin e tyre. Pasi këto gjëra vijnë nga mendjet e individëve, të gjitha mund të konsiderohen të sakta.

Në fakt, për t’i gjykuar ato si të sakta, ose ndryshe është e pakuptimtë, për shkak se të gjitha interpretimet e ndryshme të një ajeti, edhe pse kontradiktore me njëri-tjetrin, konsiderohen si

korrekte. Një person e kupton nga një gazelë e Hafizit, se pacienti i tij do ta marrë veten. Një person tjetër mëson nga ajo se i dashuri i tij, i cili po udhëton, do të kthehet së shpejti. Një person i tretë bëhet i pashpresë dhe pret vdekjen e pacientit të tij.

Ithtarët e idesë "interpretime të ndryshme të fesë", pohojnë se Kur'ani apo ndonjë tekst fetar është, gjithashtu, i tillë. Ata besojnë se individët nuk janë menduar të akuzojnë njëri-tjetrin për keqkuptimin e Kur'anit, sepse të kuptuarit e tij nuk kërkon ndonjë njohuri speciale, sepse Kur'ani apo ndonjë tekst fetar nuk ka mesazh të vetin, që ai të jetë i kuptueshëm.

Problemi i çështjes është se "të kuptuarit" është brenda sferës së njeriut. Sipas mendimit tonë, promovimi i kësaj ideje ka për qëllim të arrijë synime të caktuara politike, por kjo është quajtur dhe është reklamuar si teoria epistemologjike dhe emërtohet "interpretim i ri i fesë", "rrugë të drejta" e të tjera si këto.

Pluralizmi fetar, i paraqitur në kuadër të "interpretimeve të ndryshme të fesë", nuk është arsyetuar e nuk është vërtetuar në mënyrë shumë logjike dhe racionale. Kur një njeri racional dhe i arsyeshëm shqyrton rrënjët e kësaj ideje dhe ndikimet e saj, ai padyshim do të miratojë falsitetin dhe kotësinë e saj. Nga ana tjetër, duke pasur parasysh ndikimin shkatërrues të mendimit pluralist në shoqërinë fetare, kjo nuk mund të injorohet lehtë.

Prej kurtheve më mashtruese të shejtanit, ky armik i përbetuar i njeriut, që në kohën e krijimit të Ademit e deri sot, për të mashtruar adhuruesit e Allahut dhe monoteistët, është avancimi i mendimit të "interpretimeve të ndryshme të fesë.

Frymëzuar nga mendimi satanik, të ashtuquajturit intelektualë, nxitojnë për të ndihmuar djallin dhe ushtrinë të gjitha përpjekjet për ta ndihmuar atë në këtë drejtim. Ata kanë vendosur talentet dhe aftësitë e të shprehurit me gojë dhe me shkrim në dispozicion të djallit, duke e kthyer veten në marioneta për devijimin e njerëzve nga rruga e drejtë.

Ne duhet të mendojmë sa më shumë të jetë e mundur për kuptimin e vërtetë të “interpretimeve të ndryshme të fesë” ose “rrugëve të drejta” dhe të reflektojmë mbi ndikimet shkatërruese dhe pasojat e këtij mendimi ateist, në mënyrë që të mund të gjejmë qëllimet e themeluesve dhe të ithtarëve të kësaj gracke satanike dhe të kuptojmë intensitetin e lëvizjes së tyre.

Në çdo rast, sa herë që krahasojmë këtë prirje me atë të grupit të parë, do të gjejmë se fryma e tendencës së parë është përqendrimi tek Allahu apo robëria dhe nënshtrimi ndaj Zotit të Lartësuar dhe fryma e tendencës së dytë është përqendrimi te njeriu, ose të qëndruarit larg Zotit dhe urdhërimeve të Tij.

Në prirjen e parë, janë ushtruar përpjekje, në përgjithësi, për njeriun, që të pranojë robërinë e tij ndaj Allahut të Lartësuar, ndërsa në prirjen e dytë, përpjekjet janë ushtruar që njeriu të mohojë nënshtrimin e tij para Allahut dhe të kënaqë prirjet dhe pasionet e tij shtazarake. Kjo prirje përcakton dëshirat e njeriut si bazë dhe përpiket të interpretojë dhe të justifikojë besimin ose Kur’anin sipas tyre.

Ndoshta, kjo është një nga arsyet se pse Kur’ani, në përshkrimin që bën, thekson:

تِلْكَ آيَاتُ الْكِتَابِ وَ الْقُرْآنِ مُبِينٍ

"Këto janë vargjet e Librit dhe të Kur'anit të qartë."<sup>1</sup>

بِلِسَانٍ عَرَبِيٍّ مُبِينٍ

"E zbriti në gjuhën e qartë arabe."<sup>2</sup>

تِلْكَ آيَاتُ الْقُرْآنِ وَكِتَابٍ مُبِينٍ

"Këto janë vargjet e Kur'anit, të një Librit të qartë."<sup>3</sup> dhe

قَدْ جَاءَكُمْ مِنَ اللَّهِ نُورٌ وَكِتَابٌ مُبِينٌ

**"(Vërtet), juve ju erdhi prej Allahut dritë (i Dërguari) dhe Libër i qartë (Kur'ani)."**<sup>4</sup>

Në këto ajete nënvizohet qartësia, shkëlqimi dhe ekspresiviteti i Kur'anit. Është saktësisht për të parandaluar mendimet dinake si "interpretime të ndryshme të fesë" dhe të përgënjeshtrojnë çdo pohim të paqartësisë dhe të pasaktësisë në domethënien dhe thelbin e kuptimit të Kur'anit.

Kështu, Kur'ani është Libri i udhëzimit, në të cilin Allahu i Lartësuar ka shprehur të gjitha të vërtetat e nevojshme për lumturinë e njeriut në këtë botë dhe në Botën Tjetër. Duke reflektuar mbi Kur'anin, myslimanët janë të detyruar të njohin detyrat e tyre individuale dhe sociale, duke siguruar shpëtimin e

<sup>1</sup> Sure "Hixhr", ajeti 1.

<sup>2</sup> Sure "Esh Shu'ara", ajeti 195.

<sup>3</sup> Sure "En Neml", ajeti 1.

<sup>4</sup> Sure "El Maide", ajeti 15.

tyre nëpërmjet ndjekjes dhe zbatimit të urdhëresave të tij. Ndërkohë, pyetja se kush është personi kompetent për të interpretuar Kur'anin dhe mësimet fetare, është një temë me të cilën duhet të merremi tani.

### ***Domosdoshmëria për të fituar aftësi për kuptimin dhe interpretimin e Kur'anit***

Është e qartë se jo të gjithë mund ta kuptojnë dhe ta interpretojnë Kur'anin, ashtu si jo të gjithë mund të kuptojnë faktet delikate shkencore në çdo fushë apo sferë. Për të kuptuar ekuacionet e ndërlikuara matematikore apo hollësitë e shkencave të tjera, është aftësi vetëm për ekspertët. Ata që nuk janë ekspertë, jo vetëm janë të paaftë për të shprehur pikëpamjet e tyre në këtë drejtim, por idetë e tyre nuk kanë aspak vlerë.

Në lidhje me Kur'anin, pikëpamjeve të atyre që nuk janë njohur me shkencat dhe mësimet fetare, u mungojnë vlerat dhe rëndësia. Është e vërtetë se Kur'ani është shpallur në një gjuhë të qartë dhe elokuente, në mënyrë që njerëzit të mund ta kuptojnë dhe ta vënë atë në praktikë, por kjo nuk do të thotë se thellësia e njohurive të tij (*ma'arif*) mund të kuptohet në mënyrë uniforme e të njëtrajtshme nga të gjithë njësoj.

Ajo që mund të kuptohet nga njerëzit e thjeshtë nga Kur'ani, është shkalla e të kuptuarit që vetë Kur'ani përmend me qëllimin: "*Ne e shpallëm Kur'anin në një gjuhë të thjeshtë.*" Kjo do të thotë: Kur'ani është shpallur e është zbuluar në mënyrë të tillë, që kushdo që e di arabishten dhe zotëron frymën e nënshtrimit ndaj Allahut,

mund ta kuptojë atë dhe të përfitojë prej tij sipas nivelit të vet intelektual. Megjithatë, për të kuptuar domethënien dhe njohuritë (*ma'arif*) e Kur'anit, është i nevojshëm një reflektim dhe mendim i thellë. Në lidhje me këtë, Kur'ani thotë:

إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ قُرْآنًا عَرَبِيًّا لَعَلَّكُمْ تَعْقِلُونَ

"Në të vërtetë, Ne e zbritëm këtë Kur'an në gjuhën arabe, për ta kuptuar ju."<sup>1</sup>

إِنَّا جَعَلْنَاهُ قُرْآنًا عَرَبِيًّا لَعَلَّكُمْ تَعْقِلُونَ

"Në të vërtetë, Ne e kemi shpallur Kur'anin në gjuhën arabe, që të mund ta kuptoni ju."<sup>2</sup>

Në përgjithësi, vargjet që e ftojnë njerëzimin të reflektojnë dhe të kuptojnë Kur'anin dhe udhëzimet e tij, na thonë se ne nuk duhet të mjaftohemi vetëm nga kuptimet e dukshme të Kur'anit. Në vend të kësaj, duke u mbështetur në reflektimin, arsyen dhe njohuritë e Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*), duhet të shqyrtojmë në thellësi dhe detaje Kur'anin dhe të përfitojmë nga ky thesar i dijes hyjnore më shumë se kurrë.

Prandaj, për të kuptuar Kur'anin dhe për të interpretuar njohuritë e tij sublime (*ma'arif*), është vetëm aftësi e ekspertëve, të cilët janë të njohur me njohuritë e Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*). Një rishtar, pa pasur ndonjë njohuri për fenë dhe pa pasur njohuri për rregullat që rregullojnë interpretimin (*Tefsir*) e Kur'anit, nuk ka të drejtë të shprehë ndonjë mendim apo të thotë ndonjë gjë me

<sup>1</sup> Sure "Jusuf", ajeti 2.

<sup>2</sup> Sure "Ez Zukhruf", ajeti 3.



justifikimin e “interpretimit të ri të fesë dhe ligjeve dhe udhëzimeve të saj.”

### ***Shkallët e ndryshme të domethënies dhe të kuptimit të koncepteve kur'anore***

Shumë tradita (hadithe) që tregojnë aspekte të brendshme (*batin*) dhe të jashtme (*zahir*) të dijes kur'anore (*ma'arif*) mund të citohen dhe jo gjithkush është në gjendje të dallojë thellësinë e saj. Siç u tha më parë, Kur'ani është një oqean i thellë dhe i pakufishëm.

Në varësi të dijes së njeriut dhe aftësisë së tij për zhytje, çdokush mund të shkojë në kërkim për këtë xhevahir oqeanik të dijes, të zhytet përtej aspekteve të jashtme (*zavahir*), të kuptojë njohuritë e tij në thellësi dhe të dëshmojë fakte të ndryshme të kuptimeve të ndryshme nga një ajet i vetëm, pa kundërshtimin më të vogël. Kjo është, në vetvete, një nga mrekullitë (*mu'xhizat*) e Kur'anit.

Për shembull, Kur'ani thotë:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا اللَّهَ الْغَنِيُّ الْغَنِيُّ  
وَإِلَى اللَّهِ وَاللَّهُ هُوَ الْغَنِيُّ الْغَنِيُّ

"O njerëz! Ju jeni të varfër dhe nevojtarë për Allahun, kurse Allahu s'ka nevojë për asgjë dhe është Ai është i Denjë për çdo lavd."<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Sure "Fatir", ajeti 15.

Ajo që njerëzit e thjeshtë kuptojnë nga ky ajet, në pamje të jashtme, është se ne kemi nevojë për Allahun e Lartësuar, i cili nuk ka nevojë për asgjë dhe Ai është i denjë për çdo lavd. Nga fjala "fakr"-*"varfëri"*, ajo që u vjen ndërmend njerëzve të thjeshtë, janë nevojat njerëzore për mbijetesë, të tilla, si: ushqim, veshje, etj.

Duke krijuar shkaqet dhe pasojat e tyre, Allahu i Lartësuar siguron mjetet për mbijetesë, dhe zhvillimin e njeriut. Në këtë nivel të të kuptuarit, që është niveli i jashtëm, Kur'ani është i qartë dhe i dukshëm dhe të gjithë ata që e njohin gjuhën e tij, mund ta kuptojnë atë mirë. Megjithatë kjo nuk do të thotë se një tjetër kuptim, i cili është më i thellë se kuptimi i jashtëm, nuk mund të nxirret prej tij dhe ajeti i lartpërmendur nuk tregon për ndonjë fakt më të thellë nga ajo që njerëzit e thjeshtë kuptojnë.

Sa më shumë është njohur një person me temat e ndryshme të teologjisë skolastike (*'ilm el-kelem*) dhe nuancat letrare të gjuhës arabe, aq më shumë reflekton dhe peshon çdo varg dhe gjen kuptime më të holla dhe më të thella se sa kuptimet e dukshme të Kur'anit.

Nëse ne përpiqemi të reflektojmë pak më thellë në këtë ajet, do të kuptojmë se varfëria jonë dhe nevoja për Allahun e Lartësuar është përtej nevojës për gjëra ushqimore, veshje, shëndet dhe gjëra materiale. Ne jemi në varfëri absolute, ndërsa Allahu nuk ka asnjë nevojë. Ne jemi në thelb të varfër (*Fakir bi'dh dhat*), ndërsa Allahu nuk ka nevojë në thelb (*Ghani bi'dhdhat*). Fjalë për fjalë, "të varfër" i referohet një personi, të cilit i janë thyer kolonat ku ai mbështetet dhe është i paaftë të qëndrojë në këmbë.

Sifjalia: “Njeriu është i varfër”, do të thotë se edhe në qoftë se të gjitha gjërat materiale janë siguruar për të, ekzistenca e tij është me mangësi dhe e varur. Thelbi i ekzistencës sonë ka nevojë për Allahun. Është Allahu i Lartësuar, Ai që na ka krijuar. Duke krijuar shkaqet dhe pasojat e ekzistencës, është Ai që ka pajisur tokën për ekzistencën dhe zhvillimin e njeriut. Nga natyra dhe thelbi i qenies sonë, ne jemi të varfër dhe nevojtarë, ndërsa Allahu, pa nevoja, në thelb.

Është e qartë se pikëpamja e dytë është më e thellë se e para. Kuptimi i parë dhe i dytë konsiderohen përkatësisht si të “jashtme” dhe “të brendshme”. Kuptimi më i thellë është i dyti. Them i se qeniet njerëzore nuk janë vetëm të varfra dhe nevojtare nga natyra e ekzistencës së tyre, por nga natyra e vet e “nevojës”.

Nevoja e tyre për ekzistencë është lidhja e tyre me Allahun e Lartësuar. Sigurisht, për të kuptuar të vërtetën e kuptimit të tretë, është përtej aftësive të njerëzve të thjeshtë.

Duhet të theksohet se të tri interpretimet e këtij ajeti ecin paralelisht. Të tria janë të sakta dhe të drejta. Asnjë prej tyre nuk kundërshton tjetrën. Megjithatë, për nga thellësia, ato nuk janë të të njëjtit nivel. Nuk është e saktë të thuhet se të gjitha shkallët e kuptimeve të Kur’anit janë universalisht të kuptueshme dhe se të gjithë njerëzit e kanë forcën dhe aftësinë për të kuptuar të gjitha nivelet dhe shkallët e Kur’anit.

Është e nevojshme të theksohet se pas të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), vetëm Imamët e Pagabueshëm (*Paqja qoftë mbi ta!*), me anë të frymëzimit

hyjnor, zotërojnë njohuritë për shkencat e Kur'anit dhe njohin aspektet e brendshme të këtij Libri të madh Qiellor.

Në këtë aspekt, ne do të citojmë pjesërisht një hadith të rëndësishëm:

عَنْ أَبِي جَعْفَرٍ (ع) قَالَ يَا جَابِرُ! إِنَّ لِلْقُرْآنِ بَطْنًا وَالبطن بطنٌ وَأَهَ ظَهْرٌ وَالظَّهْرُ ظَهْرٌ يَا جَابِرُ! وَلَيْسَ شَيْءٌ أَبْعَدُ مِنْ عُقُولِ الرِّجَالِ مِنْ تَفْسِيرِ الْقُرْآنِ إِنَّ الْآيَةَ يَكُونُ أَوَّلُهَا فِي شَيْءٍ وَآخِرُهَا فِي شَيْءٍ وَهُوَ كَلَامٌ مُتَّصِلٌ يَبْحَثُ عَلَى وُجُوهٍ.

Ebu Xhaferi (Imam Muhamed El Bakir) ka thënë: "O Xhabir! Kur'ani ka një brendësi (batin) dhe kjo brendësi ekziston brenda një brendësie. Ajo, gjithashtu, ka një anë të jashtme, ose të dukshme (zahir) dhe kjo e jashtme është brenda një të jashtmeje tjetër. O Xhabir! Gjithashtu, dije se mendjet e njerëzve janë të paafta për interpretimin e Kur'anit. Me të vërtetë, pjesa e parë e një ajeti mund të trajtojë një gjë, ndërsa pjesa e fundit e ajetit mund të merret me një gjë tjetër. Ai përbëhet nga fjalë të lidhura së bashku me aftësinë për të pasur kuptime të ndryshme (por pa qenë në kundërshtim me njëri-tjetrin)."<sup>1</sup>

Ajo që është theksuar këtu është se të kuptuarit e thelbit të brendshëm dhe hollësitë e Kur'anit, nuk mund të kapen prej të gjithëve. Sigurisht, kjo nuk do të thotë se Kur'ani është shpallur vetëm për Imamët e Pagabueshëm dhe dijetarët, ndërsa të tjerët janë të paaftë për të kuptuar Kur'anin, edhe së jashtmi.

Në fakt, kuptimi i jashtëm i Kur'anit mund të jetë i dobishëm për të gjithë, në varësi të talentit, nivelit të të kuptuarit dhe dallimit, me kusht që ai lë mënjanë paragjykimet e tij, si dhe dëshirat dhe prirjet sensuale dhe shmang interpretimet spekulative.

<sup>1</sup> "Biharul Enuar", vëll. 92, f. 91.

Në lidhje me të kuptuarin e Kur'anit, njeriu duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë disa pikave të caktuara, të cilat ne do t'i trajtojmë në nëntitullin e mëposhtëm.

***Kufizimi i interpretimit të Kur'anit nga i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe Imamët e Pagabueshëm në shpjegimin, ose në parashtrimin e ligjeve***

Siç u tha dhe provua në pjesën përkatëse, një nga funksionet e të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), përveç marrjes dhe transmetimit të Shpalljes, ishte shpjegimi, sqarimi i ligjeve dhe i dekreteve hyjnore. Kur'ani i është shpallur Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në formën e një tërësie ligjesh të përgjithshme, të dhënat e të cilave nuk janë sqaruar në detaje, përveç në disa raste të veçanta.

Shpjegimet e tyre të hollësishme i ishin caktuar Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe pas kësaj, Imamëve të Pagabueshëm. Për shembull, Kur'ani urdhëron lutjen rituale, namazin, në terma të përgjithshme dhe u bën thirrje myslimanëve që të falin namazin, por procedura e saj, numri i rekateve, mënyra e recitimit, kushtet dhe detajet e tij, nuk janë përmendur në Kur'an. Shpjegimi i hollësishëm i këtyre ligjeve të përgjithshme dhe të tjera si këto, ka qenë e caktuar për Profetin Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Kështu, interpretimi dhe sqarimi i ligjeve hyjnore i është caktuar Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Kjo është një nga funksionet e tij profetike.

Kur'ani, gjithashtu, i kushton vëmendje shpjegimit të Shpalljes dhe e konsideron atë si një prej detyrave të të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kur thotë:

وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الذِّكْرَ لِتُبَيِّنَ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ

**"...Ndërsa ty (o Muhamed) të zbritëm Përkujtesën (Kur'anin), në mënyrë që t'u shpjegosh njerëzve atë që u është Shpallur dhe atë që ata mendojnë."**<sup>1</sup>

Ka të ngjarë që domethënia e "mësimit" në ajetet si ajeti 164 i sures "Ali Imran", në të cilën "mësimi" është përmendur së bashku me "recitimin", gjithashtu, nënkupton pozitën dhe funksionin e të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në sqarimin dhe interpretimin e shpalljeve kur'anore.

Në të vërtetë, ndërsa përçon Shpalljen, i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka kryer dy funksione, d.m.th, duke i recituar fjalët e shpallura njerëzve dhe, duke sqaruar dhe duke interpretuar kuptimin dhe domethënien e tyre, i njeh ata me ligjet dhe me mësimet e Kur'anit. Në lidhje me këtë, Kur'ani thotë:

<sup>1</sup> Sure "En Nahl", ajeti 44.

لَقَدْ مَنَّ اللَّهُ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ إِذْ بَعَثَ فِيهِمْ رَسُولًا مِنْ أَنْفُسِهِمْ يَتْلُو عَلَيْهِمْ آيَاتِهِ وَيُزَكِّيهِمْ وَيُعَلِّمُهُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَإِنْ كَانُوا مِنْ قَبْلُ لَفِي ضَلَالٍ مُبِينٍ

**“Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u sollli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon Shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kur’anin) e urtësinë (diturinë e thellë fetare), edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në rrugë krejt të gabuar.”<sup>1</sup>**

Në këtë ajet dhe në ajete të ngjashme, detyra e parë përmendet me frazën “të recitojë” (*jatlu*), më pas përmendet detyra e dytë, duke përdor fjalën “t’u mësojë” (*ta’lim*).

Në përfundim, sqarimi i zbulësës dhe shpjegimi i hollësishëm i ligjeve hyjnore dhe komentimi i Kur’anit të Shenjtë, në kuptimin e mësipërm, është një funksion, që është vetëm në kompetencë të të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe të Imamëve të Pagabueshëm, sepse ata janë të vetmit që janë bekuar me njohuri hyjnore dhe me urtësinë e Allahut.

---

<sup>1</sup> Sure “Ali Imran”, ajeti 164.

***Përvetësimi i njohurive të dhëna nga Ehli Bejti (Paqja qofte mbi ta!), si një parakusht në të kuptuarin dhe në interpretimin e Kur'anit***

Detyra e interpretuesve të Kur'anit (*mufassirin*) është mjaft e qartë. Siç është theksuar më parë, sqarimi i Shpalljes, shpjegimi i hollësishëm i ligjeve dhe interpretimi i ajeteve kur'anore janë, në thelb, detyra të dhëna për të të Dërguarin e Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili, gjatë jetës së tij të bekuar, i njohu njerëzit, sa herë ishte e mundur me mësimet dhe me udhëzimet e Kur'anit.

Sot, komentuesit janë të detyruar t'u referohen traditave autentike (haditheve) dhe transmetimeve (*rivajate*) të raportuara nga i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në këtë drejtim. Në bazë të këtyre haditheve, ata duhet të shqyrtojnë nga afër dhe të këqyrin ajetetet përkatëse dhe të organizojnë mendimet e tyre, në kuadrin e përshkrimeve dhe të shpjegimeve të të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Prandaj, kriteri i parë për kuptimin e saktë të Kur'anit dhe të mësimave fetare është sqarimi apo shpjegimi transmetuar nga i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe Imamët e Pagabueshëm për ne. Për këtë arsye, detyra e parë dhe më kryesorja e një interpretuesi është të kuptojë dhe të shpjegojë interpretimin që është transmetuar nga Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe nga Imamët e Pagabueshëm, sepse vetëm në dritën e



njohurive të Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*) mund të kuptohen shkencat e Kur'anit.

### ***Interpretimi i Kur'anit përmes Kur'anit***

Pika e tretë, që është shumë e rëndësishme dhe e domosdoshme që t'i kushtojmë vëmendje, për të kuptuar drejt fjalët e shpallura, është çështja e interpretimit të Kur'anit me anë të vetë Kur'anit, duke i kushtuar vëmendje lidhjeve konkrete midis ajeteve.

Është e vërtetë se ajetet e Kur'anit janë, me sa duket, të ndara dhe çdo ajet apo grup i ajeteve, në dukje, flet për një temë të caktuar, por kuptimi i drejtë apo interpretimi i duhur është i mundur vetëm kur ajetet e Kur'anit konsiderohen të lidhura bashkë. Shumë ajete dhe pika të këtij Libri Hyjnor interpretojnë njëri-tjetrin dhe janë dëshmi për vërtetësinë dhe aktualitetin e tyre.

Në këtë drejtim, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), thotë:

كِتَابُ اللَّهِ يُبَصِّرُونَ بِهِ، وَتَنْطَلِقُونَ بِهِ، وَتَسْمَعُونَ بِهِ، وَيَنْطَلِقُ بَعْضُهُ بِبَعْضٍ، وَيَشْهَدُ بَعْضُهُ عَلَى بَعْضٍ، وَلَا يَخْتَلِفُ فِي اللَّهِ، وَلَا يَخَالِفُ بِصَاحِبِهِ عَنِ اللَّهِ.

*“Libri i Allahut është libri përmes të cilit ju shihni, flisni dhe dëgjoni. Një pjesë e tij flet për pjesën tjetër dhe një pjesë dëshmon për tjetrën. Ai nuk krijon dallime rreth Allahut, as nuk çorienton ndjekësit e vet nga (rruga e) Allahut.”<sup>1</sup>*

<sup>1</sup> “Nehxhul Belaga”, Ligjërata 133.

Ndër rastet e interpretimit të Kur'anit me anë të vetë Kur'anit, mund të përmendin për shembull ajetin 11 të sures "Esh Shura" dhe ajetin 10 të sures "El Fet'h".

لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ وَهُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ

**"Asgjë dhe askush nuk i shëmbëllen Atij. Ai i dëgjon të gjitha dhe i sheh të gjitha"**<sup>1</sup>

يَدُ اللَّهِ فَوْقَ أَيْدِيهِمْ

**"Dora e Allahut është mbi duart e tyre."**<sup>2</sup>

**"Asgjë nuk është si Ai"** është një prej ajeteve të sakta (*muhkamat*) të Kur'anit dhe kuptimi i tij është i qartë dhe i kuptueshëm. Ky ajet thekson se asgjë nuk është si Ai, që është Zoti i Lartësuar, është Realiteti i vetëm. Ajeti i dytë thotë se **"dora e Allahut është mbi duart e tyre"**. Është e vërtetë se ky ajet i ka atribuuar një "dorë" Allahut, por ajeti i parë mohon këtë kuptim në dukje dhe në funksion të të cilit ne mund të kuptojmë se me fjalën *"jad"* nuk jepet kuptimi i saj i dukshëm, d.m.th *"dora"*.

Kjo më tepër i referohet kuptimit alegorik që është "pushtet" apo e ngjashme me të. Kështu, interpretimi dhe parashtrimi në ajetin: **"Dora e Allahut është mbi duart e tyre"**, pa i kushtuar vëmendje ajetit: **"Asgjë nuk është si Ai"**, është jashtë metodës së duhur të interpretimit dhe për shkak të këtij interpretimi të gabuar, ajo mund të çojë në paraqitjen e një përfaqësimi të gabuar antropomorfik të Zotit.

<sup>1</sup> Sure "Esh Shura", ajeti 11.

<sup>2</sup> Sure "El Fet'h", ajeti 10.

Si i tillë, në interpretimin e Kur'anit ne duhet t'i kushtojmë vëmendje ajeteve në lidhje me njëri-tjetrin, për të kuptuar domethënien e tyre me anë të vetë Kur'anit.

### ***Respektimi i parimeve dhe i rregullave të diskursit intelektual në kuptimin e Kur'anit***

Pika e katërt, që duhet të theksohet në interpretimin e saktë dhe në të kuptuarin e Kur'anit, është respektimi i parimeve dhe i rregullave të diskursit intelektual, sidomos kur nuk ka hadithe të vlefshme autentike në dispozicion, apo shpjegim të qartë nga i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ose nga Imamët e Pagabueshëm, domosdoshmëria e respektimit të parimeve dhe të rregullave të diskursit intelektual është e shumëfishtë. Pikërisht në këtë fazë, bëhet i domosdoshëm roli i njerëzve të shquar të fesë dhe i atyre që kanë fituar njohuritë e Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*).

Janë njerëzit ata që, në përputhje me parimet e diskursit intelektual, identifikojnë urdhëresat e përgjithshme dhe urdhëresat e veçanta (*khass*) të Kur'anit, përcaktojnë qëllimin e kuptimit të secilit prej tyre, njohin kuptimet abstrakte (*mutlak*) dhe konkrete (*mukeyed*), interpretojnë ajetet me anë të njëri-tjetrit, përcaktojnë përparësitë e një ajeti mbi një tjetër dhe u kushtojnë vëmendje atyre në aktivitetin e tyre, në interpretim.

## ***Kuptimi i interpretueseve është në përputhje me njohuritë e tyre***

Pika tjetër, që duhet të theksohet në këtë pjesë, nuk është e kufizuar në kuptimin e Kur'anit dhe në shkencat fetare. Është pranuar botërisht se aftësitë intelektuale të një individi, shtrirja e përpjekjeve të ushtruara dhe saktësia në të kuptuarin si duhet i një teme, përcakton shkallën e kuptimit të tij.

Le ta trajtojmë: Në diskutimet juridike, një nga çështjet që është pak a shumë e njohur nga të gjithë juristët (*fukahā*) dhe që konsiderohet pjesë e detyrave të çdo ndjekësi (*mukalidi*)<sup>1</sup> është çështja e ndjekjes (*taklid*) së njerëzve me më shumë njohuri, ose më të diturit (*a 'lam*). Prandaj, thuhet se ekspertët e jurisprudencës (*fik'hut*) dhe deduksioni i ligjeve nga burimet fetare (*ixhtihadi*) ka nivele të ndryshme.

Çdo *mukal'laf*<sup>2</sup> është i detyruar të ndjekë (*taklidin*) juristin më të ditur (*fekih*), d.m.th, një njeri që në çështjet e *ixhtihadit* ka talentin dhe zotësinë dhe është më i dituri në jurisprudencë. Nuk duhet të mbetet pa thënë se dekretet fetare (fetva) të fukahave, në domosdoshmërinë e ndjekjes së modelit apo referencës, gjithashtu, rrjedhin nga metodat racionale. Është njësoj sikur t'i referoheshim një mjeku specialist, i cili ka shumë vite përvojë mjekësore. Të

<sup>1</sup> Mukalidi (lit. imitues, apo ndjekës): personi që ndjek një Marja të caktuar 'et teklidit (burim i imitimit apo i autoritetit referencë) në çështjet e jurisprudencës fetare. (Përkthyesi)

<sup>2</sup> Mukal'lef (lit. i ngarkuar me një detyrë): person i përgjegjshëm, ose person i rritur, që është i detyruar të respektojë parimet e fesë. (Përkthyesi)

pëlqesh atë, krahasuar me një mjek, i cili ka marrë së fundmi licencën e tij për të ushtruar profesionin e mjekut, është vendim racional dhe të veprosh ndryshe, do të ishte e dënueshme nga të gjithë njerëzit racionalë.

Kuptimi dhe identifikimi i hollësive të Kur'anit është vetëm në kompetencë të ekspertëve, të cilët kaluan jetën e tyre për të kuptuar Kur'anin dhe shkencat fetare me njohuritë e fituara nga Ehli Bejti (*Paqja qoftë mbi ta!*).

Duke pasur parasysh shkallët e ndryshme të të kuptuarit dhe interpretimin e këtij Libri të Shenjtë, është e qartë se sa më shumë merren parasysh pikat dhe çështjet e lartpërmendura, aq më pak do të jetë mundësia e kryerjes së gabimeve gjatë interpretimit të vargjeve, ajeteve hyjnore dhe aq më e lehtë do të jetë për t'iu qasur kuptimit të drejtë të këtij shkrimi qiellor.

### ***Domosdoshmëria për t'u kushtuar vëmendje konteksteve gjuhësore***

Pika e gjashtë, për të cilat ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen e lexuesit, është nevoja për t'u kushtuar vëmendje konteksteve gjuhësore, vendit dhe kohës së shpalljes së ajeteve. Është e vërtetë se Kur'ani është shpallur për të gjitha moshat, për të gjithë brezat, por konteksti dhe koha e shpalljes ishte e qartë për të adresuarit e parë dhe njerëzit e periudhës së shpalljes dhe nuk kishte vend për dyshim dhe mosmarrëveshje mbi kuptimet dhe interpretimet e tyre.

Për më tepër, nëse kishte pasur ndonjë paqartësi rreth një ajeti, qasja e njerëzve të Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk ishte problem.

Sot, gjithsesi, mundësia e disa konteksteve dhe rasteve të shpalljeve të fshehura, përshtatshmëria, ose nevoja për kujdes për të zbrërthyer siç duhet kuptimin e Kur'anit, bëhet shumë më i domosdoshëm.

Nga ana tjetër, informacioni në lidhje me kuptimin e vërtetë dhe letrar të fjalëve të përdorura në Kur'an është një nga çështjet, pa të cilat është e pamundur ta kuptosh dhe ta interpretosh si duhet Kur'anin. Indiferenca në transformimin e kuptimeve, të cilat ndonjëherë ndodhin me kalimin e kohës për një fjalë të caktuar, mund të çojë në gabime dhe keqkuptime.

Për shembull, kuptimi dhe koncepti i fjalës "tekijjes"- "fshehjeshtirje" është i qartë për të gjithë. Në përdorimin popullor, kjo fjalë do të thotë se një person fsheh besimin ose fenë dhe vepron në mënyrë të tillë, që të tjerët janë të painformuar për besimin e tij të vërtetë ose të fesë së tij, ndërsa kuptimi letrar i fjalës "tekijje" është "devotshmëri" dhe është përdorur në Kur'an dhe në "Nehxhul Belaga" me këtë kuptim. Fjala "tekijje" nuk është përmendur në Kur'an, por fjala "tekah", e cila është sinonime me fjalën "tekijje" dhe "tekoa"- "bindja dhe frika ndaj Zotit" përmendet në pasazhin e mëposhtëm:

اتَّقُوا اللَّهَ حَقَّ تَقَاتِهِ

**“O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe...”<sup>1</sup>**

### ***Ekzistenca e bukurisë letrare në Kur’an***

Është e vërtetë se Kur’ani i Shenjtë, siç thotë vetë, është zbuluar në një gjuhë të qartë dhe ekspresive dhe në varësi të nivelit të të kuptuarit dhe talentit, njeriu mund të përfitojë nga ky Libër Qiellor. Vlen të përmendet se Kur’ani ka bukuritë më shprehëse letrare dhe retorike. Është e qartë se t’i kushtosh vëmendje pikave të lartpërmendura, është, gjithashtu, një nga kushtet themelore të përfitimit të saktë dhe siç duhet nga Kur’ani i Shenjtë.

Ndonjëherë, në Kur’anin e Shenjtë, një ajet i dhënë përmend një urdhër në kuptimin e përgjithshëm dhe në sensin praktik dhe në një ajet tjetër është sqaruar kufizimi i urdhrit në fjalë. Ose, në një ajet të caktuar, një dekret jepet në një kuptim absolut dhe kushti ose domosdoshmëria e tij mund të nxirret nga një ajet tjetër. Shtjellimi imtësisht i një çështjeje me anë të një shembulli apo përdorimit të një reference, aluzioni, metafore, alegorie, është gjithashtu një nga metodat e përdorura në Kur’an.

Meqenëse adresimi i Kur’anit janë njerëzit dhe metodat e deklaruara janë konsideruar mes mrekullive të të folurit të njeriut në shprehjen e koncepteve dhe të mendimeve, Kur’ani, gjithashtu, përdor metodat e caktuara, në mënyrën më të mirë të mundshme, duke deklaruar urdhëresat dhe udhëzimet e tij. Për këtë arsye,

---

<sup>1</sup> Sure “Ali Imran”, ajeti 102.

metodat e përdorura në Kur'an janë të njëjtat metodat e përdorura nga të urtët për të shprehur qëllimet e tyre, por me një ndryshim.

Arti i të shprehurit në Kur'an nuk mund të krahasohet me anë të shkallëve, bukurisë dhe elokuencës në përdorimin e tij nga njeriu. Arsyeja për këtë është se Kur'ani është Fjala e Allahut të Lartësuar, që i është shpallur Profetit *Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në mënyrën më shprehëse dhe i ka mësuar njerëzimit parimet e elokuencës dhe të rrjedhshmërisë.

Ky Libër ka ftuar njerëzit në monoteizëm, udhëzim, përsosmëri dhe mirëqenie në mënyrën më shprehëse.

Në një thënie të vetme: Indiferenca e ndonjë prej parakushteve të mësipërme do të çonte në keqkuptim dhe interpretim të gabuar të Librit Qiellor, Kur'anit të Shenjtë.

---



## KAPITULLI III

### KUR'ANI DHE AGRESIONI KULTUROR

#### ***Natyra kontradiktore e të vërtetës dhe e gënjeshtërs***

Statusi dhe rëndësia e Kur'anit dhe roli i këtij Libri Hyjnor, sipas "Nehxhul Belagës", në drejtimin e njerëzimit drejt lumturisë dhe përsosmërisë është shpjeguar shkurtimisht. Pyetja tjetër e rëndësishme që vjen në mendje, është: A është e mjaftueshme të zbatojmë pikat e lartpërmendura për të përfituar nga Kur'ani i Shenjtë dhe të kapemi fort pas *thikl el-Akbar*, kjo trashëgimi e madhe e Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)?

Mund të thuhet se, nëse vërehen të gjitha çështjet e nevojshme për të kuptuar siç duhet Kur'anin, urdhërimet dhe mësimet e Kur'anit do të kuptohen si duhet, kultura e shoqërisë do të formohet në bazë të udhëzimeve të Kur'anit të Shenjtë dhe nën

kujdesin e qeverisë fetare dhe të Kur'anit, njerëzit do të bëhen të imunizuar nga rreziku i devijimit.

Në udhëzimin e individëve, kjo përgjigje është në një farë mase e sakta, por udhëzimi i plotë mund të arrihet vetëm kur kjo është bërë në nivelin më të lartë. Është e qartë se pa ditur idetë devijuese të kundërshtarëve të Kur'anit dhe pa penguar komplotet e tyre kulturore me anë të ndriçimit të mendjeve dhe sqarimit, do të ishte jashtëzakonisht e vështirë që të vendosej kultura e Kur'anit dhe të udhëzohet shoqëria, në bazë të besimit fetar dhe vlerave të tij. Kjo është pjesa që zakonisht është lënë pas dore.

E vërteta dhe gënjeshtria përplasen në sferën e praktikës, ashtu si ndodh në fushën e teorisë. Pasi e vërteta identifikohet, edhe gënjeshtria do të identifikohet dhe njohja e gënjeshtres, gjithashtu, ju ndihmon për të mësuar të vërtetën. Në mënyrë të ngjashme, në sferën e praktikës, për ta bërë mbretërimin e Kur'anin më të lartin në shoqëri, kjo nuk është e mundur pa njohur armiqtë dhe pa luftuar komplotet e tyre satanike dhe skemat kundër kulturës fetare të popullit.

Në këtë drejtim, ne, së pari, duhet t'i kushtojmë vëmendje thënieve të Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), të regjistruara në "Nehxhul Belaga". Pastaj, ne do të njohim masat, sidomos të rinjtë dhe të arsimuarit, me dredhitë e strategjitë satanike të kundërshtarëve të Kur'anit për të mashtruar njerëzit.

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:

وَاعْلَمُوا أَنَّمْ لَنْ تَعْرِفُوا الرُّشْدَ حَتَّى تَعْرِفُوا الَّذِي تَرَكَهُ، وَلَنْ تَأْخُذُوا بِمِثَاقِ الْكِتَابِ حَتَّى تَعْرِفُوا الَّذِي نَقَضَهُ، وَلَنْ تَمَسُّكُوا بِهِ حَتَّى تَعْرِفُوا الَّذِي بَدَّلَهُ. فَالْتَمِسُوا ذَلِكَ مِنْ عِنْدِ أَهْلِهِ، فَإِنَّهُمْ عِنْدَ الْعِلْمِ، وَمَوْتُ الْجَهْلِ.

*“Duhet ta dini se kurrë nuk do të njihni udhëzimet, nëse nuk dini se kush i ka braktisur ato. Ju nuk do të veproni në përputhje me premtimet e Kur’anit, nëse nuk e dini se kush i ka thyer ato dhe kurrë nuk do të mbahemi pas tij, nëse nuk e dini se kush e ka braktisur atë. I kërkoni këto gjëra nga ata që i zotërojnë, sepse ata janë pranverë e jetës së dijes dhe vdekje e injorancës.”<sup>1</sup>*

Kjo thënie udhëzuese e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) për nevojën e njohjes së kundërshtarëve dhe për të identifikuar idetë e tyre devijuese, e bën barrën e përgjegjësisë së dijetarëve fetarë, të predikuesve dhe të propaganduesve shumë më të rëndë.

Spastrimi i mendjes së njerëzve, sidomos të rinjtë, të cilët nuk kanë njohuri të mjaftueshme mbi fenë, nga kundërshtitë dhe dyshimet e ateistëve, është një nga detyrat themelore të përhapjes dhe të promovimit të kulturës kur’anore apo fetare, pa të cilat njeriu nuk mund të presë një rezultat të dëshirueshëm. Për ta qartësuar këtë çështje, do ta trajtojmë këtë temë në tre drejtime: dyshimet, qasjen dhe motivi i kundërshtarëve në ngulitjen apo rrënjosjen e dyshimeve.

Është e vërtetë se Kur’ani është dhurata më e madhe që Zoti i Lartësuar u ka dhuruar ndonjëherë shërbëtorëve të Tij dhe Ai Vetë e ka siguruar mbrojtjen dhe ruajtjen e tij nga shtrembërimi i të pabesëve, por ky nuk është fundi i historisë.

Në çdo moment, në varësi të gjendjes shpirtërore të atyre që, për sa i përket statusit shoqëror, janë të aftë për të ushtruar ndikim

---

<sup>1</sup> “Nehxhul Belaga”, Ligjërata 147.

në mendjet e njerëzve, shejtani, armiku i betuar i bijve të Ademit, rrënjos dyshime në mendjet e tyre, në mënyrë që t'i tërheqë masat e njerëzve pranë tij dhe t'i largojë nga Kur'ani dhe feja.

Meqë Kur'ani është mjeti më i mirë i udhëzimit, i shpëtimit dhe i lumturisë së njerëzimit, qëllimi kryesor i shejtanit është që të ndajë njerëzit nga Kur'ani dhe feja. Një nga mjetet e përdorura nga shejtani, krahas kësaj mënyre, është që të ngulisë dyshime rreth fesë apo Kur'anit, për të dobësuar besimin e popullit.

Aktivitetet e shejtanit dhe të mbështetësve të tij për ta mposhtur Kur'anin kanë ekzistuar që nga shpallja e tij. Ata filluan me mbylljen e veshëve dhe refuzimin për të dëgjuar ajetet hyjnore dhe, pastaj, duke e vënë në dyshim dhe duke e kundërshtuar, apo duke shpifur për Profetin Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Sot vazhdojnë në forma të ndryshme dhe do të vazhdojnë edhe në të ardhmen. Për sa më sipër, do të citojmë vetëm disa nga dyshimet e shprehura në shoqërinë e sotme dhe do të përpiqemi të pastrojmë mendjet e lexuesve në mënyrë që, duke u bërë të vetëdijshëm për strategjitë apo dredhitë e tyre satanike, të mund të përballen me agresionin kulturor të armiqve.

Pasi djajtë dështuan për të shkatërruar dhe për të asgjësuar Kur'anin në përpjekjen e tyre kundër tij, ata vendosën të ndalojnë popullin nga njohja me përmbajtjen e tij. Për shumë shekuj, armiq të Kur'anit propaganduan mes myslimanëve, shi'itëve në veçanti, se Kur'ani është përtej të kuptuarit të tyre dhe ata nuk kanë njohuri për aspektin ekzoterik të tij. Si i tillë, ai nuk mund të mbështetet vetëm në aspektin e tij ekzoterik.

Duke nxitur këtë ide, ata u përpoqën t'i ndalojnë njerëzit nga përfitimet e Kur'anit dhe ta heqin atë nga jeta e myslimanëve. Është e vërtetë se respekti i jashtëm për Kur'anin, në formën e recitimit, apo duke e puthur atë dhe duke e konsideruar atë të shenjtë, ka mbetur mes myslimanëve, por ata u ndaluan nga përmbajtja e tij dhe u dekurajuan nga vënia e udhëzimeve hyjnore në praktikë.

Në ditët e sotme, të ashtuquajturit intelektualë, të cilët kanë njohuri të cingura të shkencave islame, rrënjosin dyshimet më mashtruese, të përdorura në shekujt e kaluar në Perëndim, kundër shkrimeve të shtrembëruara të feve të tjera, nën rubrikën e "mendimit të ri", në qarqet kulturore dhe akademike dhe nën ndikimin e klasës së arsimuar, të cilët janë të painformuar për idetë e tyre të rreme dhe fantazisë satanike.

Ata veprojnë në këtë mënyrë, me shpresën që të minojnë themelet e besimeve të kësaj klase, pa e ditur se myslimanët, sidomos të arsimuarit me mendje kureshtare, shpejt kuptojnë falsitetin e ideve të tyre të pabaza, të pavërteta, të palogjikshme dhe irracionale.

Besimet e myslimanëve dhe dijetarët fetarë janë ankoruar mbi logjikën dhe racionalitetin, që rrjedhin nga njohuritë e të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe të Imamëve të Pagabueshëm, që rrjedhin nga gurra e Shpalljes hyjnore. Sa herë që një mysliman ndeshet me ide të devijuara në fushën intelektuale dhe ideologjike, ai i referohet ekspertëve dhe studiuesve të shkencave fetare, për të marrë një përgjigje logjike dhe të saktë.

### ***Pretendimi i mungesës së qasjes për vërtetësinë e fesë***

Pretendimi i mungesës së qasjes për vërtetësinë e fesë, është parashtruar me motive shumë të këqija dhe ndikime shkatërruese, por aktualisht do të mjaftonte të shpjegohet natyra e këtij dyshimi dhe të përmenden në mënyrë të përmbledhur disa nga dimensionet dhe vetitë e tij të fshehura, duke ia lënë vendimin gjykimit tuaj.

Pasi diskutimi ynë ka të bëjë me Kur'anin e Shenjtë, ne do të shqyrtojmë dhe do të diskutojmë dyshimin e lartpërmendur, ose shqetësimin në lidhje me të. Ky dyshim është ngritur në forma dhe në nivele të ndryshme. Ndonjëherë pretendohet se disa ajete të Kur'anit të Shenjtë kanë interpretime të ndryshme, për të cilat komentuesit, interpretuesit nuk kanë një mendim të përbashkët.

Pavarësisht hulumtimeve tona për të arritur pikëpamje të sakta, në fund ne do të pranojmë interpretimin dhe mendimin e njërit prej interpretuesve, të cilin interpretuesit e tjerë nuk e konsiderojnë si pikëpamje të Kur'anit. Prandaj është e pamundur të marrim mendimin e vërtetë të Kur'anit.

Duke vepruar kështu, nxitësit e këtij mosbesimi, befasisht duan të nxisin dyshime në mendjet e atyre që janë të dobët mendërisht dhe nuk kanë njohuri të mjaftueshme të shkencave fetare për të analizuar dhe për të reaguar. Skeptikët mendojnë se themelet intelektuale dhe ideologjike të myslimanëve janë të bazuara në pasimin e verbër.

Ata e dinë se sa herë që flitet për mendimin, arsyen dhe logjikën, vetëm Kur'ani, së bashku me mësimet e tij, është miratuar nga një mendje e shëndoshë dhe logjike e saktë dhe është pranuar me gjithë zemër nga çdo person që kërkon të vërtetën. Ata, pastaj përpiqen ta zmadhojnë këtë dyshim në një mënyrë më të thellë, për të krijuar mundësinë të realizojnë një goditje të fortë të mendimit fetar, pa e kuptuar se, duke shqyrtuar idetë e tyre, mendimtarët myslimanë do të zbulojnë se kjo lloj ideje nuk të çon askund përveç humnerës së skepticizmit.

Në çdo rast, kjo mund të arrihet nga mënyra që është shprehur ky dyshim, se nxitësit besojnë se Kur'ani i Shenjtë ka të vërteta të pandryshueshme, por, meqë interpretuesit nuk kanë një mendim të përbashkët në komentimin e Kur'anit, jemi të paaftë për të deklaruar të vërtetën e Kur'anit. Prandaj është e pamundur të përfitojmë nga Kur'ani dhe ai duhet lënë mënjanë.

Por, kur ata përballen me ajete të qarta dhe të sakta të Kur'anit dhe nuk mund të ankohen për ajetet e qarta e as mund të hedhin poshtë arsyetimin e tij dhe të ajeteve të sakta, ata shprehin dyshimin në një mënyrë tjetër. Ata krejtësisht tërhiqen nga qëndrimi i tyre i mëparshëm, duke pretenduar pamundësinë e të kuptuarit të njohurive të Kur'anit dhe atyre fetare dhe marrin qëndrim diametralisht të kundërt.

Ata e konsiderojnë Kur'anin dhe njohuritë fetare si diçka që i mungon realitetit, ndërsa urdhëresat fetare dhe perceptimet si kuptime teorike të ajeteve kur'anore nga njeriu. Ata pretendojnë se jo vetëm Kur'ani, por të gjitha shkrimet fetare janë shpallur në mënyrë që ata të mund të interpretohen në mënyra të ndryshme

dhe të gjitha këto interpretime dhe kuptime të ndryshme janë të sakta dhe të drejta.

Nëse shtrohet pyetja: "A ndodh kështu, edhe kur këto interpretime dhe kuptime janë në kundërshtim me njëra-tjetrën?", ata do të përgjigjen se larmia e interpretimeve, edhe pse kontradiktore, nuk krijon ndonjë problem, sepse në thelb, Kur'ani kurrë nuk ka shpallur ose ka përcaktuar ndonjë realitet.

Përkundrazi, thjesht fjalët boshe dhe kornizat nën dukjen e jashtme të "Shpalljes hyjnore" i janë dhënë Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), dhe duke u konsultuar me to, të gjithë mund të nxjerrin një përfundim prej tyre. Çfarë është paraqitur, në të vërtetë, është thjesht të kuptuarit e njeriut dhe, meqë njerëzit kanë mentalitete të ndryshme, interpretimet e tyre mund të ndryshojnë nga njëri-tjetri.

Feja nuk është gjë tjetër veçse mënyra ndryshe e kuptimit të fjalëve, të ajeteve të Kur'anit dhe të librave fetarë. Përderisa ato nuk përfaqësojnë ndonjë realitet, interpretimet e ndryshme nuk mund të miratohen apo të falsifikohen. Të gjitha interpretimet zbulojnë të vërtetën dhe duhet të konsiderohen korrekte dhe të drejta, sepse Kur'ani nuk thotë të vërteta të pandryshueshme, të cilat janë në përputhje vetëm me njërin nga këto interpretime.

Themeluesit e teorisë së "rrugëve të drejta" ose të "interpretimeve të ndryshme të fesë" kanë shkuar më tej se sa kaq, në përpjekje për t'i dhënë një goditje bazës dhe themelit të fesë, d.m.th, zbulesës hyjnore, pohojnë se qeniet njerëzore, nuk mund të dallojnë të vërtetat e pandryshueshme nga Kur'ani ose Zbulesa hyjnore, dhe të gjithë shprehin dhe interpretojnë atë që është në



mendjen e tij si “zbulesë”, por edhe i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), për shkak të qenies së tij njerëzore, ka shprehur mirëkuptimin dhe interpretimin e tij si “zbulesë” për njerëzit.

Prandaj, kuptimi i të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka qenë, gjithashtu, personal, në përputhje me mentalitetin dhe rrethanat e kohës dhe vendit të tij dhe është shprehur me anë të fjalës dhe ajeteve.

Si i tillë, është pohuar se Kur’ani nuk mund të konsiderohet Fjalë e Zotit dhe e zbulesës hyjnore. Në vend të kësaj, duhet të thuhet se Kur’ani është fjala e Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Pa dyshim, ju do të pyesni: Çfarë mund të themi për ajetet e cituara më poshtë?

وَمَا يَطِيقُ عَنِ الْهَوَىٰ \* إِنْ هُوَ إِلَّا وَحْيٌ يُوحَىٰ

**“Ai nuk flet sipas dëshirës së vet, por ajo (që thotë) është vetëm Shpallje hyjnore, që i vjen atij.”<sup>1</sup>**

تَنْزِيلٌ مِّن رَّبِّ الْعَالَمِينَ \* وَلَوْ تَتَوَلَّوْا عَلَيْنَا بَعْضُ الْأَقَاوِيلِ \* الْأَخَذْنَا مِنْهُ بِالْيَمِينِ \* ثُمَّ لَقَطَعْنَا مِنْهُ الْوَتِينَ

**“(Ai) është Shpallje e zbritur prej Zotit të botëve. Sikur ai (Muhamedi) në mënyrë të rreme të na kishte veshur ndonjë fjalë,**

<sup>1</sup> Sure “En Nexhm”, ajetet 3-4.

**Ne do ta kapnim atë nga dora e djathtë dhe me siguri që do t'ia prisnim damarin e qafës."**<sup>1</sup>

Ithtarët e kësaj teorie thonë, në përgjigje, se këto pika janë, gjithashtu, kuptimi apo interpretimi i Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe përfaqësojnë ndjenjat e tij.

Është e qartë se teori të tilla nuk të çojnë askund veç skepticizmit, mohimit të realitetit, mospërfilljes së arsyetimit logjik dhe lojës me fjalë. Në ballafaqimin me kuptimet më të qarta dhe konceptet më të spikatura, nxitësit e kësaj teorie thonë: "Kjo është ndjenja dhe interpretimi juaj, që nuk tregon ndonjë të vërtetë përveç mendimit tuaj personal. Për këtë arsye, kjo është e mirë dhe e respektuar për ju, por për të tjerët nuk ka asnjë vlerë!"

Promovimi i mendimeve të tilla, në lidhje me fenë dhe Kur'anin, është një nga dredhitë më të mëdha dhe kurthet e shejtanit, të cilat deri më tani, janë përdorur për të mashtruar dhe për të joshur pasardhësit e Ademit.

### ***Rrënjosja dhe përsëritja, si arma kryesore e shejtanëve***

Një nga strategjitë e shejtanëve, për të mashtruar qeniet njerëzore, është këmbëngulja dhe vendosmëria për të ndikuar në mendjet e tyre. Për këtë arsye, Kur'ani i përshkruan ato si "joshës të poshtër" (*el-vasvasi'l-khannas*) dhe udhëzon njerëzit për të kërkuar mbrojtjen e Zotit nga e keqja e shejtanëve midis xhinëve

---

<sup>1</sup> Sure "El Hakka", ajetet 43-46.

dhe njerëzve,<sup>1</sup> sepse nga rrënjosja e pandërprerë dhe përsëritja e koncepteve të gabuara, ata duan t'i vendosin në sferat e tyre të ndikimit dhe t'i drejtojnë në rrugë të gabuar.

Shejtanët mes xhinëve dhe njerëzve janë mjeshtra për të rrënjosur nocionet satanike në mendjen e njerëzve adhures të Allahut. Ata duhet të flasin dhe duhet të shkruajnë shumë, në mënyrë që të mësohen me mendimet e tyre të rreme dhe të ushtrojnë ndikim të vazhdueshëm. Ata pranojnë se duhet të flasin dhe duhet të shkruajnë shumë, në mënyrë që njerëzit, më në fund të largojnë dyshimin dhe pasigurinë.

Duke marrë frymëzim nga Iblisi (shejtani), përparësia e tyre është që të mashtrojnë dhe të çojnë në rrugë të gabuar klasën e kualifikuar dhe të arsimuar, sepse ata besojnë se duke i mashtuar, do të kenë mundësi të largojnë masat me lehtësi më të madhe, pa e kuptuar se Allahu i Lartësuar, ka vendosur shumë pishtarë për drejtimin e myslimanëve, të cilët, me anë të hijeshisë hyjnore, do të zbulojnë manovrat satanike të kundërshtarëve dhe do të bëhen më të fortë dhe më të vendosur për të ndjekur Kur'anin.

### ***Citimi i vargjeve alegorike (muteshabihatet) të Kur'anit, si një mënyrë tjetër e kundërvënies me Kur'anin***

Është thënë më herët se një nga funksionet e të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe të Imamëve të Pagabueshëm është të interpretojnë dhe të

---

<sup>1</sup> Sure "En Nas", ajetet 1-6.

shpjegojnë Zbulesën hyjnore, sepse Kur'ani ka ajete të qarta, të drejtpërdrejta (*muhkamat*) dhe ajete alegorike (*muteshabihatet*) dhe, siç është përmendur më parë, kanë anën e brendshme dhe anën e jashtme. Është e pamundur për të gjithë, përveç të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), Imamëve të Pagabueshëm dhe atyre që kanë qasje në njohuritë hyjnore, të kuptojnë thellësinë e njohurive të tij dhe askush nuk mund ta interpretojë dhe ta shpjegojë atë, me përjashtim të atyre që kërkojnë të marrin dituri nëpërmjet shkollës së Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*).

Prandaj, sipas mënyrës racionale të të paditurve, që i referohen të diturve, nuk ka asnjë mënyrë tjetër për të kuptuar Kur'anin dhe parimet fetare, përveç se duke iu referuar transmetuesit, Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), Imamëve të Pagabueshëm dhe nxënësve të shkollës së tyre.

Megjithatë, jo të gjithë njerëzit ndjekin rrugën racionale dhe janë besnikë të arsyetimit dhe parimeve logjike të të kuptuarit (*fahim*), të udhëzimit (*tafhim*) dhe të kuptuarit (*tafahhum*). Janë ata që ndjekin vetëm devijimin e njerëzve dhe qëllimi i vetëm i tyre është të nxisin dyshimin dhe të krijojnë trazira (*fitna*) në shoqëri.

Kur'ani, gjithashtu, e ka parashikuar këtë realitet:

هُوَ الَّذِي أَنْزَلَ عَلَيْكَ الْكِتَابَ مِنْهُ آيَاتٌ مُحْكَمَاتٌ هُنَّ أُمُّ الْكِتَابِ وَأُخَرُ مُتَشَابِهَاتٌ فَأَمَّا الَّذِينَ فِي قُلُوبِهِمْ زَيْغٌ فَيَتَّبِعُونَ مَا تَشَابَهَ مِنْهُ ابْتِغَاءَ الْفِتْنَةِ وَابْتِغَاءَ تَأْوِيلِهِ وَمَا يَعْلَمُ تَأْوِيلَهُ إِلَّا اللَّهُ وَالرَّاسِخُونَ فِي الْعِلْمِ يَقُولُونَ آمَنَّا بِهِ كُلٌّ مِنْ عِنْدِ رَبِّنَا وَمَا يَذَّكَّرُ إِلَّا أُولُو الْأَلْبَابِ

**“Është Ai që të ka shpallur ty (Muhamed) Librin, disa vargje të të cilit janë të qarta e me kuptim të drejtpërdrejtë. Ato janë themelet e Librit. Kurse disa (ajete) të tjera janë jo krejtësisht të qarta (me kuptime alegorike). Ata, zemrat e të cilëve priren nga e pavërteta, ndjekin vargjet më pak të qarta, duke kërkuar të krijojnë pësjtjellim dhe duke kërkuar t’i komentojnë sipas dëshirës së vet. Por, kuptimin e tyre të vërtetë e di vetëm Allahu. Ndërsa ata që janë thelluar nëdijeni, thonë: ‘Ne i besojmë (Kur’anit). Të gjitha këto (ajete të qarta e alegorike) janë nga Zoti ynë!’. Këtë e kuptojnë vetëm mendarët.”<sup>1</sup>**

*Muhkamati* i Kur’anit u referohet ajeteve, kuptimet e të cilave janë të qarta dhe përmbajtja e të cilave janë të pamohueshme. Ajetet përbëjnë parimet dhe thelbin e njohurive kur’anore.

Kriteri dhe baza e qartësisë, ose paqartësisë së “dijes fetare” janë *muhkamat* “nëna e Librit”. Në të kundërtën, ka ajete që nuk mund të kuptohen pa ndihmën e ajeteve me kuptim të drejtpërdrejtë (*muhkamatëve*) dhe jo të gjithë mund të kuptojnë thellësinë e kuptimit të tyre.

Këto ajete quhen ajete alegorike (*muteshabihate*).

Kur’ani i ka ndaluar njerëzit që të ndjekin ajetet alegorike, pa u kushtuar vëmendje ajeteve me kuptim të drejtpërdrejtë (*muhkamateve*), komentimit dhe shpjegimit të të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe të Imamëve të Pagabueshëm. Kur’ani i Shenjtë e konsideron aktin e ndjekjes së ajeteve me kuptim të tërthortë (*muteshabihateve*) si një shenjë e devijimit të shpirtit, duke deklaruar

---

<sup>1</sup> Sure “Ali Imran”, ajeti 7.

se ata që marrin *muteshabihatet* e Kur'anit si bazë të të menduarit të tyre, të kuptuarit dhe besimit, janë në kërkim të trazirës, të interpretimit spekulativ dhe të shtrembërimit të Kur'anit.

Sipas Kur'anit, askush nuk e di interpretimin dhe komentimin e vargjeve alegorike, përveç Allahut dhe *"atyre me baza të forta dijes"*. *"Të bazuarit në dije"*, u referohen atyre që kanë pranuar me gjithë zemër nënshtrimin e tyre ndaj Allahut, duke thënë: *"Ne besojmë në Kur'an, si në ajetet e tij të drejtpërdrejta, ashtu edhe në ato alegorike. Plotësia e tij vjen nga Allahu."*

### ***Urtësia e vargjeve alegorike në Kur'an***

Në këtë pikë, ndoshta mund të lindë pyetja: Pse Kur'ani nuk është shpallur në një mënyrë të tillë që të gjitha ajetet e tij të jenë të qarta, të plota dhe pa ekuivoqe, në mënyrë që të gjithë të mund të kuptojnë atë?

Në përgjigje të kësaj pyetjeje, duhet të theksohen disa faktorë. Mendjet e qenieve të zakonshme njerëzore si ne, ndjekin faktorë natyrorë. Kur lindin qeniet e zakonshme njerëzore, ata janë njohur për herë të parë me gjëra të prekshme dhe materiale përmes shqisave dhe të kuptuarit dhe perceptimi i tyre është i kufizuar në to. Megjithatë, fuqia mendore e njeriut gradualisht bëhet më e fortë dhe fiton aftësitë e abstraksionit dhe të përgjithësimit.

Së fundi, ai zotëron fuqinë e perceptimit të të vërtetave alegorike. Sa më i fortë të jetë intelekti i njeriut dhe forca e abstraksionit dhe sa më shumë shkon njeriu përtej sferës materiale, aq më mirë mund t'i perceptojë realitetet alegorike. Të gjitha qeniet

njerëzore nuk janë të barabarta, në aspektin e zhvillimit intelektual. Ata, gjithashtu, nuk janë të njëjtë, për sa i përket perceptimit të gjërave jomateriale.

Ka shumë raste, kur niveli i të kuptuarit dhe i perceptimit të një fëmije 10-vjeçare është ende si ai i një shtatë ose tetëvjeçari dhe madje edhe më vonë, ai ndoshta mund të mendojë për Zotin dhe gjërat abstrakte brenda kornizës së kohës dhe hapësirës së tij. Kjo ndodh për shkak të të kuptuarit dhe talentit të tij, sepse fuqia e të menduarit është ende brenda kufijve të gjërave materiale, ndërsa themeli i fesë është besimi në të padukshmen, që do të thotë, besimi në realitetet abstrakte dhe jomateriale.

Në lidhje me këtë, Kur'ani thotë:

ذَلِكَ الْكِتَابُ لَا رَيْبَ فِيهِ هُدًى لِّلْمُتَّقِينَ \* الَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِالْغَيْبِ

**“Ky është Libri, në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit, të cilët besojnë në të fshehtën...”<sup>1</sup>**

Themeli i besimit, pra, qëndron në besimin në realitetet e pakapshme. Por e vërteta apo thelbi i këtyre realiteteve është diçka që nuk mund të kuptohet veçse nëpërmjet frymëzimit hyjnor të të Dërguarve dhe Imamëve të Pagabueshëm. Nuk ekziston asnjë mënyrë për ne, qeniet e zakonshme njerëzore, për të kuptuar të vërtetat metafizike dhe realitetet, përveçse duke forcuar fuqinë

---

<sup>1</sup> Sure “El Bekare”, ajetet 2-3.

tonë racionale dhe ngritjen graduale apo kalimin nga e prekshmja në realitetet abstrakte dhe metafizike.

Nga ana tjetër, shumica e fjalëve të përdorura në sensin abstrakt, janë përdorur fillimisht me kuptimin e prekshëm, konkret. Merrni për shembull vargjet e mëposhtme:

يَدُ اللَّهِ فَوْقَ أَيْدِيهِمْ

"Dora e Allahut është mbi duart e tyre."<sup>1</sup>

وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ

"... Ai është i Larti, i Madhërishmi!"<sup>2</sup>

Fjalët "fawk", "ali" dhe "uluww" të gjitha kanë kuptimin "i lartë", në krahasim me "i ulët". Është e qartë se në fillim, njeriu nuk mund të kuptonte kuptimin e këtyre fjalëve përtej të dukshmes dhe konkretes. Për shembull, njeriu merr kokën e tij si kriter për atë që është "e lartë" dhe i konsideron këmbët e tij pjesa "e ulët". Ai e konsideron çdo gjë që është nën këmbët e tij, si "të ulët". Për këtë arsye, thuhet se qielli është "i lartë", ndërsa toka është "e ulët" ose "poshtë".

Megjithatë, me hyrjen e tij në jetën shoqërore, ai shkon përtej këtyre kuptimeve dhe gradualisht percepton kuptimet e paprekshme dhe abstrakte. Kjo do të thotë, kur thuhet se filan person zë një pozitë të lartë ose paraqitet në një pozitë më të lartë,

<sup>1</sup> Sure "El Fet'h", ajeti 10.

<sup>2</sup> Sure "El Bekare", ajeti 255



njeriu nuk kupton fjalët “i lartë” ose “më i lartë”, në kuptimin e tij të prekshëm dhe konkret.

Natyrisht, në këtë lloj përdorimi, kuptimi i synuar është bërë abstrakt. Kur thuhet se “Ai që i ka krijuar të gjitha gjërat me vullnetin e Tij ka një status jashtëzakonisht të lartë”, lartësia që i atribuohet Allahut është pafundësisht mbi lartësinë që i atribuohet një shefi zyre, në lidhje me vartësit e tij.

Largësia mes të dyve është largësia mes zeros dhe infinitit, si dhe ajo e reales me virtualen. Çdo lartësi ose pozicion, është e gënjeshtërt, prishet, përveç Lartësisë Reale, që është rezultat dhe i takon Zotit, Krijuesit të gjithësisë.

إِنَّمَا أَمْرُهُ إِذَا أَرَادَ شَيْئًا أَنْ يَقُولَ لَهُ كُنْ فَيَكُونُ

**“Vërtet, urdhri i Tij, kur Ai dëshiron diçka, është që t’i thotë asaj ‘Bëhu!’- dhe ajo bëhet.”<sup>1</sup>**

Prandaj, kur Kur’ani thotë: **"Ai është i lartësuari, i Gjithëfuqishmi"**<sup>2</sup>, nënkupton se as Lartësia e Allahut nuk është fizike dhe e prekshme, as shkëlqimi dhe madhështia e Tij nuk ka ndonjë lidhje materiale dhe trupore. Por e vërteta pas shkëlqimit dhe madhështisë së Allahut është diçka që është përtej të kuptuarit njerëzor.

Natyrisht, në shumë raste nuk ka fjalë që mund të përdoren në një sens të pakuptueshëm. Pra, nuk ka asnjë alternativë, veçse të përdorim të njëjtën fjalë dhe t’i japim një kuptim abstrakt asaj. Për

<sup>1</sup> Sure “Esh Shura”, ajeti 4.

<sup>2</sup> Sure “Ja Sin”, ajeti 82.

shembull, thuhet se Allahu është i lartë dhe i madh. "High" është e njëjta fjalë që përdoret për t'iu referuar çatisë në lidhje me dyshemenë. "I madh" është, gjithashtu, e njëjta fjalë që përdoret, kur përshkruan malin Damavand.<sup>1</sup> Megjithatë, kur këto fjalë janë përdorur për të përshkruar Zotin, kuptimet e tyre bëhen abstrakte. E përsërisim, përdorimi i tyre me kuptimin abstrakt nuk do të thotë se mund të kuptohet domethënia e tyre e vërtetë, kur përdoret për përshkrimin e Zotit.

Është thënë se fjalët që afrohen më shumë me kuptimin e tyre të vërtetë, me mënyrën e mësipërme janë të së njëjtës lloj ngjashmërie që të shpie në dykuptimësi dhe ide të gabuar. Kur thuhet se "Zoti është lartë", një njeri që akoma nuk është në gjendje të ndajë kuptimet e mësipërme nga vetitë dhe atributet e tyre konkrete e reale, mendon se Zoti është në qiell, ndonëse Ai nuk është një trup që zë vend.

فَأَيُّمَا تَوَلَّوْا فَمِنْ وَجْهِ اللَّهِ

**"...pra, ngado që të ktheheni është Fytyra (ana) e Allahut..."<sup>2</sup>**

Por ai nuk mund ta kuptojë atë. Sigurisht, ai nuk ka asnjë detyrë përtej asaj që mund ta kuptojë, sepse ai nuk ka fuqi përtej saj.

<sup>1</sup> Me një lartësi prej 5,670 m, mali Damavand, i cili ngrihet në afërsi të Teheranit, është maja më e lartë e maleve Alborz, një vargmal në veri të Iranit, që shtrihet përgjatë bregut jugor të Detit Kaspik. (Përkthyesi)

<sup>2</sup> Sure "El Bekare", ajeti 115.

Kur thuhet: **“Vërtet, Allahu është i Gjithëfuqishmi, i Lartësuar”**, ai që shkon përtej kësaj faze, ka më shumë aftësi për të kuptuar dhe, gjithashtu, kap domethënien e deleguar, mendon se Madhështia dhe Lartësimi i Allahut është si ajo e zyrës qendrore, krahasuar me vartësit e saj. Por këta, në të vërtetë, ndryshojnë si dita me natën.

Njeriu që ka kaluar jetën e tij në kërkim të njohurive, të diturisë dhe të kuptuarit të domethënieve abstrakte, e kupton një domethënie edhe më të thellë të lartësimit dhe të madhësisë, duke thënë se Zoti ka Madhësi thelbësore, në raport me të tjerët.

Të gjitha krijesat ekzistojnë. Po kështu edhe Allahu, por ekzistenca e Allahut, të Madhërishtit dhe të Lartësuarit, për sa i përket nivelit ekzistencial të madhësisë, nuk mund të krahasohet me krijesat e Tij. Por, përsëri, e vërteta, pas Lartësisë së Tij, madhësisë dhe nivelit sublim të ekzistencës është diçka që gjithkush mund ta dallojë në varësi të forcës dhe aftësisë së tij të perceptimit, edhe pse të kuptuarit e thelbit të Tij është i pamundur për të gjithë.

Tani, duke pasur parasysh shpjegimin sa më sipër, argumentojnë se sa herë që Allahu dëshiron të na tregojë ne, qenieve njerëzore, diçka që është përtej të kuptuarit tonë të përbashkët, Ai duhet të përdorë fjalë që mund t'i kuptojmë deri në një masë, pas reflektimit, edhe pse është përtej fuqisë sonë për të kuptuar thelbin e tyre. Në raste të tilla, nuk ka asnjë mundësi, përveç përdorimit të fjalëve alegorike.

Si të tilla, ajetet që tregojnë çështje metafizike dhe përtej të kuptuarit të qenieve të zakonshme humane, pak a shumë, do të

kenë shkallë të caktuara të metaforës, thelbi i të cilave mund të njihet me ndihmën e ajeteve të qarta.

Për shembull, sa herë që Kur'ani thotë: "**Dhe Ai është i Larti, i Madhërishmi...**"<sup>1</sup> dhe ne nuk mund ta kuptojmë të vërtetën apo thelbin e madhësisë dhe të lartësimit të Qenies më të Lartë, atëherë duhet ta interpretojmë atë nëpërmjet vargjeve të qarta dhe të sakta, të tilla, si: "**Asgjë nuk i shëmbëllen Atij**"<sup>2</sup>, në mënyrë që të shmangen keqkuptimet dhe keqinterpretimet.

Ajeti i parë thotë se Allahu është i Larti dhe i Madhërishëm, ndërsa i dyti na informon se Ai nuk ka të barabartë dhe të krahasueshëm me Të. Kjo do të thotë se çfarëdo rangu i madhësisë dhe i lartësimit që ne mund të mendojmë, kjo është nën madhësinë dhe lartësimin e Tij të vërtetë, sepse Ai qëndron më lart se gjithçka.

E njëjta gjë është e vërtetë në lidhje me atributet e Allahut. Kur thuhet se Allahu është i Gjithëdijshëm dhe Fuqiplotë, është e qartë se thelbi i njohurive në lidhje me Zotin është mbi atë që është kuptuar për qeniet njerëzore. Por e vërteta për atributet e Allahut është diçka që është e pakuptueshme për gjithkënd, me përjashtim të Zotit, thelbi i të Cilit është Dituria, Jeta dhe Fuqia e Tij.

Për të udhërrëfyer njeriun drejt Tij dhe Atributeve të Tij, Allahu i Lartësuar ka përdorur të njëjtat fjalë, të cilat njeriu, fillimisht, i kupton në sensin e tyre të prekshëm, në mënyrë që

---

<sup>1</sup> Sure "Esh Shura", ajeti 4.

<sup>2</sup> Sure "Esh Shura", ajeti 11.

njeriu të mos mbetet i privuar nga kjo njohuri e lartë, pa marrë parasysh sa e metë është.

Prandaj, ekzistenca e vargjeve alegorike në Kur'an është pjesë e urtësisë hyjnore, sepse pa to, mjetet për të kuptuar konceptet dhe faktet abstrakte dhe të paqarta do të jenë krejtësisht të humbura. Por, për të cituar, për të interpretuar dhe për të shpjeguar vargjet alegorike, siç u tha më herët, është diçka që duhet të realizohet me ndihmën e vargjeve të qarta e të sakta.

Por jo të gjithë individët që synojnë të kuptojnë Kur'anin dhe shkencat e tij zgjedhin rrugën e lartpërmendur logjike, racionale dhe të natyrshme në të kuptuarit e dijeve hyjnore. Në ajetin në fjalë, Zoti përmend ekzistencën e ajeteve jo krejtësisht të qarta dhe alegorike në Kur'an dhe thotë se **"ata zemrat e të cilëve priren nga e pavërteta..."**<sup>1</sup> kanë disa sëmundje psikologjike dhe morale.

Me fjalë të tjera: **"Në zemrat e tyre ka një sëmundje."**<sup>2</sup> Ata i konsiderojnë ajetet alegorike si bazë të të menduarit dhe të veprimit të tyre. Pa marrë parasysh ajetet e qarta të Kur'anit, ata i japin përparësi ajeteve alegorike dhe kështu përgatisin terrenin për devijimin e vetes dhe të të tjerëve.

---

<sup>1</sup> Sure "Ali Imran", ajeti 7.

<sup>2</sup> Sure "El Bekare", ajeti 10.

## ***Kombinimi i të vërtetës dhe falsitetit, si një armë tjetër për shmangësit***

Natyrisht, ata që duan t'i kundërvihen fesë, Kur'anit, vlerave fetare dhe parimeve në shoqërinë islame, kurrë nuk do të përshtatin mënyrën e përbaljes së drejtpërdrejtë, për të arritur objektivat e tyre, sepse ata e dinë se, duke vepruar kështu, do të përballen me kundërshtimin masiv të myslimanëve dhe do të pësojnë disfatë që në fillim. Pas këshillave psikologjike, ata zgjedhin metodat e duhura për të arritur objektivat e tyre satanike.

Një nga qasjet e tyre është bashkimi apo kombinimi i të vërtetës me gënjeshtren. Ata i bashkojnë, duke shkriur elemente të së vërtetës dhe të gënjeshtres në një mënyrë të tillë, sa që personave që u adresohen, herë pas here, ngaqë nuk kanë njohuri dhe profesionalizëm të mjaftueshëm për të dalluar të vërtetën nga gënjeshttra, i pranojnë fjalët në tërësi. Kështu, falsiteti, i zbukuruar me famën e të vërtetës dhe fshehur pas vellos, me shprehje letrare të bukura, rrënjohet në mënyrë të pavetëdijshme në mendjet e dëgjuesve.

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:

فَلَوْ أَنَّ الْبَاطِلَ خَلَصَ مِنْ مِرَاجِ الْحَقِّ لَمْ يَخَفْ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ، وَلَوْ أَنَّ الْحَقَّ خَلَصَ مِنْ لَبْسِ الْبَاطِلِ انْقَطَعَتْ عَنْهُ النَّسْرُ  
الْمَعَانِدِينَ، وَلَكِنْ يُؤَخِّدُ مِنْ هَذَا ضِعْفٌ، وَمِنْ هَذَا ضِعْفٌ، فَيَمْرَجَانِ! فَهَاتَاكَ يَسْتَوْلِي الشَّيْطَانُ عَلَى أَوْلِيَائِهِ، وَيَنْجُو الدِّينَ  
سَبَقَتْ لَهُمْ مِنَ اللَّهِ الْحُسْنَى.

*“Nëse e gabuara do të ishte e qartë dhe e papërzier, ajo nuk do të fshihej prej atyre që janë në kërkim të saj. Në qoftë se e drejta do të ishte e pastër, e papërzier me të gabuarën, ata që kanë urrejtje ndaj saj, do ta mbyllnin gojën. Gjithsesi, merret diçka këtu dhe diçka atje dhe të dy përzihen e kombinohen! Në këtë fazë shejtani merr kontrollin mbi miqtë e tij dhe shpëtojnë vetëm ata, për të cilët virtyti ka qenë caktuar nga Allahu që më parë.”<sup>1</sup>*

Natyrisht, të mbrapshtët dhe ata, zemrat e të cilëve janë në rrugë të gabuar, siç përshkruhet në Kur'an, që nuk janë të gatshëm t'i nënshtrohen Zotit, marrin ajetet alegorike dhe grupin e haditheve, të cilat janë të falsifikuara, në lidhje me zinxhirin e transmetimit (*sened*), ose metafora në aspektin e përmbajtjes, si ballinë e aktiviteteve të tyre propagandistike kundër Islamit. Ndërkohë, kanë neveri të dëgjojnë ajetet e qarta të Kur'anit, thëniet e të vërtetës dhe dijes hyjnore të transmetuar nga Ehli Bejti (*Paqja qoftë mbi ta!*) apo nga Imamët e Pagabueshëm.

Ata që shpesh e konsiderojnë veten si myslimanë, janë bashkuar, me dashje ose pa dashje, me armiqtë e Islamit, sepse ata janë në kërkim të pikave negative që i atribuohen në mënyrë të gabuar Islamit. Duke i amplifikuar këto pika negative, ata synojnë minimin e prirjeve të individëve që kërkojnë të vërtetën drejt Islamit, të cilët nuk e kanë përqaftuar ende Islamin. Në këtë libër, kemi të bëjmë jo vetëm me ateistët dhe armiqtë jomyslimanë, por edhe me ata që pretendojnë të jenë myslimanë.

Në mënyrë që të refuzojnë fjalët e të vërtetës dhe t'i nënshtrohen arsyes dhe logjikës, ata paraqesin justifikime për veten

---

<sup>1</sup> “Nehxhul Belaga”, Ligjërata 50.

e tyre, të tilla si ato që përmendëm në pjesën "Lexime dhe interpretime të ndryshme mbi fenë" dhe ruajnë qëndrimin e tyre, pa marrë parasysh pasojat e deklarimeve të tyre.

Në këtë pjesë, unë po lë lexuesit e dashur t'i gjykojnë vetë këto arsyetime dhe ndikimet e tyre. Megjithatë, nga simpatia dhe shqetësimi, i ftojme ata që të rishikojnë besimin e tyre, ashtu si Kur'ani nxit besimtarët që të ftojnë njëri-tjetrin për të menduar, për të reflektuar, për t'u reformuar dhe për të udhëzuar, si dhe të kujtojnë njëri-tjetrin për të vërtetën.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اسْتَجِيبُوا لِلَّهِ وَلِلرَّسُولِ إِذَا دَعَاكُمْ لِمَا يُحْيِيكُمْ

"O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit, kur ai ju thërret drejt asaj që ju jep jetë!"<sup>1</sup>

### ***Interpretime të ndryshme, si një armë për kundërvënien me Kur'anin***

Duhet të jetë e qartë se ideja e përmendur, e cila është e shprehur si "rrugë të drejta e të ndershme", shprehja "kuptimi, leximi apo interpretime të ndryshme të fesë", ose brenda kuadrit teorik të "gjuhës së fesë" ose "feja e të paktëve ose ose e të shumtëve", nuk ka qëllim tjetër veçse të kundërshtojë besimet fetare të mendimit monoteist.

<sup>1</sup> Sure "El Enfal", ajeti 24.



Le ta dinë se dijetarët e kujdesshëm e të matur myslimanë, janë mjaft të zgjuar për të zbuluar natyrën e paarsyeshme dhe joracionale të argumenteve të tyre dhe janë shumë të vetëdijshëm për planin e tyre të fshehtë, si nxitës të këtyre dyshimeve të pabaza.

### **Motivet e kundërshtarëve të kulturës fetare, sipas Kur'anit**

Duke marrë në konsideratë diskutimet tona, mund të lindë kjo pyetje: Cili është motivi i kundërshtarëve të Kur'anit dhe i kulturës fetare, që qëndron prapa këtyre akteve mëkatore? Në përgjigje të saj, së pari, do të shqyrtojmë pikëpamjen e Kur'anit dhe pastaj do të shpjegojmë thënien e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) në "Nehxhul Belaga", për sa thamë më sipër.

Mund të themi nga Kur'ani se, që nga fillimi i shpalljes, shejtani është përpjekur, me të gjitha mundësitë e tij, duke shfrytëzuar dobësitë e xhindëve dhe qenieve humane, t'i largojë njerëzit nga Kur'ani. Asgjë tjetër nuk mund të pritët nga shejtani përveç kësaj, sepse ai u betua:

فَبِعْرَضِكَ لِأَعْوَابِهِمْ أَجْمَعِينَ \* إِلَّا عِبَادَكَ مِنْهُمُ الْمُخْلَصِينَ

**"Betohem në madhërinë Tënde se unë do t'i mashtroj (njerëzit) të gjithë, përveç robërve të Tu të sinqertë!"<sup>1</sup>**

Për të zbatuar planin e tij të largimit të njerëzve dhe për t'i kufizuar ata prej njohurive të Kur'anit, ai bëri ajetet e qarta si

<sup>1</sup> Sure "Sad", ajetet 82-83.

pretekst. Ai nxiti materialistët dhe miqtë e tij për të ndjekur ajetet alegorike të Kur'anit, pa u kushtuar vëmendje vargjeve të tij të qarta. Në këtë mënyrë, përmes tyre ai do të mund të tërheqë pjesën tjetër drejt pasigurisë dhe dyshimit. Pas ndarjes së ajeteve të Kur'anit në *muhkamate* dhe *muteshabihate*, Allahu i Lartësuar, thotë:

فَأَمَّا الَّذِينَ فِي قُلُوبِهِمْ زَيْغٌ فَيَتَّبِعُونَ مَا تَشَابَهَ مِنْهُ ابْتِغَاءَ الْفِتْنَةِ وَابْتِغَاءَ تَأْوِيلِهِ

**"Ata, zemrat e të cilëve priren nga e pavërteta, ndjekin ajetet më pak të qarta, duke kërkuar të krijojnë pështjellim dhe duke kërkuar t'i komentojnë sipas dëshirës së vet..."<sup>1</sup>**

Pasuesit e tij e ndihmuan në arritjen e objektivit të tij. Kur'ani i përshkruan këta individë si **"ata që në zemrat e tyre kanë të pavërtetën"** dhe **"në zemrat e të cilëve ekziston një sëmundje"** dhe i ndalon njerëzit nga ndjekja e tyre.

Shqetësimi ynë është të shpjegohet, nga pikëpamja kur'anore, motivi i kundërshtimit të këtyre individëve ndaj kulturës fetare. Kur'ani i Shenjtë thotë se ata që kanë si qëllim "të krijojnë pështjellim", i marrin ajetet alegorike si bazën e mendimeve dhe të veprimeve të tyre, ose heqin dorë nga e dukshmja, e qarta në Kur'an, nën pretekstin e *mutashabihateve*, janë nxitës të rebelimit.

Pyetja që shtrohet këtu është: Çfarë është rebelim, joshje dhe nxitje e rebelimit? Leksikografët, veçanërisht ata që përpiqen të gjejnë kuptimin origjinal të fjalës dhe t'i japin kuptim fjalëve, duke

<sup>1</sup> Sure "Ali Imran", ajeti 7.

marrë parasysh rrënjët e fjalëve, kanë thënë se “*fitnah*”, fillimisht kishte kuptimin “të ngrohësh diçka me anë të zjarrit”.

Arabët për një gjë që vendoset mbi zjarr, për t’u ngrohur, për t’u djegur ose për t’u shkrirë, thonë: “Është bërë e nxehtë, është përcëlluar.” (fatanahu). Në Kur’an, fjala “*fatanahu*” është përdorur edhe në kuptimin tekstual, kur thotë:

يَوْمَ هُمْ عَلَى النَّارِ يُفْتَنُونَ

**"Kjo është dita kur ata do të përcëllohen në zjarr."**<sup>1</sup>

Prandaj, thelbi i kuptimit të drejtpërdrejtë të fjalës “*fatanahu*” është të djegësh dhe të shkrish. Megjithatë, siç thonë leksikografët, thelbësore për kuptimin e fjalëpërfjalshëm bëhet kuptimi i dytë apo i tretë i fjalës. E njëjta gjë është e vërtetë në rastin e fjalës “*fitnah*”.

Siç u tha, “*fitnah*”, fillimisht kishte kuptimin “të nxehet”, por “të nxehet” ka një thelb, që është, nëse kjo rritje e nxehtësisë ose djegie, përcëllim i ndodh një njeriu, e tillë si në ajetin: **"Kjo është dita kur ata do të përcëllohen në zjarr."**, ai do të jetë në një gjendje nervozizmi ose ankthi (*idhtirab*).

Trazimi, ankthi ose shqetësimi është gjendja e jashtme e atij që është përcëlluar fizikisht. Ndonjëherë, ajo shpreh një gjendje të brendshme apo shpirtërore. Si i tillë, trazimi është në fakt, një nga kushtet e “*fitnas*” apo të rritjes së nxehtësisë dhe, duke pasur parasysh zgjerimin e kuptimit të një fjale, “*fitnah*”, gjithashtu, i referohet gjërave që shkaktojnë trazirë, shqetësim, ankth të brendshëm apo shpirtëror. Pasi një pjesë e shqetësimit të

<sup>1</sup> Sure “Dharijat”, ajeti 13

brendshëm apo shpirtëror është shqetësimi ose pasiguria në çështjet e besimeve, çdo gjë që shkakton një problem të tillë, është quajtur, gjithashtu, "fitnah".

Ekziston termi "rebelim"-*"fitnah"* në religjion", sepse duke nxitur mendimet paragjykuese ose të rreme, disa individë dëshirojnë të krijojnë zemërim dhe ankth apo pasiguri në bindjet apo në besimin e besimtarëve dhe i bën ata të braktisin fenë e vërtetë.

Një provim apo test është quajtur gjithashtu *"fitnah"*, pasi shkakton shqetësim dhe ankth, pasi në momentin e testimit, një person është i shqetësuar për rezultatin, ai nuk është i qetë me mendje. Në Kur'an, fjala *"fitnah"*, në kuptimin e shqetësimit, të trazirës për shkak të një testi, mund të gjendet në ajete të shumta.

Kur'ani thotë:

أَمَّا أَمْوَالُكُمْ وَأَوْلَادُكُمْ فِتْنَةٌ

**"Ta dini se pasuria juaj dhe fëmijët tuaj janë vetëm sprovë..."<sup>1</sup>**

Allahu, gjithashtu, thotë:

وَيَبْلُوكُم بِالسَّرِّ وَالْخَيْرِ فِتْنَةٌ

**"Dhe Ne do t'ju sprovojmë me të mirë dhe me të keqe me anë të testit."<sup>2</sup>**

<sup>1</sup> Sure "El Enfal", ajeti 28.

<sup>2</sup> Sure "Enbija", ajeti 35.

Ndonjëherë, ndëshkimi apo bezdia dhe shqetësimi, në vetvete, është referuar, gjithashtu, si “*fitnah*”.

Është e qartë se në ajetin që po diskutojmë:

هُوَ الَّذِي أَنْزَلَ عَلَيْكَ الْكِتَابَ مِنْهُ آيَاتٌ مُحْكَمَاتٌ هُنَّ أُمُّ الْكِتَابِ وَأُخَرُ مُتَشَابِهَاتٌ فَأَمَّا الَّذِينَ فِي قُلُوبِهِمْ زَيْغٌ فَيَتَّبِعُونَ مَا تَشَابَهَ مِنْهُ ابْتِغَاءَ الْفِتْنَةِ وَابْتِغَاءَ تَأْوِيلِهِ وَمَا يَعْلَمُ تَأْوِيلَهُ إِلَّا اللَّهُ وَالرَّاسِخُونَ فِي الْعِلْمِ يَقُولُونَ غَائِبًا لِمَ كُلٌّ مِنْ عِنْدِ رَبِّنَا وَمَا يَذَّكَّرُ إِلَّا أُولُو الْأَلْبَابِ

“Është Ai që të ka shpallur ty (Muhamed) Librin, disa vargje të të cilit janë të qarta e me kuptim të drejtpërdrejtë. Ato janë themelet e Librit. Kurse disa (vargje) të tjera janë jo krejtësisht të qarta (me kuptime alegorike). Ata, zemrat e të cilëve priren nga e pavërteta, ndjekin vargjet më pak të qarta, duke kërkuar të krijojnë pështjellim dhe duke kërkuar t’i komentojnë sipas dëshirës së vet.”<sup>1</sup>, “*fitnah*” do të thotë “rebelim në fe”, pasi ndjekja e *mutashabihateve* është në kundërshtim me testimin ose provimin dhe ata që ndjekin *muteshabihatet* nuk kanë si qëllim torturën dhe mundimin e të tjerëve.

Kjo, gjithashtu, nuk do të thotë të ngroh apo të djeg. Përkundrazi, ata janë rebelimnxitësit, sepse nën pretekstin e ajeteve alegorike, kanë për qëllim të nxisin zemërimin ose dyshimin në mendjet e njerëzve dhe t’i drejtojnë ata në rrugë të gabuar.

<sup>1</sup> Sure “Ali Imran”, ajeti 7.

## **Qëndrimi kur'anor përballë "rebelimit"- "fitnah" në fe**

"Rebelimin në fe", në kuptimin e mësipërm, mund të konsiderohet si konfrontim i maskuar me elementet e mashtrimit dhe të dredhisë. Ky aktivitet ndërmerret me qëllim të çrrënjësjes së thelbit të fesë, nën petkun e besimit për t'u dukur. Nëpërmjet hipokrizisë (*nifakut*), përkrahësit e rebelimit mbajnë idetë e tyre të fshehura satanike, kështu që bëhet e vështirë për njerëzit e thjeshtë të zbulojnë motivet e tyre antifetare.

Për këtë arsye, Kur'ani e ka konsideruar atë gjynahun më të rëndë dhe paralajmëron njerëzit për më të madhin e rreziqeve në këtë botë dhe në Botën Tjetër, duke i nxitur ata që të ngrihen dhe të bëjnë të gjitha përpjekjet e tyre për të mbrojtur fenë e tyre.

Armiqtë, zakonisht, i drejtohen përballjes me Islamin dhe myslimanët në dy mënyra. Kur'ani, gjithashtu, ofron udhëzime që kanë të bëjnë me kompletet e armiqve.

### *1. Rebelimi i armatosur*

Një nga mënyrat konvencionale të konfrontimit me Islamin dhe myslimanët është lufta fizike apo lufta e hapur. Me pushtimin ushtarak të vendeve myslimane, duke vrarë myslimanët dhe duke plaçkitur burimet e tyre pasurore, ata përpiqen të arrijnë objektivat e tyre. Në këtë mënyrë, ata vrasin myslimanët dhe shkatërrojnë vendet myslimane, por ata kurrë nuk arrijnë qëllimet e tyre. Duke dhënë jetën për hir të fesë, myslimanët jo vetëm që nuk humbasin aspak, por besimi i tyre bëhet më i fortë dhe më i qëndrueshëm.

Në kulturën fetare, qëllimi i jetës në këtë botë është përsosja e njeriut dhe arritja e afërsisë hyjnore me anë të besimit, të adhurimit dhe nënshtrimit ndaj Zotit, shkalla më e lartë e të cilës është martirizimi në rrugën e Zotit.

Ndërkohë, qëndrimi i Kur'anit ndaj kësaj strategjie të armiqve është si vijon:

وَقَاتِلُوهُمْ حَتَّى لَا تَكُونَ فِئْتَهُ وَيَكُونَ لِلدِّينِ كُلِّهِ لِلَّهِ

**“Luftojini ata, deri sa të zhduket mosbesimi dhe deri sa të mbretërojë besimi vetëm për Allahun!”<sup>1</sup>**

Në këtë luftë, slogani i myslimanëve është si vijon:

قُلْ هَلْ يَرْضَوْنَ بِنَا إِلَّا إِخْدَى الْحُسَيْنَيْنِ وَمَنْ يَرْضُ بِكُمْ أَنْ يُصِيبَكُمُ اللَّهُ بِعَذَابٍ مِنْ عِنْدِهِ أَوْ يَأْتِيَنَا فَتَرْتَضَوْا إِنَّا مَعَكُمْ مُتَرْضَوْنَ

**“Thuaj: ‘Çfarë prisni për ne, përveçse njëjës prej dy të mirave (fitores ose martirizimit)? Ndërsa ne po presim që Allahu t’ju godasë me dënim nga ana e Tij ose me duart tona. Pra, pritni se edhe ne me ju do të presim.”<sup>2</sup>**

## 2. Rebelimi kulturor

Qasja e dytë kryesore e armiqve në përballjen me Islamin dhe myslimanët përbëhet prej aktiviteteve kulturore, të cilat nxisin dyshim në zemrat e myslimanëve. Qasja, mënyrat dhe mjetet,

<sup>1</sup> “Sure “El Bekare”, ajeti 193.

<sup>2</sup> Sure “Et Teube”, ajeti 52.

metodat dhe pasojat e përdorura në këtë lloj konflikti janë të ndryshme nga një sulm ushtarak. Në një sulm ushtarak, armiku del në front me armët më të përparuar, për të vrarë fizikisht myslimanët dhe për të plaçkitur pasuritë e tyre.

Në sulmin kulturor, pena dhe fjala janë përdorur për të mashtruar dhe për të korruptuar mendjet e myslimanëve.

Në një sulm ushtarak, armiku përballet me luftëtarët myslimanë në mënyrën më të ashpër të mundshme, ndërsa në sulmin kulturor, armiku pretendon të jetë plot "simpati dhe shqetësim". Në një sulm ushtarak, myslimanët mund ta shohin armikun, ndërsa në sulmin kulturor, identifikimi i armikut nuk është një detyrë e lehtë. Në sulmin ushtarak, armiku ka për qëllim të zhdukë trupat fizikisht, nga përdorimi i minave dhe i armëve të sofistikuar. Në sulmin kulturor, ai ka ndërmend të fitojë zemrat dhe mendjet për interesat e tij nëpërmjet indoktrinimit të tyre.

Në një sulm ushtarak, armiku ka aftësinë për të dërguar jashtë vetëm një numër të caktuar të luftëtarëve myslimanë nga kjo botë e pandershme materialiste. Në sulmet kulturore, djajtë qëndrojnë në pritë për të joshur të rinjtë e pafajshëm, burimin më të madh të një kombi mysliman, që nuk ka njohuri të mjaftueshme të shkencave fetare dhe normave dhe i mbytet ato në mosbesimin dhe ateizëm.

Është e vërtetë se armiqtë nuk do të dalin të fituar nga kjo luftë kundër fesë dhe kombit mysliman, sepse të rinjtë tanë myslimanë janë të arsimuar. Ata, me nder dhe fitore, dolën nga lufta e armatosur dhe pushtimi, janë mjaft vigjilentë për të zbuluar ndryshimin e armikut nga fronti ushtarak në atë kulturor.



Megjithatë, për shkak të seriozitetit të rrezikut dhe pasojave të pariparueshme të humbjes në frontin kulturor, Kur'ani i Shenjtë, duke paralajmëruar myslimanët, i nxit ata të qëndrojnë të vendosur kundër armiqve të Zotit dhe fesë.

### ***Paralajmërimi i Kur'anit kundër rebelimit kulturor***

Meqenëse lumturia e myslimanëve në këtë botë dhe në Botën Tjetër do të jetë e rrezikuar në rast neglizhence, Kur'ani i paralajmëron myslimanët kundër rebelimit kulturor dhe e konsideron atë si më serioz se një sulm ushtarak.

Kur'ani i Shenjtë thotë:

وَأَقْتُلُوهُمْ حَيْثُ تَمَفُّتُوهُمْ وَأَخْرِجُوهُمْ مِّنْ حَيْثُ أَخْرَجُوكُمْ وَالْفِتْنَةُ أَشَدُّ مِنَ الْقَتْلِ

**“Vritini ata kudo që t’i gjeni dhe dëbojini prej vendeve, ashtu siç ju dëbuan ata ju. Mosbesimi është më i rëndë se vrasja.”<sup>1</sup>**

Natyrisht, ne jemi të vetëdijshëm se kundërshtarët e Kur'anit, gjatë shpalljes së tij dhe me ardhjen e Islamit, me anë të agresionit ushtarak janë munduar ta shuajnë Islamin dhe myslimanët. Megjithatë, Kur'ani i jep më shumë rëndësi kërcënimit të rebelimit kulturor dhe fetar, se sa agresionit ushtarak.

Kur'ani thotë:

وَالْفِتْنَةُ أَكْبَرُ مِنَ الْقَتْلِ

---

<sup>1</sup> Sure “El Bekare”, ajeti 191.

**"Dhe Përçarja është më e rëndë se vrasja."**<sup>1</sup>

Kjo do të thotë: Politeizmi është më i rrezikshëm se agresioni ushtarak dhe vrasjet, dhe mëkati i kryerjes së tij është më i rëndë se ai vrasjes së myslimanëve.

***Politeizmi (shirku) me petkun e ri***

Politeizmi (*shirku*) ka ekzistuar krahas monoteizmit (*teuhid*) në të gjithë historinë e njerëzimit. Ata që refuzuan t'i nënshtrohen Krijuesit të universit, kanë qenë në ndjekje të kënaqjes së dëshirave të tyre materiale e trupore dhe vazhdimisht kanë penguar monoteistët në mënyra të ndryshme.

Ithtarët e politeizmit përshtatën me zgjuarsia mënyrën e jetesës së njerëzve të kohës dhe zgjodhën metodat e duhura për të arritur objektivat e tyre. Si i tillë, pasi politeizmi u manifestua në formën e idhujtarisë, në periudhën e hershme të Islamit, prijësit e politeizmit nxitën adhurimin e idhujve të bërë prej guri dhe druri, duke i penguar njerëzit nga prirja për adhurimin e një Zoti të vetëm. Arsyeja prapa këtij qëndrimi ishte se, me mbizotërimin e kulturës monoteiste, nuk do të kishte vend për të kënaqur dëshirat e tyre trupore e sensuale.

Sot, politeizmi, në formën e tij moderne, është pasqyruar nën maskën e "teorive shkencore" në tubime dhe qarqe të ndryshme. Në qoftë se gjatë periudhës së hershme të Islamit, 360 idhuj apo më shumë, u adhuruan dhe u reklamuan nga materialistët që të

---

<sup>1</sup> Sure "El Bekare", ajeti 217.

trullosnin mendjet e njerëzve, sot elementet e politeizmit përpiqen të krijojnë sa më shumë idhuj si njerëz, i dekurajojnë ata nga të menduarit për Allahun e Lartësuar dhe tërheqin vëmendjen e tyre me dinakëritë dhe paragjykimet satanike.

Është e qartë se koncepti i “shtigjeve apo i rrugëve të drejta e të ndershme”, ose “interpretime të ndryshme të fesë” i takon kësaj kategorie, pasi kjo do të thotë se çdo person mund të marrë çdo gjë që ai e kupton në lidhje me Zotin dhe fenë nga tekstet fetare, si bazë e besimit dhe e veprimit të tij, sepse kjo është e vërteta dhe realiteti.

Prandaj, të gjithë mund të kenë hyjnitë e tij private apo personale dhe fenë e tij. Është e qartë se ky koncept është diametralisht i kundërt me frymën e monoteizmit, i cili është mishëruar në formulën e besimit: *“Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!”* (*La ilahe ilall'Allah*)

Meqenëse subjekti më i ndjeshëm në jetën e njeriut është besimi i tij, prej të cilit varet lumturia e tij në këtë botë dhe në Botën Tjetër, është me vlerë të rishikojmë besimin dhe idetë e tij, bazuar mbi Kur'anin dhe mësimet e të Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*) dhe të vlerësojë në mënyrë racionale apo logjike ato, pa u devijuar nga trillet dhe tekat e tij, sepse vetëm në këtë mënyrë ai mund ta çlirojë veten nga kurthet e shejtanit dhe humnera e devijimit.

Sigurisht, për të pastruar vetveten dhe për të kapërcyer dëshirat trupore, është jashtëzakonisht e vështirë dhe nuk është pa qëllim që i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e ka konsideruar atë “*xhihadi i madh*” (*xhihad al-akbar*).

Është e vërtetë se në një situatë të tillë, njeriu, për të shpërfillur zotimet dhe premtimet e armiqve të Islamit, të ndërmarrë xhihadin e madh, është një arritje mahnitëse dhe e mrekullueshme, por nuk është e pamundur. Në histori, shumë individë kanë ardhur në vete në momentin e fundit, çliruan veten nga dëshirat e tyre trupore dhe kurthi i djajve nga xhindët dhe njerëzit, shpëtuan veten nga kërcënimi i mallkimit të përjetshëm dhe u kthyen në gjirin e monoteizmit.

### ***Lajmërimi i Kur'anit për lindjen e rebelimit në fe***

Kur'ani i Shenjtë ka udhëzuar myslimanët, duke u treguar mënyrat për të arritur përsosmërinë dhe lumturinë. Si një pishtar ndriçues, që nuk do të shuhet kurrë, ai e ka bërë rrugën e drejtë të udhëzimit të qartë për kërkuesit e ndjekësit e të vërtetës.

I Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), gjithashtu, ka shkundur dhe ka larë pluhurin dhe shëmtirat e politeizmit mbi faqen e njerëzimit, mbolli farën e shpresës dhe çliroi zemrat e atyre që janë të etur për të vërtetën. E bëri atë të frytshme dhe themeloi qeveri të bazuar në monoteizëm. Ndërkohë, shumë myslimanë u bënë të padobishëm dhe besimi i tyre nuk kalonte përtej deklaramit me gojë.

Besimi i vërtetë tek Allahu nuk u rrënjos në zemrat e tyre. Natyrisht, individë të tillë i dhanë përparësi dëshirave të tyre trupore mbi vullnetin e Zotit dhe urdhrave të të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Gjatë jetës së Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut*

qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), armiqtë e fshehtë të Islamit dhe të të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk e konsiderojnë të dobishme, të përshtatshme të shprehin hapur armiqësinë e tyre dhe të zbulojnë komplotin e tyre për të ndryshuar drejtimin e qeverisjes hyjnore, kundërshtojnë Imamët e Pagabueshëm dhe kufizojnë njerëzit nga udhëzimi i tyre hyjnor. Këta djaj dhe njerëzit materialistë priten vdekjen e të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për të zbatuar skemat e tyre të liga dhe ogurzeza.

Duke parashikuar këtë komplot, Kur'ani i Shenjtë jep këtë paralajmërim:

أَحْسِبَ النَّاسُ أَنْ يُزَكُّوا أَنْ يَقُولُوا آمَنَّا وَهُمْ لَا يُفْتَنُونَ

**“Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë ‘Ne besojmë’, pa u vënë në provë?!”<sup>1</sup>**

***Lajmërimi i lindjes së rebelimit pas të Dërguarit të Allahut*** (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)

Një ditë, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) po fliste për Kur'anin, duke i ftuar njerëzit të kapen fort pas fortesës hyjnore (*habl'ul-matin*), të ndjekin udhëzimet e tij, duke dhënë myzhde lumturie në Parajsë për besimtarët e duke i paralajmëruar hipokritët dhe rebelët për ndëshkim në zjarrin e ferrit.

<sup>1</sup> Sure “Ankebut”, ajeti 2.

Një burrë u ngrit dhe e pyeti rreth rebelimit dhe i kërkoi Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) që të citonte një thënie të Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për këtë çështje.

Në përgjigje, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) kujton momentin e shpalljes së ajetit, **"Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë: 'Ne besojmë', pa u vënë në provë?"**<sup>1</sup>, dhe se si i informoi njerëzit i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për dukurinë e fitnesnë fe, si një provë të madhe.

Ai tha se e kuptoi që rebelimi do të ndodhte pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe e pyeti të Dërguarin e Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për natyrën e rebelimit në fe. I Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i tha: **"Pas meje, umeti im do të përjetojë fitnen."**

Pastaj i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) përmend llojet e rebelimit që do të kryhen nga materialistët, duke theksuar tri lloje:

يَا عَلِيُّ إِنَّ الْقَوْمَ سَيُفْتَنُونَ بِأَمْوَالِهِمْ وَيَتَّبِعُونَ بِدِينِهِمْ عَلَى رِيْبِهِمْ وَيَتَّبِعُونَ رَحْمَتَهُ وَيَأْمَنُونَ سَطْوَتَهُ يَنْسَجِلُونَ حَرَامَهُ بِالشُّبُهَاتِ  
الْكَاذِبَةِ وَالْأَهْوَاءِ الشَّاهِيَةِ، فَيَنْسَجِلُونَ الْحَمْرَ بِالتَّيْنِذِ وَالسُّخْتِ بِالْهَدْيَةِ وَالتَّرْبَا بِالتَّبِيْعِ.

**"O Ali! Me siguri njerëzit do të testohen me pasurinë e tyre. Ata do të llogariten si një favor për Zotin e tyre, me pranimin e fesë, si dhe do të presin mëshirën dhe imunitetin e Tij nga ndëshkimi. Ata do të bëjnë të**

<sup>1</sup> Sure "El Bekare", 2: 217.

*ligjshme atë që Ai e ka ndaluar me dyshime të pajustificueshme. Kështu, ata do të barazojnë verën me shurupin e frutave, ryshfetin me dhuratën dhe kamatën (riba) me tregtinë.”<sup>1</sup>*

## **1. Fitneja financiare**

I Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) përmend si llojin e parë, rebelimin në çështjet e pasurisë. Ata që janë njohur me jurisprudencën islame (*fik'h*) e dinë se një numër i madh i ligjeve praktike të Islamit merren me pasurinë, biznesin, tregtinë, si dhe me çështjet ekonomike. Në Islam, të drejtave individuale u është kushtuar një vëmendje shumë e veçantë.

Janë miratuar rregulla dhe rregullore në transaksionet tregtare të biznesit dhe të tregtisë, në bazë të interesave të vërteta të jetës shoqërore të njeriut. Duke i respektuar ato, njerëzit mund të ndihen të lumtur në këtë botë dhe në Botën Tjetër. Marrëdhëniet ekonomike në shoqëri realizohen kryesisht në formën e tregtisë ose të shitblerjes dhe ngrehina apo struktura e jetës shoqërore është e bazuar në transaksionet sociale, bashkëpunimin dhe ndihmesën reciproke për njëri-tjetrin, në zgjidhjen e problemeve të ndryshme.

Për shkak të instinktit të përfitimit të njeriut, transaksionet me fajde, lloji më i keq, më i pështirë dhe më i neveritshëm nga transaksionet, sipas Islamit, ka qenë i përhapur në mesin e njerëzve, gjë të cilën Kur’ani e ka ndaluar me ashpërsi për ta kryer. Toni i ndalimit të kësaj praktike, nga Kur’ani, është aq i këshillueshëm,

---

<sup>1</sup> “Biharul Anuar”, vëll. 32, f. 341.

saqë e konsideron atë të barasvlershëm me ndërmarrjen e luftës kundër Zotit:

فَإِنْ لَمْ تُنْعَمُوا فَأَنْزَلْنَا مِنْ اللَّهِ

**“Nëse nuk e bëni këtë, atëherë u është shpallur luftë nga Allahu dhe i Dërguari i Tij.”<sup>1</sup>**

I Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Pas meje, njerëzit do të goditen me fitne, në marrëdhëniet pasurore e ekonomike, do të injorojnë dekretet e qarta të Kur'anit për ndalimin e kamatës dhe do të praktikojnë kamatën, nën pretekstin e tregtisë dhe të biznesit bazuar në arsyetime të rreme.”*

## 2. Fitneja ideologjike

Zoti i Lartësuar ka krijuar universin dhe na ka dhënë bekimin e ekzistencës. Ai e ka përmbushur dhuratën e Tij mbi ne, qeniet njerëzore, duke dërguar shërbëtorët e Tij më të mirë, shkrimet hyjnore për ne, për të arritur përsosmërinë dhe begatinë. Mirënjohja për bekimin dhe udhëzimin mund të shprehet vetëm me njohjen e nënshtrimit ndaj Zotit, që është pozita më e lartë e mundshme e njeriut.

Është e neveritshme, e pështirë dhe e urryer të hasësh një njeri injorant, të ndihet se po i bën Allahut nder, duke pranuar udhëzimet dhe dekretet e tij. Ai nuk mund të kuptojë se Zoti, në të vërtetë, e meriton mirënjohjen tonë, sepse është Ai që na ka udhëzuar e drejtuar drejt fesë së vërtetë.

---

<sup>1</sup> Sure “Bekare”, ajeti 279.



Duke iu drejtuar të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), Kur'ani i Shenjtë thotë:

يَمْتُونُ عَلَيْكَ أَنْ أُسْلِمُوا قُلْ لَا تَمْتُونَا عَلَىٰ إِسْلَامِكُمْ بَلِ اللَّهُ يَمُنُّ عَلَيْكُمْ أَنْ هَدَاكُمْ لِلْإِيمَانِ

**“Ata e quajnë si favor për ty që kanë pranuar Islamin. Thuaju: ‘Mos e quani si favor për mua se keni pranuar Islamin, përkundrazi, Allahu ju ka dhuruar mirësi dhe ju ka udhëzuar në besim, nëse alla që thoni është e vërtetë!’”<sup>1</sup>**

Prandaj, nga pikëpamja fetare, kriteri është qenie rob dhe nënshtrim ndaj Zotit dhe jo të qenit egoist dhe arrogant ndaj Allahut. I Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) paraqet egoizmin dhe ndjenjën e arrogancës në vend të frymës së nënshtrimit dhe dorëzimit ndaj Zotit, si një nga manifestimet e rebelimit në fe.

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Pas meje, një nga manifestimet e rebelimit në fe është që në vend të të qenit mirënjohës ndaj Allahut për bekimin e fesë dhe udhëzimin hyjnor, njerëzit do të ndihen se Allahu u detyrohet atyre për pranimin e fesë së Tij dhe presin shpërblimin dhe mëshirën e Tij si diçka të drejtë! Në mënyrë të ngjashme, për përqaftimin e fesë së Islamit, ata do të mendojnë plot arrogancë, se nuk meritojnë ndonjë ndëshkim.”

Është e vërtetë se Zoti i Lartësuar, nuk ndëshkon shërbëtorin e tij pa pasur ndonjë arsye. I Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) konsideron të pasurit e një ndjenje të tillë si *fitne* në fe, pasi ata që kanë këtë ndjenje, sa herë

<sup>1</sup> Sure “Huxhurat”, ajeti 17.

që respektimi i normave fetare është në përputhje me dëshirat e tyre trupore, do ta mashtrojnë lehtësisht veten dhe të tjerët me arsyetime të pabaza. Si e tillë, të kesh ndjenjën e arrogancës ndaj Allahut, është e neveritshme për fenë e vërtetë dhe frymën e Islamit, që është nënshtrimi i plotë ndaj vullnetit të Zotit.

### 3. Arsyetimet e rreme, fitnet më të rrezikshme

Fitneja më e rrezikshme që e shqetësoi të Dërguarin e Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe për të cilën ai i paralajmëroi njerëzit, duke ia përmendur atë Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), është fitneja ose komploti i shtrembërimit (*tahrif*) në fe dhe kalimi i urdhrit mbi atë çka Allahu e ka ndaluar. Është e vërtetë se mosrespektimi i ligjeve fetare (*shariatit*) dhe ndjenja e arrogancës ndaj Allahut të Plotfuqishëm është me të vërtetë një gjynah thelbësor, por ajo që është më e rëndë, është fabrikimi i arsyetimeve të gënjeshtërtë për veprimtari antifetare dhe t'i japësh një ngjyrë fetare dëshirave trupore e sensuale.

Në këtë rast, shejtani nxiton për shpëtimin e myslimanëve materialistë dhe i ndihmon ata duke shtrembëruar ligjet fetare.

I Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë se në mënyrë që t'u shërbejë epsheve të veta, kërkuesit e fitnes mbështeten në dyshime, në arsyetime të rreme dhe në argumente të kota, për të shpallur të lejuar atë që Allahu e ka ndaluar dhe tallen me fenë e Tij.

Ajo që vlen të përmendet, është se i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka

përmendur posaçërisht vazhdimësinë e fitnes, që do të vazhdojë të ekzistojnë deri në ardhjen imam Mehdiut.

Ajo që i Dërguari i Allahut përmend si shembuj të fitneve, të tilla si vera që konsiderohet si e ligjshme, me pretekstin se është e njëjtë si shurupi apo lëngu i frutave, apo ryshfeti, si sinonim i dhënies së dhuratave, apo fajdeja, si identike me tregtinë, janë vetëm disa prej fitneve në fe dhe nuk janë të kufizuara me këta shembuj.

Në ditët e sotme, ka myslimanë, të cilët nuk e konsiderojnë veten jashtë Islamit, por, në realitet, nuk pranojnë besnikërisht ligjet hyjnore. Ata që kanë pozita sociale, marrin një qëndrim vetëmbrojtës për shkak të ndikimit të kulturës perëndimore dhe bëhen të huaj për identitetin e tyre fetar. Nga ana tjetër, njohja prej tyre e shkencave fetare nuk është e mjaftueshme.

Ndërkohë, pavarësisht paaftësisë së tyre për shprehjen e pikëpamjeve për çështje të veçanta fetare, ata guxojnë të japin vendime dhe, ndonjëherë, janë të ndikuar nga dinakëritë djallëzore dhe janë të nxitur nga armiqtë e fesë. Me apo pa vetëdije, fjalët e tyre nuk kanë asnjë domethënie veç mohimit të fesë dhe largimit nga Islami.

Për shembull, nëse një person pohon se ligjet e Islamit janë të zbatueshme vetëm për njerëzit e asaj periudhe dhe në shekullin e 21-të, Kur'ani dhe ligjet e Islamit nuk janë të afta për administrimin e shoqërisë, dhe ligjet e dekretet e tij duhet të ndryshohen në përputhje me kërkesat dhe gjykimin e popullit, apo njerëzit e shekullit të 21-të duhet të kenë një profet, i cili është i përshtatshëm për kohën, pohime të tilla mund të konsiderohen jo

vetëm një mohim i fesë, por kuptim i gabuar i fesë dhe i ligjeve të saj nga pretenduesit e lartpërmendur.

Ata që bëjnë pohime të tilla, supozohet t'i kushtojnë vëmendje pasojave dhe ndikimeve për pohimet e tyre. Ndoshta ata do të shmangin thënien e diçkaje që mund të konsiderohet rebelim ndaj fesë dhe të shpëtojnë veten nga kurthi i djallit dhe i armiqve të Islamit dhe të Kur'anit.

### ***Errësimi i atmosferës, me qëllim mashtrimin e masës***

Metodologjia e armiqve të fesë dhe të Kur'anit, në krijimin e fitnes dhe të agresionit ushtarak, është krejtësisht i ndryshëm nga rruga e tyre, e ndërmarrjes së sulmit kulturor dhe i rebelimit. Në kundërshtim me agresionin ushtarak, në fitnen kulturore, ata kurrë nuk e tregojnë hapur veten, duke mohuar fenë dhe duke kundërshtuar kulturën fetare të popullit, apo të shprehin hapur besimet e tyre të vërteta.

Ajo që ekziston në shoqërinë tonë, si fitneja kulturore, për momentin, është se armiqtë e Kur'anit dhe të kulturës fetare, errësojnë atmosferën kulturore në një mënyrë të tillë, që njerëzit, veçanërisht të rinjtë e arsimuar, humbasin forcën e identifikimit të së vërtetës nga falsiteti dhe, në mënyrë të pandërgjegjshme, bien në kurthin e mendimeve të rreme dhe të besimeve të kota. Natyrisht, në qoftë se klasa e arsimuar e një vendi, goditet me devijimin intelektual, porta për devijimin dhe mashtrimin e publikut do të jetë e hapur, sepse nëse dijetari (alimi) degjeneron, edhe bota (alam) do të degjenerohet.

Prandaj, fitneja kulturore, siç paralajmëron i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), është një nga gjërat më të rrezikshme që kërcënon lumturinë e njerëzve në këtë botë dhe në Botën Tjetër.

Është e qartë se në trajtimin e kërcënimeve të tilla, shteti islam duhet të jetë i vendosur në deklarin e të vërtetave të fesë dhe në përhapjen e kulturës dhe të mësimave të Kur'anit, si dhe të mbikëqyrë sistemin arsimor, nga niveli parashkollor deri në universitet dhe të gjitha qendrat kulturore, që armiqtë keqdashës të Islamit nuk do të mund të mashtrojnë të tjerët me anë të errësimit të atmosferës kulturore.

Nga ana tjetër, detyra më themelore e dijetarëve fetarë është të ndriçojë njerëzit, veçanërisht të rinjtë, të cilët nuk kanë njohuri të mjaftueshme të mësimave fetare dhe të shkencave kur'anore dhe të luftojnë fitnet kulturore. Dijetarët fetarë janë të detyruar të informojnë njerëzit, veçanërisht të rinjtë, për kërcënimet kulturore dhe komplotin e armiqve të fesë, për t'i mbajtur ata larg nga kurthet e shejtanit. Njerëzit fetarë mund të ndihmojnë studiuesit e përkushtuar fetarë në përmbushjen e misionit të tyre të madh për drejtimin e shoqërinë.

Siç u tha në fillim të librit, në këtë pjesë do të përmendim motivet e kundërshtarëve të kulturës fetare, siç është shënuar në "Nehxhul Belaga" nga Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*). Ne, së pari, duhet të përcaktojmë këto elemente dhe pastaj të përmendim motivet e këtyre individëve, që kundërshtojnë kulturën fetare dhe të mësimet e Kur'anit.

### **Shtrembëruesit e mësimeve fetare, sipas Imam Aliut**

(Paqja qoftë mbi të!)

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) i quajti ata që shtrembërojnë të vërtetat e fesë dhe korruptojnë kulturën fetare të popullit si "inJORANTË,pseudo të ditur". Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

وَأَخْرَجَ قَدْ تَسَمَّى عَالِمًا وَلَيْسَ بِهِ.

"Ndërsa (lloji) tjetër është njeriu, që e quan veten të ditur e të shkolluar, por nuk është i tillë."<sup>1</sup>

Ata që kundërshtojnë ithtarët e Kur'anit janë njerëz, që e quajnë veten dijetarë, edhe pse, në realitet, ata nuk janë të tillë. Duke përdorur tituj të rremë, ata mashtrojnë dhe largojnë nga udha e drejtë njerëzit.

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

فَأَقْبَسَ جَاهِلًا مِنْ جَاهِلٍ.

"Ai ka mbledhur inJORANCËN prej të padijshmëve."<sup>2</sup>

Me fjalë të tjera, atë që e pohonin si subjekte dhe interpretime akademike të fesë dhe synonin të impononin besimet fetare, nën pretekstin e interpretimeve të ndryshme të fesë, janë elemente të inJORANCËS, që kanë fituar nga miqtë inJORANTË. Ndoshta, ju mund të pyesni veten se si një inJORANT mund të mësojë diçka prej një të

<sup>1</sup> Guraul Hikem, vëll. 7, f. 269.

<sup>2</sup> "Nehxhul Belaga", Ligjërata 86.

padituri. Çfarë do të thotë “një injorant merr mësim nga një i paditur”?!

Për t’u bërë i vetëdijshëm mbi mrekullinë e fjalëve të Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe për të qenë më të informuar për përgjegjësitë tona, në ndriçimin e njerëzve prej devijuesve të tillë nga e vërteta, ne do të citojmë një shembull të pseudodijetarëve injorantë, që mësojnë nga injorantët e tjerë, përmes asaj që ata e quajnë “metoda shkencore”.

Sot, në Perëndim besohet se përvetësimi i dijes është i pamundur për njeriun dhe ai duhet të jetë skeptik për çdo gjë dhe nuk ka siguri për çdo temë. Ithtarët e kësaj ideje besojnë se, për një person që thotë se është i sigurt për një çështje të caktuar, është shenjë e injorancës dhe e marrëzisë, sepse është e pamundur që të dihet gjithçka. Duke qenë krenar për këtë dyshim dhe injorancë, ata argumentojnë se shenja e dijes, e mësimi dhe e inteligjencës për njeriun është të jesh skeptik për çdo njohuri dhe siguri në çdo çështje, fetare ose jo fetare.

Argumente të tilla të pabaza e të dobëta janë paraqitur përgjatë njëqind vjetëve të kaluara, apo më shumë, në mesin e evropianëve. Para kësaj, ekzistonte, gjithashtu, baza intelektuale e skeptikëve. Në shoqërinë tonë, sot, ka nga ata që kanë për qëllim të dobësojnë bindjet fetare të njerëzve, duke hedhur dyshim mbi besimet e tyre fetare, me pretendimin se njeriu nuk mund të ketë njohuri të caktuar në çdo fushë, dhe, në këtë mënyrë, të realizojë qëllimet e tij për të kënaqur epshet apo dëshirat e tij sensuale. Në mënyrë mjaft interesante, ata paraqitën këto mosmarrëveshje, nën pretekstin e “çështjeve akademike” dhe presin që njerëzit tanë të

kujdesshëm dhe të zgjuar t'i pranojnë goditjet e tyre dhe ta hanë karremin.

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) vuri në dukje ekzistencën e individëve të tillë të ligj gjatë gjithë historisë dhe ka thënë:

فَاتَّبَسَ جَهَائِلَ مِنْ جُهَالٍ وَأَصَالِيْلَ مِنْ ضَلَالٍ.

"Njeriu përfton injorancën nga injorantët dhe devijimin nga të devijuarit."<sup>1</sup> Ata mësojnë tema qesharake nga një grup personash të paditur dhe të devijuar dhe i diskutojnë e i quajnë ato si "fakte shkencore". Një shembull i "fakteve të tyre shkencore" është se njeriu duhet të dyshojë për çdo gjë dhe të mos ketë siguri për çdo gjë! Në lidhje me çështjet fetare, ata thonë se çfarëdo që kupton personi, është e vërteta! Kjo ndodh për shkak se në thelb, e vërteta dhe e pavërteta nuk ekzistojnë! Nuk ka asnjë kriter për të vërtetën dhe gënjeshtren, përveç të kuptuarit vetjak të çdo personi.

Gjithashtu, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:

وَتَصَبَّ لِلنَّاسِ أَشْرَاكًا مِنْ حِبَالِ غُرُورٍ، وَقَوْلٍ زُورٍ.

"Ai ka vendosur për njerëzit një kurth (të bërë) prej litarësh mashtrimi dhe ligjërimit mashtrues."<sup>2</sup>

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka vazhduar më tej:

قَدْ حَمَلَ الْكِتَابَ عَلَى آرَائِهِ.

<sup>1</sup> Po aty.

<sup>2</sup> Po aty.



“Ai e kupton Librin (Kur'anin) sipas pikëpamjeve dhe pasioneve të tij.”<sup>1</sup> Pastaj, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) e zhvendos vëmendjen e tij drejt stileve propagandistike të këtyre njerëzve dhe thotë:

وَعَطَفَ الْحَقُّ عَلَى أَهْوَائِهِ، يُؤْمِنُ مِنَ الْعَظَائِمِ، وَمُؤْمِنٌ كَبِيرٌ الْجَرَائِمِ.

“Ai i bën njerëzit të ndihen të sigurt nga gjynahet e mëdha dhe i trajton krimet e rënda si të lehta.”<sup>2</sup>

Kjo do të thotë: Një përpjekje për të tërhequr vëmendjen e njerëzve, që t'i bëjë ata të ndihen të sigurt nga pasojat e mëkateve të tyre të mëdha, t'i paraqesin mëkatet e mëdha si të parëndësishme dhe, në këtë mënyrë, t'i nxisin ata për kryerjen e krimeve dhe veprave të këqija. Ata, në të vërtetë, përpiqen të dobësojnë bindjet dhe devotshmërinë fetare.

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

يَسْأَلُ: أَقْبَىٰ عِنْدَ الشُّهُبَاتِ، وَفِيهَا وَقَعٌ، وَيَقُولُ: أَعْتَزِلُ الْبِدْعَ، وَيَبْتَهَا اضْطَجَعَ. فَالصُّورَةُ صُورَةُ إِنْسَانٍ، وَالْقَلْبُ قَلْبُ حَيَوَانَ، لَا يَعْرِفُ بَابَ الْهُدَىٰ فَيَتَّبِعُهُ، وَلَا بَابَ الْعَىٰ فَيُضِدُّ عَنْهُ، فَذَلِكَ مَيْثُ الْأَوْخِيَاءِ!

“Ai thotë se është në pritje për sqarimin e dyshimeve, por është i zhytur në to dhe mënjanohet prej futjeve të gjërave të reja në fe, por në fakt është i zhytur në to. Forma e tij është ajo e një njeriu, por zemra e tij është ajo e një kafshe. Ai nuk di të ndjekë derën e udhëzimit apo t'i qëndrojë larg derës së devijimit. Njerëz të tillë jetojnë në trup të vdekur.”<sup>3</sup> Pastaj, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) iu drejtua popullit: “Nga po shkoni?<sup>4</sup> Atëherë,

<sup>1</sup> Po aty.

<sup>2</sup> Po aty.

<sup>3</sup> Po aty.

<sup>4</sup> Sure “Tekuir”, ajeti 26.

si largoheni prej Tij?!<sup>1</sup> Shenjat (e udhëzimit) qëndrojnë në këmbë, treguesit (e virtytit) janë të qartë dhe minaret (e dritës) janë ngritur. Ku po largoheni nga e vërteta drejt të kotës dhe pse endeni kuturu, ndërkohë që midis jush keni pasardhësit e Profetit? Ata janë frerët e të Drejtës, shenjat e Besimit dhe gjuha e të vërtetës. Jepuni atyre të njëjtën pozitë të mirë siç i jepni Kur'anit dhe afrohuni tek ata (për të shuar etjen për udhëzim), ashtu si devetë e etura që i drejtohen burimit të ujit."<sup>2</sup>

Me një ton më të ashpër se ajo e Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), Kur'ani i Shenjtë i përshkruan këta injorantë pseudo të ditur dhe i paralajmëron njerëzit për mashtrimet e tyre:

وَكَلَّمَكَ جَعَلْنَا لِكُلِّ نَبِيٍّ عَدُوًّا شَيَاطِينَ الْإِنْسِ وَالْجِنِّ يُوحِي بَعْضُهُمْ إِلَىٰ بَعْضٍ زُخْرُفَ الْقَوْلِ غُرُورًا وَلَوْ شَاءَ رَبُّكَ مَا فَعَلُوهُ  
فَدَرَّوهُمْ وَمَا يَفْقَهُونَ

**"Kështu, çdo Profeti Ne i kemi caktuar armiq djajtë e njerëzve dhe të xhindeve, të cilët e frymëzojnë njëri-tjetrin me fjalë boshe, të zbukuruar për mashtrim. Por, sikur të donte Zoti yt, ata nuk do të bënin kështu, prandaj lëri ata dhe trillimet e tyre."**<sup>3</sup>

Armiqtë e Profetëve dhe kundërshtarët e udhëzimit hyjnor janë qenie njerëzore nga pamja e jashtme, por, për shkak se të gjitha aktivitetet e tyre janë të drejtuara kah largimi i të tjerëve, kah rrënjësia e dyshimeve, dobësimi i besimeve fetare dhe kundërshtimi i udhëzimit hyjnor, Kur'ani i përshkruan ata si

<sup>1</sup> Sure "Gafir", ajeti 62.

<sup>2</sup> "Nehxhul Belaga", Ligjërata 50.

<sup>3</sup> Sure "En'am", ajeti 112;

shejtanë me fytyrë njeriu dhe paralajmëron njerëzit të kenë kujdes prej tyre.

### ***Trajtimi i Kur'anit nga materialistët pseudomuslimanë***

Ata që nuk kanë besimi fortë, nuk do të jenë të kënaqur me fenë dhe do të jenë gjithmonë të prirur të interpretojnë e të justifikojnë ligjet dhe vlerat fetare sipas tekave dhe dëshirave të tyre trupore. Në qoftë se interpretimi i tyre i fesë dhe i Kur'anit, sipas dëshirave të tyre trupore, do të ishte i lejuar, kjo do të ishte shumë e këndshme për këtë grup, pasi, në këtë mënyrë, ata mund të kënaqin epshet e veta dhe të vazhdojnë të shijojnë privilegjin e të qenit musliman në një shoqëri islame.

Në mënyrë të ngjashme, është e natyrshme se ata që nuk u janë bashkangjitur vlerave fetare dhe ligjeve hyjnore, mirëpresin interpretime të tilla të fesë dhe të Kur'anit. Ata ndjekin personat që interpretojnë dhe e justifikojnë fenë, Kur'anin dhe vlerat fetare, sipas dëshirave të tyre trupore, i marrin ato si modelet e tyre dhe u shprehin mirënjohje atyre.

Është po aq e natyrshme që individë të tillë nuk pajtohen me dijetarët fetarë, të cilët interpretojnë dhe shtjellojnë Kur'anin dhe ligjet e tij, ashtu si ata janë në të vërtetë, pa marrë parasysh kënaqësitë dhe pëlqimet e njerëzve.

Është me të vërtetë për të ardhur keq se sot, ne mund të jemi dëshmitarë të atyre që, nën pretekstin e "interpretimeve të ndryshme të teksteve fetare", kanë si qëllim t'i japin ngjyrë fetare

dëshirave të tyre trupore, apo dëshirave sensuale dhe të tallen me fenë e Allahut dhe me Kur'anin e Shenjtë.

Duke parashikuar gjendjen e shoqërisë, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) shfaq pakënaqësinë për tjetërsimin e Kur'anit në kohën e tij, si dhe në fund të jetës, duke thënë: *"I ankohe Allahu për njerëzit që jetojnë në injorancë dhe vdesin duke qenë në rrugë të gabuar. Për ta asgjë nuk është më e pavlefshme se Kur'ani, nëse recitohet si duhet të recitohet dhe asgjë nuk është më e vlefshme se Kur'ani, nëse ajetet e tij zhvendosen nga vendi i tyre."*<sup>1</sup>

Në mënyrë të ngjashme, në lidhje me statusin e Kur'anit dhe udhëzimet e fesë gjatë fundit të jetës së tij, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë kështu:

وَأَيُّ سَيِّئَاتِي عَلَيْكُمْ مِنْ بَعْدِي زَمَانٌ لَيْسَ فِيهِ شَيْءٌ أَخْفَى مِنَ الْحَقِّ، وَلَا أَظْهَرَ مِنَ الْبَاطِلِ، وَلَا أَكْثَرَ مِنَ الْكُذْبِ عَلَى اللَّهِ وَرَسُولِهِ، وَلَيْسَ عِنْدَ أَهْلِ ذَلِكَ الزَّمَانِ سِلْعَةٌ أُبْوَرَ مِنَ الْكِتَابِ إِذَا ثَلِي حَقٌّ يَلَاوِيهِ، وَلَا أَتَقَى مِنْهُ إِذَا حُرِفَ عَنْ مَوَاضِعِهِ، وَلَا فِي الْبِلَادِ شَيْءٌ أَنْكَرَ مِنَ الْمَعْرُوفِ، وَلَا أَعْرَفَ مِنَ الْمُنْكَرِ! فَقَدْ نَبَذَ الْكِتَابَ سَمَلَهُ، وَتَنَاسَاهُ حَفْظَتَهُ، فَالْكِتَابُ يَوْمَئِذٍ وَأَهْلُهُ مَنْفِقَاتٍ طَرِيدَانِ، وَصَاحِبَانِ مُضْطَجِبَانِ فِي طَرِيقٍ وَاحِدٍ لَا يُؤْوِعُهُمَا مُوْوٍ، فَالْكِتَابُ وَأَهْلُهُ فِي ذَلِكَ الزَّمَانِ فِي النَّاسِ وَلَيْسَا فِيهِمْ، وَمَعَهُمْ وَلَيْسَا مَعَهُمْ! لِإِنَّ الصَّلَاةَ لَا تُوَافِقُ الْهُدَى، وَإِنْ اجْتَمَعَا، فَاجْتَمَعَ الْقَوْمُ عَلَى الْفُرْقَةِ، وَاقْتَرَفُوا عَنِ الْجَمَاعَةِ، كَانَتْهُمْ أَيْمَةُ الْكِتَابِ وَلَيْسَ الْكِتَابُ إِمَامَهُمْ.

*"Sigurisht, do të vijë koha për ju, pas meje, kur asgjë nuk do të jetë më e fshehur se legjitimiteti, asgjë nuk do jetë më e dukshme se padrejtësia dhe asgjë më aktuale se pavërtetësia ndaj Allahut dhe Profetit të Tij. Për njerëzit e kësaj periudhe, asgjë nuk do të jetë më e pavalërë se Kur'ani që*

<sup>1</sup> "Nehxhul Belaga", Ligjërata 17.

*recitohet si duhet të recitohet dhe asgjë më e vlefshme se Kur'ani i zhvendosur nga pozicioni i tij në mënyrë të gabuar.*

*Dhe nëpër qytete asgjë nuk do të jetë më shumë e urryer se virtyti dhe asgjë më e pranueshme se vesi. Mbajtësit e Librit do ta hedhin atë tutje dhe hafizët e tij do ta harrojnë atë. Në këto ditë, Kur'ani dhe njerëzit e tij do të dërgohen në mërgim dhe do të dëbohen. Ata do të jenë bashkudhëtarë në një rrugë, por askush nuk do t'i ofrojë atyre strehë.*

*Si pasojë, në këtë periudhë, Kur'ani dhe populli i tij do të jetë mes njerëzve, por jo midis tyre, do të jetë me ta, por jo midis tyre, sepse devijimi nuk mund të përputhet me udhëzimin, edhe pse mund të jenë bashkë. Njerëzit do bashkohen me ndarjen dhe, për këtë arsye, do të shkëputen nga komuniteti, sikur ata të ishin udhëheqësit e Kur'anit dhe jo Kur'ani udhëheqësi i tyre.”<sup>1</sup>*

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), lajmëroi qartë, se pas tij do të vijë një kohë, kur asgjë nuk do të jetë më e fshehur se e vërteta dhe asgjë më e dukshme se gënjeshtria. Gënjeshtria dhe shpifjet ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) shpesh do të bëhen nga injorantë, pseudo të arsimuar dhe hipokritë materialistë, për të arritur qëllimet e tyre.

---

<sup>1</sup> “Nehxhul Belaga”, Ligjërata 147.

## **Paralajmërimi i Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) për njerëzit**

Çështja që ia vlen të përmendet, është paraqitja dhe përshtetja e gjendjes shpirtërore dhe kulturore të masave në të ardhmen. Është e vërtetë se ajetet kur'anore dhe deklaratat e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), që u diskutuan dhe u shqyrtuan në këtë libër, u janë drejtuar njerëzve, por shumica e tyre i janë drejtuar elitës së shoqërisë dhe atyre që mund të ushtrojnë ndikim mbi kulturën e shoqërisë.

Në këtë predikim, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) lajmëron shprehimisht gjendjen shpirtërore dhe kulturën fetare të njerëzve në të ardhmen dhe i paralajmëron ata për çrregullime të një kulture të tillë dhe neglizhencë të së vërtetës. Pas përshtetjes të frymës dominuese të një pjese të elitës së shoqërisë, të cilët, me qëllim që të rritin objektivat materiale dhe dëshirat e tyre, më së shumti do të veshin gënjeshtër dhe shpifje ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), do ta interpretojnë Kur'anin dhe fenë, në bazë të ideve të tyre personale dhe do t'i çojnë njerëzit në rrugë të gabuar, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) lajmëroi kulturën mbizotëruese të masave në këtë mënyrë:

*"Njerëzit, në atë kohë, do të jenë të tillë që, nëse Libri i Allahut (Kur'ani) do të interpretohej e do të shpjegohej saktë dhe drejt, kjo do të konsiderohej një nga gjërat më të kota për ta dhe, nëse do të interpretohej sipas dëshirave të tyre sensuale, do të bëhej gjëja më e vlefshme dhe më e dashur për ta. Në atë kohë, vlerat fetare apo hyjnore do të jenë gjërat më të*

*neveritshme për njerëzit, ndërsa vlerat antifetare do të jenë gjërat më të dashura për ta."*

Ata janë të informuar se armiqtë e Kur'anit dhe fuqitë arrogante duan që një kulturë e tillë të mbizotërojë në shoqërinë tonë. Në përputhje me agresionin kulturor, duke sulmuar detyrimet e shenjta fetare dhe duke zhvilluar një propagandë antifetare, ata përpiqen për kushte të tilla, siç lajmëroi Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*).

Në vazhdim, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "Në atë kohë, asnjë veprim nuk do të vërehet nga ata që kanë njohuri për Fjalën e Allahut, përveç indiferencës. Mbrojtësit e Kur'anit kanë detyrë të ruajnë vlerat fetare. Asgjë tjetër përveç vetëkënaqësisë dhe neglizhencës, nuk do të duket në kryerjen e detyrës. Në atë kohë, Kur'ani dhe pasuesit e tij të vërtetë, si dhe dijetarët fetarë, do të jenë në mesin e njerëzve, por, në realitet, të ndarë prej tyre dhe populli do të jetë po aq larg prej tyre.

Kjo do të ndodhë, sepse njerëzit do t'i izolojnë dhe nuk do t'i ndjekin ata. Ata do të jetojnë në mesin e njerëzve, por zemra e njerëzve nuk do të jetë bashkë me ta, sepse njerëzit do të ecin në rrugën e devijimit, e cila nuk mund të pajtohet me rrugën e Kur'anit, me rrugën e udhëzimit."

Në fund të Ligjëratat, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "Njerëzit do të jenë bashkuar në ndarje e përçarje dhe, për këtë arsye, do të shkëputen nga bashkësia islame, sikur të ishin udhëheqësit e Kur'anit dhe jo Kur'ani udhëheqësi i tyre."

Kjo do të thotë se njerëzit, në atë kohë, do të jenë të bashkuar në mosmarrëveshje dhe grindje.

Është sikur ata të bien dakord për të mos u pajtuar me Kur'anin dhe interpretuesit e tij të vërtetë, për të ndjekur injorantët, pseudo të ditur, si të ishin udhëheqësit e Kur'anit dhe do ta interpretojnë dhe do ta justifikojnë Kur'anin sipas dëshirave të tyre trupore, dhe do të shkëpusin dhe do të qëndrojnë larg myslimanëve të vërtetë, dijetarët fetarë dhe interpretuesit autentikë të Kur'anit. Në vend që ta quajnë Kur'anin si udhërrëfyesin dhe modelin e tyre të të menduarit dhe të vepruarit, ata do ta anashkalojnë Kur'anin, do të refuzojnë të pranojnë udhërrëfimin dhe drejtimin e tij dhe do ta interpretojnë Kur'anin dhe fenë sipas mendimit të tyre.

Tani, armiqtë e fesë dhe të Kur'anit bëjnë përpjekje të shumta për të mënjanuar identitetin fetar të popullit mysliman, duke i kufizuar ata nga liria dhe nderi, duke dobësuar besimet e tyre fetare. Duke marrë parasysh rëndësinë dhe ndjeshmërinë e situatës, është e domosdoshme për kombin mysliman, sidomos dijetarët fetarë, që të kuptojnë kërcënimin, të jenë vigjilentë dhe të mos jenë të vetëkënaqur në lidhje me situatën e tyre, lidhur me kërcënimin që vjen nga armiqtë e Islamit dhe të Kur'anit.

Ndërkohë, siç u përmend më parë, në një përpjekje për të arritur agjendën e tyre imperialiste, armiqtë e Islamit dhe të kufrit global, nuk e shprehin hapur armiqtësinë e tyre ndaj Islamit dhe ndaj umetit mysliman në përballjen e kulturës fetare të popullit. Ata zakonisht përdorin ato elemente myslimane që jetojnë në shoqërinë islame që, nga njëra anë, kanë pozita sociale dhe kulturore dhe, nga ana tjetër, kanë besueshmëri disi fetare.

Me qëllim, ose pa qëllim, ata që janë vegla në duart e agjentëve të huaj, krijojnë terrenin për largimin e njerëzve, duke shtrembëruar mësimet fetare. Këta individë janë kritikuar dhe janë



qortuar në shumë ajete të Kur'anit të Shenjtë dhe në traditat e Imamëve të Pagabueshëm dhe njerëzit janë paralajmëruar rreth tyre.

### ***Motivi i injorantëve pseudo të ditur në shtrembërimin e mësimëve fetare, sipas Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!)***

Siç e kam thënë më parë, Kur'ani i Shenjtë etiketon veprimtarinë e njerëzve të tillë si fitne dhe ata që duan të shtrembërojnë Kur'anin, të vërtetat dhe mësimet fetare, janë nxitës të fitneve, të cilët vijnë në shpëtim të shejtanit në devijimin e njerëzve. Tani lind pyetja: Pse, pavarësisht nga njohja e të vërtetës dhe duke qenë të vetëdijshëm për supersticionet e pabazuara që kanë fituar, ata janë të vendosur të justifikojnë largimin që u bëjnë njerëzve? Me fjalë të tjera: Cili është problemi psikologjik i atyre që synojnë të shtrembërojnë mësimet fetare dhe çojnë njerëzit në rrugë të gabuar? Cila është origjina e vërtetë e fitnes në fe, që është e aktualizuar në formën e shtrembërimit të mësimëve fetare?

Në përgjigje të kësaj pyetjeje, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:

إِنَّمَا بَدَأَ وَقُوعَ الْوَيْلِ أَهْوَاءُ تَلْبِغٍ، وَأَحْكَامٌ تُبْتَدَعُ.

*"Baza e shfaqjes së ligësive qëndron në ato dëshira, sipas të cilave veprohet dhe urdhëresave që shpiken."*<sup>1</sup>

<sup>1</sup> "Nehxhul Belaga", Ligjërata 50.

Rebelimi në fe buron nga dëshirat trupore e sensuale, dëshirat e zjarra të kësaj bote. Ata që i largojnë njerëzit, duke shtrembëruar mësimet fetare, kanë humbur shpirtin e tyre të dorëzimit dhe të nënshtrimit ndaj Allahut të Lartësuar, si rezultat i dredhive dhe i tundimeve satanike.

Fryma e nënshtrimit dhe e dorëzimit ndaj Zotit kërkon që njeriu të jetë besnik ndaj ligjeve islame dhe vlerave fetare me fjalë dhe vepra, sepse shumë dekrete fetare mund të mos jenë në përputhje me dëshirat e tij trupore dhe njeriu mund të mos jetë sinqerisht i gatshëm për të pranuar dhe për të vepruar në përputhje me to.

Në raste të tilla, qeniet njerëzore janë gjithmonë në dilemë dhe nuk kanë mundësi tjetër: të zgjedhin vullnetin e Allahut dhe ligjin islam dhe të kundërshtojnë dëshirat e tyre trupore, apo të preferojnë epshet dhe dëshirat e tyre mbi vullnetin e Allahut.

Në këtë provë të madhe, shumë njerëz janë pushtuar nga dëshirat e tyre trupore dhe ata pëlqejnë dëshirat e tyre personale para vullnetit të Zotit dhe vlerave fetare. Disa prej tyre kanë kurajën dhe thonë: "Ne jemi të lidhur nga besimet dhe vlerat fetare. Ne nuk do të shtrembërojmë apo nuk do të kundërshtojmë vlerat fetare."

Ky lloj qëndrimi ndaj fesë nuk mund të konsiderohet fitne në fe, sepse askush nuk është dërguar në rrugë të gabuar me anë të mashtrimit.

Mungesa e frymës së dorëzimit dhe e nënshtrimit ndaj Zotit dhe urdhëresat e Tij mund të jetë një burim i fitneve, kur ata që nuk

kanë këtë frymë, synojmë me arsyetimet e rreme të interpretojnë fenë sipas dëshirave të tyre trupore.

Në qoftë se individë të tillë gëzojnë një status shoqëror dhe një pjesë e njerëzve ia dëgjojnë fjalën, ata janë më shumë se çdo njeri tjetër objekt i tundimit të shejtanit, sepse ata kanë dëshira që janë të ndaluara nga feja dhe është e vështirë për ta t'i heqin qafe, për shkak të dobësisë së shpirtit të tyre për nënshtrimin ndaj Zotit. Ndërkohë, ata kanë forcë, që e përdorin për të paraqitur të vërtetën në favorin e tyre.

Shejtani shfrytëzon këtë mundësi të artë, i tërheq dhe i nxit ata drejt fitnes dhe shtrembërimit të fesë. Shejtani ndez zjarrin për të kënaqur këto dëshira në shpirtin e tyre. Ai, gjithashtu, rrënjos këtë dyshim në mendjet e tyre: Cila është prova se ajo çfarë është deklaruar prej dijetarëve fetarë si obligim dhe vlera fetare, është pikërisht ato që Zoti apo feja dëshiron prej nesh?

Meqenëse individë të tillë shikojnë se me ekzistencën e Kur'anit, thëniet e dijetarëve dhe mësimet e Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*), nuk mund t'i kënaqin plotësisht dëshirat e tyre trupore, epshet dhe tekat, ata vendosin të gjejnë një mënyrë të re për të mundësuar përmbushjen plotësisht të dëshirave të tyre. Në të njëjtën kohë, të mbeten përsëri në gjirin e Islamit, për të ruajtur pozitën e tyre në shoqëri. Prandaj, ajo që i tërheq drejt shmangies, është mungesa e frymës së dorëzimit dhe e nënshtrimit ndaj Zotit dhe nënshtrimi ndaj dëshirave të tyre trupore.

Në përgjigje të pyetjes se pse disa njerëz në shoqërinë islame kanë për qëllim të krijojnë fitne në fe, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë se rrënjët e të gjitha trazirave në fe qëndrojnë te dëshirat

trupore, të cilat këta njerëz nuk mund t'i braktisin. Në mënyrë që t'i plotësojnë këto dëshira, ata përfshihen në fitne, duke ndjekur një mënyrë të re të ballafaqimit të ligjeve dhe vlerave fetare.

Meqë ra fjala, cila është kjo mënyrë e re që ata përdorin për të çuar përpara synimet e tyre? Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë se ata formulojnë ligje sipas dëshirave të tyre trupore dhe ia atribuojnë ato Islamit. Ata angazhohen në deformimin e të vërtetave të fesë me interpretime të pabaza dhe arsyetime të rreme dhe interpretojnë Kur'anin dhe ajetet e tij ashtu si ata dëshirojnë.

Si rezultat i kësaj, ata tregojnë diçka që është në kundërshtim me të vërtetën e fesë dhe Kur'anin e Shenjtë dhe i nxitin njerëzit që të mos i binden Kur'anit. Është e qartë se këta individë sillen në një mënyrë tillë që njerëzit të mos bëhen të vetëdijshëm për agjendën e tyre satanike dhe të mos i ndjekin ata.

Për Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*) baza e të gjithë trazirave dhe e ndryshimeve në fe, është egoizmi dhe mungesa e frymës së dorëzimit dhe e nënshtrimit ndaj Zotit. Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ua kthen mendjen njerëzve, sidomos udhëheqësve të tyre, nga ndjekja e dëshirave dhe e tekave të tyre, si dhe i paralajmëron me ajetin në vijim:

أَرَأَيْتَ مَنْ اتَّخَذَ إِلَهَهُ هَوَاهُ

**"A e ke parë atë ti, që epshin e vet e ka marrë për zot?"<sup>1</sup>**

Ata që sot janë forca më me ndikim dhe agjentët e shejtanit në shtrembërimin e mësimeve të fesë, nuk ishin të tillë. Ka shumë

---

<sup>1</sup> Sure "Furkan", ajeti 43.

raste të individëve, të cilët ishin në mesin e myslimanëve të drejtë dhe propaganduesve të vërtetë të Kur'anit dhe mësimëve fetare, por ata ndryshuan drejtimin gjatë rrugës dhe u bashkuan me radhët e kundërshtarëve të Islamit.

Ata u përjashtuan nga kujdestaria e Allahut dhe pranojnë kujdestarinë dhe miqësinë e shejtanit. Në të kundërtën, ka edhe shumë persona, të cilët, pas shumë vitesh shmangie, shmangie të vetes dhe të të tjerëve, pendohen pas rikthimit në gjirin e Islamit dhe kalojnë pjesën e mbetur të jetës, duke kompensuar bëmat e tyre të padëshirueshme në të kaluarën.

Kjo zhvendosje e pozicioneve të individëve gjatë gjithë jetës nuk është e pazakontë apo e rrallë. Megjithatë, ajo që vlen të përmendet, është se, sipas Kur'anit, nuk ka gjynah më të rrezikshëm dhe më të rëndë se sa fitneja në fe. Mëkati më i rëndë është se, pas njohjes të së vërtetës dhe duke u njohur me ligjet dhe mësimet e fesë, ai vendos të pengojnë njerëzit nga njohja, duke ndikuar mbi ta.

Si përfundim, unë do të doja të tërhiqja vëmendjen e të gjithëve me thënien e çmuar të Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*):

حَاسِبُوا أَنْفُسَكُمْ قَبْلَ أَنْ تُحَاسَبُوا.

*"Llogaritini vetat tuaja, para se të thirreni për të dhënë llogari."*<sup>1</sup>

Kjo do të thotë, vlerësojeni veten, besimet tuaja, idetë tuaja dhe veprimet tuaja në gjykimin e ndërjegjjes suaj. Para se të ktheheni te Zoti dhe të humbisni mundësinë për t'u penduar,

---

<sup>1</sup> "Biharul Enuar", vëll. 8, f. 145.

kthelhuni në prehrin e Kur'anit dhe te feja e vërtetë. Ruaj veten nga kurthet e shejtanit dhe epshet trupore dhe frikësojeni atë me kështetimin e paevitueshëm.

Më lejoni të përfundoni me paralajmërimin e Kur'anit të Shenjtë, në këtë drejtim:

لَمْ كَانَ عَاقِبَةُ الَّذِينَ آسَأُوا السُّؤَىٰ أَنْ كَذَّبُوا بِآيَاتِ اللَّهِ وَكَانُوا بِهَا يَسْتَهْزِئُونَ

**"Pastaj përfundimi i atyre që punuan keq, ka qenë e keqja e madhe (Xhehenemi), ngaqë i mohonin Shpalljet e Allahut dhe talleshin me to."**<sup>1</sup>

I lutem Allahut të Lartësuar, t'i udhëzojë të gjithë në rrugën e të vërtetës.

وَالسَّلَامُ عَلَيَّ مَنِ اتَّبَعَ الْهُدَىٰ

**"Paqe mbi ata që ndjekin udhëzimin e Tij!"**<sup>2</sup>

<sup>1</sup> Sure "Rrum", ajeti 10.

<sup>2</sup> Sure "Ta Ha", ajeti 47.

## PËRMBAJTJA

PARATHËNIE.....	8
HYRJE.....	11
KAPITULLI I.....	15
STATUSI I KUR'ANIT NË SHOQËRITË FETARE.....	15
<i>Kur'ani, si i vetmi Libër i Shenjtë në dispozicion të njerëzimit.....</i>	15
<i>Mënyra kur'anore e ligjërit.....</i>	18
<i>Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe shpjegimi i Kur'anit.....</i>	20
<i>Përmendja e dy pikave.....</i>	23
<i>Roli i Kur'anit në jetë.....</i>	24
<i>Kur'ani, si burim universal i udhëzimit.....</i>	26
<i>Një shembull i rrugëve të përgjithshme të Kur'anit.....</i>	28
<i>Manifestimi i mëshirës hyjnore në vendosjen e qeverisë islame.....</i>	30
<i>Zgjidhja e problemeve sociale qëndron në ndjekjen e Kur'anit.....</i>	31
<i>Organizimi i çështjeve sociale, sipas udhëzimeve të Kur'anit.....</i>	34

<i>Roli i një objektivi në jetën shoqërore.....</i>	35
<i>Pavarësia qëndron në ndjekjen e Kur'anit.....</i>	41
<i>Kur'ani, ilaçi çudibërës për sëmundjet më të rënda.....</i>	44
<i>Urtësia pas disa fatkeqësive.....</i>	48
<i>Respekti i vërtetë, i jashtëm, për Kur'anin e Shenjtë.....</i>	55
<i>Kur'ani, drita e vërtetë.....</i>	58
<i>Fanarët dhe reflektimet kur'anore.....</i>	61
<i>Shpëtimi i ndjekësve të Kur'anit në Ditën e Ringjalljes.....</i>	65
<i>Këshillime dhe kujtesa.....</i>	67
<i>Sekreti i suksesit dhe roli i Kur'anit.....</i>	69
<i>Ibrahimi (Paqja qoftë mbi të!), një model i nënshtrimit ndaj Kur'anit të Shenjtë.....</i>	71
<b>KAPITULLI II.....</b>	75
<b>KUPTIMI DHE INTERPRETIMI I KUR'ANIT.....</b>	75
<i>Problemi kryesor.....</i>	75
<i>Këshilla e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), lidhur me Kur'anin.....</i>	79
<i>Interpretimi spekulativ (Tefsir bi err rrajji).....</i>	81
<i>Udhëzimi i Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), për të shmangur interpretimin spekulues.....</i>	84



<i>Dy këndvështrime për trajtimin e Kur'anit dhe të mësimëve fetare.....</i>	86
<i>Pluralizmi fetar apo mohimi i fesë, nën petkun e "interpretimeve të ndryshme".....</i>	89
<i>Domosdoshmëria për të fituar aftësi për kuptimin dhe interpretimin e Kur'anit.....</i>	95
<i>Shkallët e ndryshme të domethënies dhe të kuptimit të koncepteve kur'anore.....</i>	97
<i>Kufizimi i interpretimit të Kur'anit nga i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe Imamët e Pagabueshëm në shpjegimin, ose në parashtrimin e ligjeve.....</i>	101
<i>Përvetësimi i njohurive të dhëna nga Ehli Bejti (Paqja qofte mbi ta!), si një parakusht në të kuptuarin dhe në interpretimin e Kur'anit.....</i>	104
<i>Interpretimi i Kur'anit përmes Kur'anit.....</i>	105
<i>Respektimi i parimeve dhe i rregullave të diskursit intelektual në kuptimin e Kur'anit.....</i>	107
<i>Kuptimi i interpretuesëve është në përputhje me njohuritë e tyre.....</i>	108
<i>Domosdoshmëria për t'u kushtuar vëmendje konteksteve gjuhësore.....</i>	109
<i>Ekzistenca e bukurisë letrare në Kur'an.....</i>	111
<b>KAPITULLI III.....</b>	113
<b>KUR'ANI DHE AGRESIONI KULTUROR.....</b>	113
<i>Natyra kontradiktore e të vërtetës dhe e gënjeshtërs.....</i>	113

<i>Pretendimi i mungesës së qasjes për vërtetësinë e fesë.....</i>	118
<i>Rrënjosja dhe përsëritja, si arma kryesore e shejtanëve.....</i>	122
<i>Citimi i vargjeve alegorike (muteshabihatet) të Kur'anit, si një mënyrë tjetër e kundërvënies me Kur'anin.....</i>	123
<i>Urtësia e vargjeve alegorike në Kur'an.....</i>	126
<i>Kombinimi i të vërtetës dhe falsitetit, si një armë tjetër për shmangësit...134</i>	
<i>Interpretime të ndryshme, si një armë për kundërvënien me Kur'anin.....</i>	136
<i>Motivet e kundërshtarëve të kulturës fetare, sipas Kur'anit.....</i>	137
<i>Qëndrimi kur'anor përballë "rebelimit"- "fitnah" në fe.....</i>	142
<i>Paralajmërimi i Kur'anit kundër rebelimit kulturor.....</i>	145
<i>Politeizmi (shirku) me petkun e ri.....</i>	146
<i>Lajmërimi i Kur'anit për lindjen e rebelimit në fe.....</i>	148
<i>Lajmërimi i lindjes së rebelimit pas të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).....</i>	149
<i>Errësimi i atmosferës, me qëllim mashtrimin e masës.....</i>	156
<i>Shtrembëruesit e mësimëve fetare, sipas Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!)....</i>	158
<i>Trajtimi i Kur'anit nga materialistët pseudomyslimanë.....</i>	163
<i>Paralajmërimi i Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) për njerëzit.....</i>	166
<i>Motivi i injorantëve pseudo të ditur në shtrembërimin e mësimëve fetare, sipas Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!).....</i>	169

## تجلي القرآن في نهج البلاغة

المؤلف: محمد تقي المصباح البيزدي

تيرانا: 2023

اسم الكتاب: تجلي القرآن في نخب البلاغة

المؤلف: محمد تقي المصباح اليزدي

الترجمة الى اللغة الألبانية: منتور چادری

المشرف العام: شيخ وُلنَّتْ مَرِيَا

التصحيح اللغوي: يريدا كولا

الاخراج و الغلاف: صبريه فزا

الناشر: جمعية "النسيم"

تيرانا: 2023